

PËR MËSIMDHEËNËSIN/EN

duk gjini
shtëpia botuese publishing house

**Majlinda Hyseni, Afërdita Pajaziti-Bellaqa,
Antigona Mehmeti, Besnik Shabiu**

BIOLOGJIA

Për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët

6

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	6
Hyrje.....	8
Planifikimi vjetor.....	17
Plani dymujor: shtator—tetor.....	18
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	21
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	24
Plani tremujor: prill—maj—qeror.....	28
Mësimi 1: Biologjia - shkenca e jetës.....	32
Mësimi 2: Organizmat e gjallë përbëhen nga qeliza.....	34
Mësimi 3: Ushtrime - Vrojtimi i qelizës në mikroskop.....	36
Mësimi 4: Përsëritje - qeliza.....	38
Mësimi 5: Qelizat japin indet, organet dhe sistemet e organeve.....	40
Mësimi 6: Sistemet e organeve.....	42
Mësimi 7: Karakteristikat e organizmave.....	44
Mësimi 8: Sistematika - Klasifikimi i organizmave.....	46
Mësimi 9: Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore.....	48
Mësimi 10: Përsëritje - (Sistematika - Klasifikimi i organizmave).....	50
Mësimi 11: Mbretëritë e botës së gjallë.....	52
Mësimi 12: Mbretëritë (fungji, animalia, plantea).....	54
Mësimi 13: Biodiversiteti.....	56
Mësimi 14: Përfitimet ekologjike nga biodiversiteti.....	58
Mësimi 15: Cilat rreziqe që e kërcënojnë biodiversitetin dhe cilat janë masat mbrojtëse?.....	60
Mësimi 16: Përsëritje (Biodiversiteti).....	62
Mësimi 17: Biodiversiteti në Kosovës.....	64
Mësimi 18: Llojet endemike në Kosovë.....	66
Mësimi 19: Ku jetojnë qeniet e gjalla?.....	68
Mësimi 20: Përsëritje (Biodiversiteti).....	70
Mësimi 21: Ç'është mjedisi?.....	72
Mësimi 22: Biosfera dhe njësitë që e përbëjnë atë.....	74
Mësimi 23: Funksionimi i ekosistemit.....	76
Mësimi 24: Qarkullimi ciklik i materieve në ekosistem.....	78
Mësimi 25: Qarkullimi i energjisë në ekosistem.....	80
Mësimi 26: Ekologjia e popullatave.....	82
Mësimi 27: Dinamika e popullatave.....	84
Mësimi 28: Ndërveprimet mes qenieve të gjalla.....	86
Mësimi 29: Nisha ekologjike.....	88
Mësimi 30: Përsëritje.....	90
Mësimi 31: Sjelljet e shtazëve.....	92
Mësimi 32: Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve.....	94
Mësimi 33: Struktura trupore përcaktuese e sjelljeve të shtazëve.....	96
Mësimi 34: Përsëritje.....	98
Mësimi 35: Sjelljet ciklike.....	100

Mësimi 36: Organizimi i biocenozave dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve	102
Mësimi 37: Suksesionet (njëpasnjëshmëritë) ekologjike	104
Mësimi 38: Klasifikimi i ekosistemeve	106
Mësimi 39: Përsëritje	108
Mësimi 40: Biomet detare dhe oqeanike	110
Mësimi 41: Biomet tokësore - pyjet halore.....	112
Mësimi 42: Pyjet gjetherënëse.....	114
Mësimi 43: Pyjet e zonave me klimë të nxehtë.....	116
Mësimi 44: Biomet barishtore	118
Mësimi 45: Përsëritje	120
Mësimi 46: Biomet me kushte të papërshtatshme.....	122
Mësimi 47: Ekosistemet e kultivuara tokësore - artificiale.....	124
Mësimi 48: Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor.....	126
Mësimi 49: Cilët janë faktorët e shkatërrimit të pyjeve?	128
Mësimi 50: Përsëritje	130
Mësimi 51: Ndotja e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij.....	132
Mësimi 52: Ndotja e tokës	134
Mësimi 53: Ndryshimet klimatike - ngrohja globale (efekti serrë).....	136
Mësimi 54: Niveli i dyoksidit të karbonit në ajër po rritet	138
Mësimi 55: Ndryshimi i klimës - ngrohja globale (efekti serrë) - Përsëritje.....	140
Mësimi 56: Çelësat e thjeshtë për përcaktim (klasifikim) të organizmave	142
Mësimi 57: Si duhet të ushqehemi?.....	144
Mësimi 58: Shëndeti - dietat e balancuar dhe stërvitja	146
Mësimi 59: Si ta mbajmë higjienën për një jetë të shëndetshme?.....	148
Mësimi 60: Riprodhimi te njeriu dhe edukata seksuale.....	150
Mësimi 61: Puberteti - pjekuria seksuale	152
Mësimi 62: Puberteti - pjekuria seksuale - Përsëritje	154
Mësimi 63: Seksualiteti njerëzor	156
Mësimi 64: Abuzimi seksual.....	158
Mësimi 65: Drogat - efektet dhe pasojat e përdorimit të tyre.....	160
Mësimi 66: Pagjumësia dhe qëndrimi i gjatë ulur - pasojat në shëndet	162
Mësimi 67: Seksualiteti njerëzor, abuzimi, drogat, pagjumësia - Përforcim.....	164

Të dashur mësimdhënës dhe mësimdhënëse,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë në zhvillimin e mësimet, mbështetur në metodologjitë më të përparuara të sotme.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për të formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" në vazhdim të nismës për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësimdhënësve, ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për të formësuar të ardhmen e tyre?

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues, bashkëpunues dhe kurioz, i aftë për të përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme shqiptare.

Cilësia e re e të nxënësve dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por kërkohet të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave është i pranishëm për herë të parë në Kosovë i zbatuar në vitin 2022 dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë


Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënës, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.

Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.

Parashikimi është faza e parë e orës mësimore që siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin/en gjatë përgatitjes.

Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore; tema është më e gjerë.

Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zërthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Zakonisht, mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentoohen.

Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes.

Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



Përpunimi i përmbajtjes është faza e dytë e orës mësimore, ku bëhet përzgjedhja e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik i tij.

Përforsimi është faza e tretë e orës mësimore, ku bëhet integrimi i dijeve dhe shprehive, si dhe zbatimi i tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimi

Rezultatet e të nxënës të temës janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës. Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacione mendore; të menduarit e tyre është konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Prandaj, mësimi me këta nxënës kalon në tri faza, dhe të menduarit e tyre sipas proceseve njohëse.

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës. Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve. Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimin, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit janë zërtim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - fazat e zhvillimit të mësimin. Tashmë nxënësit, duke filluar nga klasa e tretë e lart, zotërojnë operacionet mendore, të cilat kanë karakter konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Me kalimin në klasat më të larta, marrin karakter mbizotërues, pasi të menduarit është formal. Mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit gjatë të nxënësve, sipas proceseve njohëse.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimin?

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënës

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënësve. Në këtë fazë kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimin, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive. Gjithashtu, ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përfundimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimi përfundon me fazën e përfundimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve të ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësimdhënësin/en

BIOLOGJIA 6

Fokusi kryesor i të mësuarit të *Shkencave të natyrës* është thellimi i të kuptuarit të koncepteve dhe ideve edhe përmes lëndës së biologjisë. Kjo u ndihmon nxënësve që t'i kuptojnë ndërlidhjet mes këtyre lëndëve dhe koncepteve, për t'i argumentuar dukuritë shkencore si tërësi dhe ndikimin e tyre në funksionimin e shoqërisë dhe të natyrës.

Nxënësit duhet t'i zgjerojnë dhe t'i thellojnë njohuritë dhe shkathtësitë për dijet, metodat, proceset për përdorimin e të arriturave shkencore në jetën e përditshme. Ata inkurajohen të kuptojnë se si shkenca mund të përdoret për të shpjeguar se çka ka ndodhur rreth tyre si dhe t'i analizojnë shkaqet dhe pasojat.

Fusha kurrikulare *Shkencat e natyrës* ndihmon zhvillimin e integruar të kompetencave, të cilat ndihmojnë përgatitjen e nxënësve në aspektin social, shëndetësor e ekonomik dhe që lidhen me çështje të ndryshme në nivel kombëtar dhe global.

Qëllimet e të mësuarit të biologjisë janë:

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit të koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes eksplorimit të proceseve njerëzore dhe natyrore në mjedis;
- Zhvillimi i qasjes shkencore në zgjidhjen e problemeve e cila ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues;
- Inkurajimi i nxënësve t'i eksplorojnë, t'i zhvillojnë dhe t'i zbatojnë idetë dhe konceptet shkencore përmes disenjimit dhe aktiviteteve praktike;
- Inkurajimi i nxënësve të vlerësojnë kontributin e biologjisë dhe teknologjisë në mjaft dimensione në shoqëri;
- Kultivimi i kujdesit dhe respektit për diversitetin e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla, varësinë dhe bashkëveprimin mes tyre;
- Inkurajimi i nxënësve të sillen me përgjegjësi për të mbrojtur, për të përmirësuar dhe për të dashur mjedisin duke u përfshirë në identifikimin, në diskutimet dhe në aktivitetet për problemet mjedisore që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Gatishmëria e nxënësve t'i komunikojnë idetë, të prezantojnë punën dhe t'i raportojnë të gjeturat e hulumtimeve përmes medieve të ndryshme;
- Zotërimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, për përpunimin dhe për prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve në biologji.

Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për *shkencat natyrore*, brenda orës mësimore dhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, nevojitet përdorim i përshtatshëm i metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat dhe për fushën *Shkencat e natyrës*, e përkatësisht rezultatet lëndore, paraqesin jo vetëm pika referuese për përzgjedhjen e përmbajtjeve, por edhe për përzgjedhjen e metodologjive, duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve, në kontekst të filozofisë dhe parimeve të Kornizës Kurrikulare.

Suksesi i nxënësve në lëndën *Biologji* varet nga puna dhe angazhimi i mësimitdhënësit dhe nxënësit. Kjo arrihet duke përdorur qasje krijuese, ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore, si dhe metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike në laborator, klasë si dhe të nxënësve në natyrë.


Mësimdhënia për nxënësit e klasës së gjashtë realizohet përmes ilustrimeve, provave dhe lojërave, nën mbikëqyrjen e mësimitdhënësit, duke pasur parasysh kohën në dispozicion për nevojat dhe kërkesat e tyre, natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, bazën didaktike dhe stilet e të nxënësve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënësve cilësore sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësve

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje "Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës" (e rishikuar) (2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, rezultatet specifike të të nxënësve të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimi e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësve - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënësve - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet "trekëndësh magjik". Ky trekëndësh paraqet marrëdhëniet koherente midis rezultateve të të nxënësve, veprimtaritë e mësimdhënies të të nxënësve dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathësive.



Burimi: Nga *Metodologji e mësimdhënies*, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.


Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimin të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimin ka dhënë rezultate mjaft të mira.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshtarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënësia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimin midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësimdhënësi apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

*Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)
Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 3

Nr.	Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore
I.	Kompetenca komunikim dhe të shprehur – Komunikues efektiv
1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke i paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke i respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
7.	Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në forma të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8.	Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevojë (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

II. Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	
1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
2.	Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3.	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/ detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe e arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke e dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për t'i gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të nxënës - Nxënës i suksesshëm	
1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose në internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
2.	Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
4.	Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.
5.	Ndërlidh temën e dhënë që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafik) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7.	I parashtron pyetje vetes (pse?, çka?, si?, kur?) dhe i organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe e vlerëson përparimin e vet derisa ta gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv	
1.	Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.
2.	Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
3.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen të ndërmerren për evitimin e tyre.
4.	Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.
5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, disenjime të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
6.	Ndihmon në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare apo humanitare në shkollë dhe në komunitet dhe i shpreh pastaj përvojat dhe ndjenjat e veta me shkrim dhe forma të tjera të të shprehurit.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/ aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
8.	Merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

1.	Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm.
2.	Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative të paktën të tri llojeve të ushqimeve të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.
3.	Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.
4.	Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.
5.	Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe ua shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.
6.	Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke i ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit.
7.	Kërkon ndihmë/këshilla pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.
8.	Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.
9.	Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.
10.	Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për t'i ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të fituara.

VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

1.	Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2.	Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe e arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3.	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizojnë shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
4.	Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme nga mediet, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më.
5.	Shpjegon, në formë të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit.
6.	Dëshmon vetëbesimin e lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.
7.	Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.
8.	Merr pjesë në aktivitete që promovojnë tolerancë dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dalta nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së katër të kurrikulës (Shk. 3), në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:

Koncepti	Rezultatet e të nxënit të fushës (RNF)	
Bota e gjallë	<p>RNF: Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.</p> <p>Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësor të njeriut.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Biodiversiteti	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore. Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera. Identifikon rregullat themelore të emërtimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla. Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike. Identifikon dhe i përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (psh. invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdor këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (psh. invertebrorët-arthropodat-insektet; vertebrorët-gjitarët-primatët; bimët me farë-bimët me lule-bimët barishtore). Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojlojshmëri e jetës në Tokë, duke e përfshirë llojlojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato. Shpjegon rëndësinë e biodiversitetit për stabilitetin e ekosistemeve natyrore dhe përfitimet e njeriut nga biodiversiteti (sigurimin e resurseve jetësore si ushqimi, barnat, lëndët e para për prodhime të ndryshme etj.) Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe të zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (psh. për shkak të gjetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invazive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit). Identifikon produktet e jetës së përditshme, të cilat kanë origjinë nga diversiteti i organizmave (psh. mëndafshi nga krimbi i mëndafshit, suplementet ushqimore, shamponët, pastat e dhëmbëve dhe deodorantët që përmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj.). Tregon vetëdijësim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret në traktin digjestiv mund ta ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje). Identifikon bimët dhe shtazët endemike, të rrezikuara për zhdukje që jetojnë në Kosovë. Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë. Vlerëson rolin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit - në nivel global. Përdor çelësa të thjeshtë dikotomikë për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë. Analizon një çështje lokale të lidhur me biodiversitetin (psh. efektet e aktiviteteve të njeriut në biodiversitetin urban). Vlerëson përfitimet që ka shoqëria njerëzore nga biodiversiteti si dhe problemet që shkaktohen nga zvogëlimi i biodiversitetit.

		<ul style="list-style-type: none"> • Ndjek rregullat e sigurisë gjatë aktiviteteve në natyrë dhe punës në terren. • Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lumë, pyll, livadh etj.) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit. • Krahason karakteristikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shtazëve (psh. krahason karakteristikat e një peshku dhe një gjitari, të një peme gjethebjatësë -halore dhe një peme gjetherënëse, të fiernave dhe bimëve me lule). • Përdor fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët-kurrizorët, invertebrorët-parruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj. • Shfrytëzon organizues grafik për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme. • Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e ekosistemit. • Definojnë nocionet/termat themelore ekologjike.
	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi - karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit - tipat e organizmave të tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit). • Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes). • Përshkruan se si përshtatjet shërbejnë për ta mundur mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjellje - sigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi duke e gjetur, tërhequr partnerinose shpërndarja e farave/ fryteve. • Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesve, konsumuesve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit. • Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës, duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezës. • Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zërthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit, duke i shpjeguar nocionet prodhuesi dhe konsumuesi. • Bën dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore. Organizmi është qenie e gjallë. Popullata definohet si grup i bimëve ose i shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë. • Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme i mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, kënetë, përroi etj.). • Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). • Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (psh. ujqit udhëtojnë në grup për ta mbrojtur territorin e tyre, rritin të vegjlit (këlyshët) e tyre dhe e gjuajnë prentë e madhe). • Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie, vetëm duke e pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegon se si këto marrëdhënie e mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit. • Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale. • Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: psh. ruajtja-konservimi i biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ: psh. zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale. • Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.
	Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon procesin e rritjes dhe të zhvillimit, proceseve riprodhuese njerëzore dhe problemet e abuzimit seksual. • Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit. • Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës. • Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuate. • Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tij.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shkencat natyrore. Klasa VI

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor	
LËNDA MËSIMORE: BIOLOGJI	Biodiversiteti	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor	Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut	<p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 6.</p> <p>Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 1, 4, 5, 6, 7, 8.</p> <p>Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6.</p> <p>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv 2, 3, 4, 5.</p> <p>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 1, 2, 5, 8.</p> <p>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 4, 7.</p>
	Gjithsej 18 orë	Gjithsej 16 orë	Gjithsej 21 orë	Gjithsej 20 orë	

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Biologji

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: VI

Temat mësimore: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

2.	Dëgjon në mënyrë aktive dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke i paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/ detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
3.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
5.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë), sipas një radhitjeje logjike.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

3.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen të ndërmerren për evitimin e tyre.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënëit për tema mësimore RN	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Biodiversiteti</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore. Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individit), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera. - Krahason karakteristikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shtazëve (p.sh., krahason karakteristikat e një peshku dhe një gjitari, të një peme gjethebajtëse halore dhe një peme gjethehënëse, të fienave dhe bimëve me lule). - Identifikon rregullat themelore të emërimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla. Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike. - Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh., invertebrorët nuk kanë shtyllë rruzazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdor këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (psh. invertebrorët-arthropodat-insektet; vertebrorët-gjitarët-pri-lule-bimët barishtore). 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Njohja e nxënësve me planprogramin lëndor 2. Biologjia shkencë e jetës 3. Qeliza bimore 4. Ushtrime -vrojimi në mikroskop i qelizës 5. Përsëritje - Qeliza 6. Qelizat japin indet, organet dhe sistemet e organeve 7. Sistemet e organeve 8. Karakteristikat e organizmave 9. Sistematika - klasifikimi i organizmave 10. Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore 11. Përsëritje 12. Mbretëritë e botës së gjallë 13. Mbretëritë (fungji, animalia, plantea) 14. Biodiversiteti 15. Përfitimet ekologjike 16. Cilat janë rreziqet që e kërcënojnë biodiversitetin dhe cilat janë masat mbrojtëse? 17. Përsëritje 18. Vlerësim 	<p>18</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt); - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve; - Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren. 	<p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).</p> <p>Vlerësimi me test.</p> <p>Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës).</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale.</p> <p>Vlerësimi për ecurinë dhe produktin e punës me projekte.</p> <p>Vlerësimi i port-folios.</p> <p>Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore.</p> <p>Vlerësimi i de-tyrave të shtëpisë.</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Fizikë</p> <p>Edukatë qytetare</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Histori</p> <p>Ekologjia dhe mjedisi</p>	<p>- Libri Biologjia 6 (B. Mustafa, A. Hajdari, Sh. Mustafa)</p> <p>- Atlas</p> <p>- Foto ilustrose</p> <p>- Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës (https://www.ammk-rks.net/repository/docs</p> <p>/Biodiversity_i_Kosoves.pdf)</p> <p>Slide/materiale të ndërtuara nga mësimdhënësi</p> <p>Tekste nga fushat e tjera</p>		

	<p>- Përdor çelësa të thjeshtë diktomikë për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë. Ndjek rregullat e sigurisë gjatë aktiviteteve në natyrë dhe punës në terren. Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkollë, park qyteti, kënetë, lumë, pyll, livadh, etj.) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit.</p>						
--	---	--	--	--	--	--	--

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Biologji

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: VI

Temat mësimore: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
2.	Dëgjon në mënyrë aktive dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke i paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik	
1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për t'i gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose në internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
4.	Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.
5.	Ndërlidh temën e dhënë që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë), sipas një radhitjeje logjike.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Definin nocionet/termat themelorë ekologjikë. - Diskutojnë efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes). - Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi - karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit - tipat e organizmave të tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit). - Bën dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore. Organizmi është qenie e gjallë. - Popullata definohet si grup i bimëve ose i shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë. Shfrytëzon organizues grafkë për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> 19. Biodiversiteti në Kosovë 20. Llojet endemike në Kosovë 21. Prezantimi i projekteve -hulumtojnë për biodiversitetin në Kosovë 22. Ku jetojnë qeniet e gjalla? 23. Përsëritje -Biodiversiteti 24. Çështje mjedisi? 25. Biosfera dhe njësitë që e përbëjnë atë 26. Funksionimi i ekosistemit 27. Qarkullimi ciklik i materieve në ekosistem 28. Qarkullimi i energjisë në ekosistem 29. Ekologjia e popullatave 30. Dinamika e popullatave 31. Ndërveprimet mes qenieve të gjalla 32. Nishat ekologjike 33. Përsëritje 34. Vlerësim 	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëbiseduese - Mësimdhënie dhe të nxënit që e nxit hulumtimin e pavarur; - Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); - Mësimdhënie me anë të pyetjeve drejtuar nxënësve); - Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve); - Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore; - Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale; 	16	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi për nxënie (informata kthyese, vlerësim i ndersjellë). - Vlerësimi me test. - Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale. - Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime). - Vlerësimi për ecurinë dhe produktin e punës me projekte. 	<ul style="list-style-type: none"> - Gjjuhë dhe komunikim - Ekologji dhe mjedisi - Gjeografi - TIK - Art Figurativ - Matematikë 	<ul style="list-style-type: none"> - Libri Biologjia 6, (B. Mustafa, A. Hafajdi, Sh. Mustafa) - Slide/ materiale të ndërtaura nga mësimdhënësi - Tekste nga fushat e tjera - Materiale nga interneti 	

	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e ekosistemit. - Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zëbrthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit, duke i shpjeguar noçionet prodhuesi dhe konsumuesi. - Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës, duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezës. - Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesve, konsumuesve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rjetën e ushqimit. - Bën dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore. Organizmi është qenie e gjallë. Popullata definohet si grup i bimëve ose i shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë. - Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). 		<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. 		
--	---	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Biologji

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: VI

Temat mësimore: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke i paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për t'i gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

3.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.
5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, disenjim të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan se si përshtatjet shërbejnë për ta munduruar mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjellje - sigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi duke e gjetur ose tërhequr partnerin ose shpërndarja e farave/fryteve. - Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda speciet (p.sh., ujëqit udhëtojnë në grup për ta mbrojtur territorin e tyre, rritin të vegjlit (këlyshët) e tyre dhe e gjuajnë prenë e madhe). - Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme, duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke e pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegon se si këto marrëdhënie e mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit. Shfrytëzon organizues grafikë për t'i treguar krahasimet mes organizimave në biocenoza të ndryshme. - Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes). - Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale. 	<ul style="list-style-type: none"> 35. Sjelljet e shtazëve 36. Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve 37. Struktura trupore përcaktuese e sjelljeve të shtazëve 38. Përsëritje 39. Sjelljet ciklike 40. Struktura dhe dinamika e biocenozeve 41. Suksesionet ekologjike 42. Klasifikimi i ekosistemeve 43. Përsëritje 44. Biomet detare dhe oqeanike 45. Biomet tokësore -pyjet halore 46. Pyjet gjettherënëse 47. Pyjet e zonave me klimë të nxehtë 48. Biomet barishtore 49. Përsëritje 50. Biomet me kushte të papërshtatshme 51. Ekosistemet e kultivuara tokësore -antropogjene 52. Si ka ndryshuar mjedisi jetësor? 53. Cilët janë faktorët e shkatërrimit të pyjeve? 54. Përsëritje 55. Vlerësim 	<ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie dhe të nxëniti që e nxit lumtimin e pavarur; - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj); - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve); - Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve); - Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore; - Diskutimi dhe të nxëniti në bashkëpunim (në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); 	21	<p>Vlerësimi për nxënënie (informatë kthyesë, vlerësimi i ndërsjellë)</p> <p>Vlerësimi me test</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)</p> <p>Vlerësimi për ecurinë dhe produktin e punës me projekte</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Art figurativ</p> <p>Matematikë</p> <p>Ekologjia dhe mjedisi</p> <p>Slide/ materiale të ndërtuara nga mësimdhënësi</p> <p>Tekste nga fushat e tjera</p>	<p>Libri Biologjia 6, (B. Mustafa, A. Hajdari, Sh. Mustafa)</p> <p>Atlaset</p> <p>Foto ilustruese</p> <p>Materiale të ndryshme nga interneti</p> <p>Slide/ materiale të ndërtuara nga mësimdhënësi</p> <p>Tekste nga fushat e tjera</p>	

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Biologji

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: VI

Temat mësimore: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor
Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

2.	Dëgjon në mënyrë aktive dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke i paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
4.	Shpreh mendimin/ gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.

II. Kompetenca të menduarit -- Mendimtar kreativ dhe kritik

1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecure/ strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke e dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatit e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/ dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë – Nxënës i suksesshëm

1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose në internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/ detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
5.	Ndërlidh temën e dhënë që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/ punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti, veprë arti (në klasë/ shkollë apo gjetiu).

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

1.	Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.
2.	Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
3.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen të ndërmerren për evitimin e tyre.
4.	Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (psh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.), për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.
5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, disenjime të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.

V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

3.	Diskuton në grup moshatarësh duke ofruar argumente për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.
7.	Kërkon ndihmë/ këshilla pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.
9.	Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e Vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale. - Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: psh. ruajtja-konservimi i biodiversitetit, pyllëzimi; Ndjek rregullat e sigurisë gjatë aktiviteteve në natyrë dhe punës në terren. - Ndikimi negativ: psh. zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndoaja (tokë/ ujë/ ajër), ngrohja globale. - Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndojes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij. - Ndikimi negativ p.sh., zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndoaja (tokë/ ujë/ ajër), - Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale. - Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: psh. ruajtja-konservimi i biodiversitetit, pyllëzimi; Ndjek rregullat e sigurisë gjatë aktiviteteve në natyrë dhe punës në terren. - Ndikimi negativ: psh. zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndoaja (tokë/ ujë/ ajër), ngrohja globale. 	<p>56. Ndofta e mjedisit</p> <p>57. Ndofta e tokës</p> <p>58. Ndryshimet klimatike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndrohja globale, efekti serrë - Niveli i dyoksidit të karbonit në ajër po rritet <p>59. Përsëritje - Ndryshimet klimatike - ngrohja globale (efekti serrë)</p> <p>60. Ekskursionet - Ekzamini i ekosistemeve</p> <p>61. Çelësat për përcaktimin e organizmave të vrojtuar në ekosistem</p> <p>62. Si duhet të ushqehemi?</p> <p>63. Shëndeti, dieta e balancuar dhe stërvitjet</p> <p>64. Si ta mbajmë higjienën për një jetë të shëndetshme?</p> <p>65. Riprodhimi te njeriut dhe edukata seksuale</p> <p>66. Cilat janë ndryshimet në pubertet?</p> <p>67. Përsëritje</p> <p>68. Seksualiteti njerëzor</p> <p>69. Abuzimi</p> <p>70. Drogat - problem për të gjitha moshat</p> <p>71.</p>	<p>20</p> <p>Bashkëbiseduese;</p> <p>Mësimdhënie dhe të nxëniti që e nxit hulumtimin e pavarur;</p> <p>Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj);</p> <p>Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);</p> <p>Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);</p> <p>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore;</p> <p>Diskutimi dhe të nxëniti në bashkëpunim (në grupe të vogla, të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);</p> <p>Mësimdhënie dhe të nxëniti përmes mjeteve multimediale;</p>		<p>Vlerësimi për nxënëti (informata të kthyesa, vlerësim i ndersjellë)</p> <p>Vlerësimi me test</p> <p>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale</p> <p>Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)</p> <p>Vlerësimi për produktin e punës me projekte</p>	<p>Gjuhë dhe komunikim</p> <p>Gjeografi</p> <p>TIK</p> <p>Art Figurativ</p> <p>Matematikë</p> <p>Ekologjia dhe mjedisi</p>	<p>Libri Biologjia 6, (B. Mustafa, A. Hajdari, Sh. Mustafaj)</p> <p>Atlase</p> <p>Foto ilustruese</p> <p>Materiale të ndryshme nga interneti</p> <p>Slide/materiale të ndërtuara nga mësimdhënësi</p> <p>Tekste nga fushat e tjera</p>	

<ul style="list-style-type: none"> - Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lumë, pyll, livadh etj.) dhe i klasifikon. - Tregon vetëdijësim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret në traktin digestiv mund ta ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje). - Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre. - Shpjegon procesin e rritjes dhe të zhvillimit, proceseve riprodhuese njerëzore dhe problemet e abuzimit seksual. - Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit. - Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës. - Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuate. 		<p>72. Prezantimi i pro-jekeveve -Drogat</p> <p>73. Pagjumësia dhe qëndrimi i gjatë ulur - problem në rritje</p> <p>74. Përsëritje</p> <p>75. Vlerësim</p>	<p>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p>		
---	--	--	---	--	--

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I. 2, II. 1, III. 5, IV. 3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biologjia - shkenca e jetës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon termin biologji;
- Argumenton rëndësinë e studimit të biologjisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlase, foto ilustruese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë, Ekologji dhe mjedis.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Parashitrohen pyetjet:

Çfarë dini për biologjinë?

Keni dëgjuar më parë për të?

Përgjigjet e mundshme të nxënësve:

- Biologjia është shkencë që e studion natyrën.
- Biologjia është shkencë që i studion bimët.
- Biologjia na mëson për kafshët dhe njeriun.

PJESA E PARË

BIODIVERSITETI

1. BIOLOGJIA - SHKENCA PËR JETËN

Në nuk e dimë nëse ka jetë diku tjetër në univers, përveç në Tokë. Planeti ynë ka kushtet e nevojshme për të jetuar bimët, kafshët dhe qeniet e tjera të gjalla. Në Tokë, ka ujë dhe ajër, që janë të domosdoshëm për jetën. Rrezet e diellit sigurojnë energjinë e nevojshme dhe temperaturën e duhur. Më poshtë janë disa fotografi që tregojnë shembuj të qenieve (krijesave) të gjalla të tokës. Një qenie e gjallë quhet *organizëm*.

Biologjia (nga greqishtja bios - jetë dhe logos - shkencë (mësim, dije) na mëson ndërtimin, fiziologjinë, sjelljen, organizimin, llojlojshmërinë dhe përhapjen e organizmave të gjallë në natyrë.



Sanza



Gaforrja



Qukapiku



Kërpudha

10

1. BIOLOGJIA - SHKENCA PËR JETËN

Në nuk e dimë nëse ka jetë diku tjetër në univers, përveç në Tokë. Planeti ynë ka kushtet e nevojshme për të jetuar bimët, kafshët dhe qeniet e tjera të gjalla. Në Tokë, ka ujë dhe ajër, që janë të domosdoshëm për jetën. Rrezet e diellit sigurojnë energjinë e nevojshme dhe temperaturën e duhur. Më poshtë janë disa fotografi që tregojnë shembuj të qenieve (krijesave) të gjalla të tokës. Një qenie e gjallë quhet *organizëm*.

Biologjia (nga greqishtja bios - jetë dhe logos - shkencë [mësim, dije] na mëson ndërtimin, fiziologjinë, sjelljen, organizimin, llojllojshmërinë dhe përhapjen e organizmave të gjallë në natyrë.



Sanza



Gaforrja



Qukapiku



Kërpudha

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Lexim i drejtuar*

Lexojnë pjesë-pjesë me radhë njësinë mësimore.

Nxënësi 1 - lexon një pjesë, pastaj e diskutojmë së bashku.

Nxënësi 2 - lexon pjesën tjetër, përsëri diskutojmë së bashku.

Vazhdojmë kështu edhe me pjesët e tjera.

**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:***Ese*

Nxënësit në formë të esesë i përmbledhin informacionet e njësisë mësimore.

Ese

Biologjia është shkencë natyrore e cila e studion ndërtimin, fiziologjinë, sjelljen, llojllojshmërinë e organizmave në natyrë.

Fjala biologji rrjedh nga gjuha greke që do të thotë bios-jetë dhe logos-shkencë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të biologjisë dhe argumentimin e rëndësisë së biologjisë si shkencë natyrore.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4, II. 6, III. 3, 5, IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Organizmat e gjallë përbëhen nga qeliza

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon qelizën;
- Emërton organelet qelizore;
- Dallon qelizën bimore dhe shtazore;
- Krahason qelizat prokariote dhe eukariote.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas, foto ilustruese, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënët

Alfabeti i njëpasnjëshëm në tryezë të rrumbullakët

Prezantohet emri i njësisë mësimore.

Mësimdhënësi përgatit më parë kopje të fletëve ku paraqitet një tabelë (si në modelin e dhënë).

Nxënësit mundohen të plotësojnë sa më shumë kuti për një kohë të shkurtër (6-7 min). Nxënësvë në fund u kërkohet t'i shkëmbejnë termat me të gjithë klasën.

1.1. Organizmat e gjallë përbëhen prej qelizës

Çfarë është një qelize? Në vitin 1665, natyralisti anglez, **Robert Huku**, me mikroskopin e tij të thjeshtë, në prerjen e hollë të tapës, për herë të parë vërejtí disa dhomëza të ngjashme me hojet e bletëve, të cilat i quajti celula (qeliza). Qelizat rëndom janë të vogla, mikroskopike, por ka përjashtime. Për t'i parë ato, do t'ju duhet një mikroskop.

1.1.1. Struktura dhe funksioni i qelizës


Një organizëm është i përbërë nga pjesë të vogla të gjalla, që quhen qeliza. Ato kanë forma të ndryshme. Organizmi është me të vërtetë si një shtëpi e përbërë nga pjesë të ndryshme si tulla, hekur, dru, tjegulla, xhama etj. Çdo njëra prej tyre është e ndërtuar në mënyrë të veçantë dhe kryen një punë të veçantë, kështu që shtëpia bëhet funksionale. Format e qelizave varen, kryesisht, nga funksionet e tyre, por edhe nga veëndodhja e tyre në krahasim me qelizat e tjera. Të gjitha qelizat përbëhen prej membranës, citoplazmës dhe materialit bërthamor.

Të gjitha qelizat bimore e shtazore kanë strukturën e mëposhtme:

Membrana. Qeliza është e mbështjellë me membranë. Ajo është një shtresë shumë e hollë, e cila rregullon hyrjen ose largimin e materieve.

Citoplazma. Brenda membranës qelizore ndodhet citoplazma, e cila është një masë gjysmë e lëngët, e pangjyrë, e tejdukshme, me veti ngitëse, në të cilën ndodhen organelet të ndryshme, të cilat kryejnë të gjitha aktivitetet e qelizës (shih figurën në faqen tjetër).

Bërthama. Çdo qelizë ka bërthamën, për të kontrolluar aktivitetet e qelizës. Nëse bërthama ndahet prej qelizës, ajo vdes. Nga citoplazma bërthama është e ndarë me mbështjellësin e saj. Bërthama është e mbushur me plazmën bërthamore, në të cilën ka një ose më shumë bërthamëza dhe kromozome. Forma dhe madhësia e bërthamës është e llojllojshme. Rëndom në një qelizë gjendet vetëm një bërthamë, por ka edhe qeliza të tilla që kanë disa.



Qeliza bimore dhe qeliza shtazore

Qeliza bimore

Te dyja qelizat, ajo e bimëve dhe ajo e shtazëve, kanë te tri pjesët e përkshuara më lart, por qelizat e bimëve kanë strukturë shtesë.

Muri qelizor është i përbërë nga një lëndë kimike e veçantë e quajtur celulozë. Muri qelizor luan rol në përcaktimin e formës së qelizës dhe në qarkullimin e lëndëve të ndryshme organike dhe joorganike në meste qelizave në saj të prezencës së poreve në të.

Vakuola është strukturë në formë të një qeseje. Roli i saj është në depozitimin e lëngut qelizor, në ruajtjen e substancave të mbetjeve (të panevojshme), ose dhënie të ngjyrës së qelizave, p.sh.: ngjyra e kuqe epanxharit.

Kloroplastet janë strukturë me ngjyrë të gjelbër, që vjen nga pigmenti i quajtur klorofil dhe marrin pjesë në procesin e fotosintezës. Ato nuk gjenden në çdo qelizë bimore, por ka shumë në qeliza të gjethëve.

Qeliza shtazore

Qeliza shtazore përmban një organelë të veçantë - **centriolën**.

1.1.2. Organizmat njëqelizorë

Të gjitha bimët dhe shtazët janë organizma shumëqelizorë dhe e kanë bërthamën të diferencuar. Ka organizma një dhe shumëqelizorë në kuadër të grupit të protistëve dhe kerpudhave, të cilët kanë bërthamën e diferencuar nga citoplazma dhe quhen **eukariote**. Bakteret dhe algat e kaltra në të gjelbër janë organizma njëqelizorë me një strukturë shumë të thjeshtë. Këto nuk e kanë bërthamën të diferencuar, materiali bërthamor është në citoplazmë dhe jo në bërthamë të veçantë, prandaj quhen **prokariote**.

A	B bimë	C	Ç	D	DH
E	Ë	F	G	GJ	H
I	J	K	L	LL	M muri qelizor
N	NJ njeriu	O	P	Q qeliza	R
RR	S	SH shtazë	T	TH	U
V	X	XH	Y	Z	ZH



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Ditari dypjesësh

Lexojnë njësinë mësimore për 10-15 min. Gjatë leximit nënvizojnë informacionet për ta plotësuar ditarin dypjesësh.

Citimet përzgjidhen nga mësimdhënësi.

Pjesa e komentit plotësohet nga nxënësit.

Citimet	Komenti
Qeliza bimore	
Qeliza shtazore	
Prokariote	
Eukariote	




Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Diagrami i Venit

Plotësojmë në tabelë së bashku me nxënësit diagramin e Venit.

Paraqesim të përbashkëtat dhe dallimet në mes të qelizës bimore dhe shtazore.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të organeleve qelizore, dallimit të qelizës bimore dhe shtazore dhe krahasimit të qelizave prokariote dhe eukariote.

Detyrë:

(Pyetje dhe përgjigje, faqe 13 (libri bazë))

Reflektim për veprimtarin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 1, III. 1, 5, IV. 3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime - Vrojtimi i qelizës në mikroskop

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon qelizën në epidermën e qepës;
- Përcakton organelet qelizore në qelizën e vrojtuar;
- Analizon funksionin e secilës organele qelizore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas, foto ilustruese, modele qelizash, mikroskop, xhami i objektit, xhami mbulues, qepë, ujë, një pipetë dhe një brisk.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Harta e koncepteve

Paraqesim konceptin kryesor “Qeliza” në tabelë. Kërkohet nga e gjithë klasa të ndërtojnë një hartë të koncepteve me njohuritë që tashmë i dinë për qelizën.

USHTRIM

3. Përgatitja e një preparati për vrojtimin e qelizës bimore dhe një preparati për vrojtimin e qelizës bakteriale me anë të mikroskopit.

Mjeti i nevojshëm për vrojtim: mikroskop i thjeshtë me dritë natyrale.

Ju tashmë dini ta përdorni mikroskopin e thjeshtë shkollor, sepse e keni mësuar që në klasën e pestë. Është e rëndësishme që pasqyra e tij të jetë e kthyer nga burimi i dritës.

Mjetet e nevojshme për përgatitjen e një preparati: xhami i objektit, xhami mbulues, brisku i rrojës, pinceta, një gotë e vogël me ujë dhe qepa.

Përshkrimi i punës për vrojtimin e qelizës bimore. Ndaheni në dy grupe. Njëri grup ka për detyrë ta analizojë ndërtimin e qelizës bimore. Kështu që, merret një copë e vogël e cipës së qepës, e cila pritët me brisk rroje në formë katrori dhe vendoset në xham të objektit, në të cilin më parë është qitur një pikë ujë. Pasi të vendoset cipa e qepës në ujë, mbulohet me xham mbulues. Tashmë e kemi përgatitur preparatin për ta vendosur në mikroskop. Në fillim, shikohet me objektivin më të vogël, me anë të të cilit mund të vërehen shumë qeliza dhe bërthamat e tyre. Pastaj përdoret objektivin më i madh dhe me anë të mikrovizitës qartësohet objekti që e vrojtojmë, në këtë rast cipa e qepës. Me këtë mikroskop, në qelizën e qepës do të vëreni murin qelizor, citoplazmën, bërthamën, bërthamëzën dhe vakuolën. Grupi tjetër punon për ta analizuar ndërtimin e qelizës bakteriale. Paraprakisht, e mbushim një gotë me ujë të ndotur, nga e cila marrim një pikë ujë dhe e vendosim në xham të objektit. Me anë të mikroskopit, vrojtojmë pikën e ujit. Aty do të shohim forma të ndryshme të baktereve, disa prej të cilave janë të lëvizshme e disa jo.

Përshkrimi i punës për vërtetimin e qelizës bakteriale:

- Vizatoje në fletoren tënde qelizën bimore duke i shënuar të gjitha pjesët e saj që i vërtetosh në mikroskop.
- Përshkruaje këtë qelizë në orën e biologjisë dhe komentoje së bashku me shokët e klasës.



Mikroskopi shkollor




Teknika e përgatitjes së preparatit për vërtetim në mikroskop

4. A janë këto pohime të sakta?

- Në vitin 1665, natyralisti anglez, Robert Huku, e zbuloi dhe e përshkroi qelizën. **PO JO**
- Qelizat janë të vogla dhe shihen vetëm me anë të mikroskopit. **PO JO**
- Qelizat e kanë rolin ndërtues të një organizmi sikur pjesët e materialit ndërtues të një shtëpie. **PO JO**
- Në mes qelizave bimore, shtazore dhe bakteriale, në aspektin ndërtimor, nuk ka dallime. **PO JO**
- Të gjitha bimët dhe shtazët janë organizma shumëqelizorë. **PO JO**

8



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Vërtetimi në mikroskop

Përgatitet preparati. Mjetet që na duhen, janë: mikroskopi, xhami i objektit, xhami mbulues, qepë, ujë, një pipetë dhe një brisk.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënës:

Diskutim i njohurive

Pas vërtetimit në mikroskop të qelizës së qepës kërkohet nga nxënësit:

- Ta vizatojnë në fletore qelizën që kanë vërtetuar.
- Ta përshkruajnë këtë qelizë dhe ta komentojnë së bashku me shokët e klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi vlerësohet për saktësinë e vizatimit të qelizës bimore, emërtimit të organeleve qelizore dhe prezantimit të tyre.

Detyrë:

(Në orën e ardhshme, marrin materiale ricikluese për punë praktike në klasë)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 1, III. 1, 5, IV. 3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje - qeliza

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërtojnë organelet qelizore nga modelet e ndërtuara dhe e tregojnë funksionin e tyre;
- Vlerësojnë funksionin e qelizës për qeniet e gjalla.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, mjete ricikluese për punë në grupe, modele qelizash.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Fizikë, Jeta dhe Puna, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Analiza e tipareve semantike

Shpërndahen fletë të bardha A4, ku është e vizatuar tabela për t'i analizuar tiparet semantike. Vendosin shenjën “V” në vendin përkatës.

1.1. Organizmat e gjallë përbëhen prej qelizës

Çfarë është një qelizë? Në vitin 1665, naturalisti anglez, **Robert Huku**, me mikroskopin e tij të thjeshtë, në prerjen e hollë të tapës, për herë të parë vërejtí disa dhomëza të ngjashme me hojet e bletëve, të cilat i quajti celula (qeliza). Qelizat rëndom janë të vogla, mikroskopike, por ka përjashtime. Për t'i parë ato, do t'ju duhet një mikroskop.

1.1.1. Struktura dhe funksioni i qelizës


Një organizëm është i përbërë nga pjesë të vogla të gjalla, që quhen qeliza. Ato kanë forma të ndryshme. Organizmi është me të vërtetë si një shtëpi e përbërë nga pjesë të ndryshme si tulla, hekur, dru, tjegulla, xhama etj. Çdo njëra prej tyre është e ndërtuar në mënyrë të veçantë dhe kryen një punë të veçantë, kështu që shtëpia bëhet funksionale. Format e qelizave varen, kryesisht, nga funksionet e tyre, por edhe nga veçndodhja e tyre në krahasim me qelizat e tjera. Të gjitha qelizat përbëhen prej membranës, citoplazmës dhe materialit bërthamor.

Të gjitha qelizat bimore e shtazore kanë strukturën e mëposhtme:

Membrana. Qeliza është e mbështjellë me membranë. Ajo është një shtresë shumë e hollë, e cila rregullon hyrjen ose largimin e materieve.

Citoplazma. Brenda membranës qelizore ndodhet citoplazma, e cila është një masë gjysmë e lëngët, e pangjyrë, e tejdukshme, me veti ngjitëse, në të cilën ndodhen organelet të ndryshme, të cilat kryejnë të gjitha aktivitetet e qelizës (shih figurën në faqen tjetër).

Bërthama. Çdo qelizë ka bërthamën, për të kontrolluar aktivitetet e qelizës. Nëse bërthama ndahet prej qelizës, ajo vdes. Nga citoplazma bërthama është e ndarë me mbështjellësin e saj. Bërthama është e mbushur me plazmën bërthamore, në të cilën ka një ose më shumë bërthamëza dhe kromozome. Forma dhe madhësia e bërthamës është e llojllojshme. Rëndom në një qelizë gjendet vetëm një bërthamë, por ka edhe qeliza të tilla që kanë disa.



Qeliza bimore

Të dyja qelizat, ajo e bimëve dhe ajo e shtazëve, kanë të tri pjesët e përkrahura më lart, por qelizat e bimëve kanë strukturë shtesë.

Muri qelizor është i përbërë nga një lëndë kimike e veçantë e quajtur celulozë. Muri qelizor luan rol në përcaktimin e formës së qelizës dhe në qatullimin e lëndëve të ndryshme organike dhe joorganike në mësht qelizave në saj të prezencës së porenëve të tyre.

Vakuola është strukturë në formë të një geseje. Roli i saj është në depozitimin e lëngut qelizor, në ruajtjen e substancave të mjetëve (të panevojshme), ose dhenien e ngjyrës së qelizave, p.sh.: ngjyra e kuqe epanxharit.

Kloroplastet janë strukturë me ngjyrë të gjelbër, që vijnë nga pigmenti i quajtur klorofil dhe marrin pjesë në procesin e fotosintezës. Ato nuk gjenden në çdo qelizë bimore, por ka shumë në qeliza të gjethëve.

Qeliza shtazore

Qeliza shtazore përmban një organelë të veçantë - **centriolën**.

1.1.2. Organizmat njëqelizorë

Të gjitha bimët dhe shtazet janë organizma shumëqelizorë dhe e kanë bërthamën të diferencuar. Ka organizma një dhe shumëqelizorë në kuadër të grupit të protistëve dhe kërpudhave, të cilët kanë bërthamën e diferencuar nga citoplazma dhe quhen **eukariote**. Bakteret dhe algat e kaltra në të gjelbër janë organizma njëqelizorë me një strukturë shumë të thjeshtë. Keto nuk e kanë bërthamën të diferencuar, materiali bërthamor është në citoplazmë dhe jo në bërthamë të veçantë, prandaj quhen **prokariote**.

Struktura e qelizave bimore, shtazore dhe bakteriale	Strukturat e veçanta të qelizës shtazore	Strukturat e veçanta të qelizës bimore	Strukturat e veçanta të qelizës bakteriale
Membrana qelizore			
Muri qelizor		V	
Kapsula			
Membrana plazmatike			
Mitokondriet			
Kloroplasti			
Flagjeli			V
Centriola			
Ribozomi			
Lizozomi			



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes


Veprimtari praktike me karakter krijes

Nxënësit janë ndarë në grupe një orë më parë. U është kërkuar të marrin me vete mjete ricikluese.

Detyra është paraqitja praktike e një modeli të qelizës.

U jepet kohë 20-25 minuta.

Mësimdhënësi e mbikëqyr punën e grupeve.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:

Turi i galerisë

Zgjidhet një përfaqësues i grupit nga mësimdhënësi, për ta prezantuar punën e ekipore.

Prezanton praktikisht modelin e qelizës së paraqitur, dallon organelet qelizore në qelizë dhe tregon funksionin e tyre.

Modelet ekspozohen në një kënd të klasës, nxënësit e tjerë e kanë mundësinë t'i shikojnë punimet e grupeve të tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e demonstrimit të modeleve të qelizave të ndërtuara, emërtimit të organeleve qelizore dhe interpretimit të funksionit të organeleve qelizore.

Detyrë:

(Plotësojnë fletore pune, faqe 5-6.)

Reflektim për veprimtarinë e orës mësimore:

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2. 6, II. 1, III. 3. 4, IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qelizat japin indet, organet dhe sistemet e organeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan nivelet e organizimit të trupit të njeriut dhe të bimëve;
- Dallon llojet e ndryshme të indeve, organeve dhe sistemeve të organeve;
- Analizon se si nivelet e organizimit janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlase, foto ilustruese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Fizikë, Kimi, Gjuhë dhe komunikim.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Shpjegim i përparuar

Vendosen para nxënësve disa modele të qelizave, organeve dhe sistemeve të organeve. Shpjegohet lidhja që kanë në mes tyre, qeliza është njësia më e vogël ndërtuese e organizmave të gjallë. Qeliza ndërton indet, indet e njëjta me funksion të njëjtë formojnë organin dhe organet e ndryshme me funksion të njëjtë formojnë sistemet e organeve dhe, të gjitha sistemet bashkë, e formojnë organizmin.


1. 2. QELIZAT JAPIN INDET → ORGANET → ORGANIZMIN

Çka i mundëson një organizmi (trupit) t'i kryejë të gjitha proceset e ndryshme të jetës në të njëjtën kohë?


Indet janë grupe qelizash, që duken njësoj, kanë ndërtim të njëjtë, origjinë të njëjtë dhe kryejnë një funksion të njëjtë në organe. P.sh., në organizmin tonë, qelizat e indeve, që përbëjnë muskujt kontraktues të zemrës, apo qelizat e kuqe të gjakut, që marrin dhe bartin oksigjenin. Ndërsa te bimët, p.sh., qelizat e indit mbrojtës të tapës kanë ndërtim të njëjtë, origjinë të njëjtë dhe kryejnë një funksion të njëjtë të vetëm mbrojtës.

Organet. Numër i caktuar indesh përbën një organ. Çdo ind ka ndërtim dhe funksion të caktuar, por të gjitha së bashku veprojnë si një tërësi e pandarë dhe kryejnë funksione, që janë tipike për atë organ. Kështu, kërcelli është një organ i përbërë prej disa indeve, por të gjitha së bashku ndihmojnë në qëndrimin e drejtë të bimës, transportimin e ujit e të lëndëve minerale dhe bartjen e tyre në organet e tjera të bimës. Gjithashtu, njëra prej organeve tona, p.sh., zemra, përbëhet nga katër tipa indeve, të cilët mundësojnë kontraktimin e këtij organi dhe pompimin e gjakut.

Organizmi (trupit). Një organizëm duhet të jetë kompleks për të kryer të gjitha proceset jetësore të nevojshme për të mbijetuar. Organizmi përbëhet prej organeve. Secili kryen një funksion të rëndësishëm. Organet shpesh vendosen në **sisteme të organeve**, të cilat kryejnë funksione të caktuara.




Qelizat japin indin → organin → sistemin e organeve → organizmin



Si funksionon një sistem i organeve?

Psh., kur e futni ushqimin në gojë, prodhoni pësstymë, në mënyrë që ju ta zbutni ushqimin dhe ta gëlltini atë. Pësstyma ndihmon që ushqimi të shkojë në lukt. Në lukt, ushqimi ndryshohet përsëri dhe, si i tillë, përcillet në zorrë të hollë, ku i nënshtrohet një ndryshimi edhe më të madh. Nga zorra e hollë përthithen lëndët ushqyese të tretura në ushqim, ndërsa përmes zorrës së trashë largohen mbetjet e panevojshme. Ky është **sistemi i tretjes**.

Sistemi i qarkullimit të gjakut. Ky transporton të gjitha lëndët e tretshme të përthithura nga zorrët nëpër trup. Zemra pompon gjakun që qarkullon në enët e gjakut, në artere dhe vena. Bimët, ujin dhe lëndët ushqyese minerale i thithin nga dheu dhe përmes enëve të veçanta të tufës përcuese (ksilemës) të **sistemit përcues** i bartin në të gjitha pjesët e bimës, ndërsa lëndët organike që i krijojnë vetë përmes procesit të fotosintezës në gjethe i bartin në pjesët e tjera përmes enëve të tjera të veçanta (floemës).




Sistemi i tretjes te njeriut



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Lexojnë njësinë mësimore përreth 10-12 minuta. Pas leximit krijojnë skicë në fletoret e tyre për njësinë mësimore.

Në secilën skicë shkruajnë nga një koncept dhe i zgjerojnë informacionet për konceptin.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Shënime mbi shënime

Ndaj nxënësit në dyshe.
Nxënësit i lidhin treguesit me njëri-tjetrin.
Treguesi (kategoria) 1 është ideja kryesore: organizmi, treguesi 2 është përpunim i treguesit 1, treguesi 3 është përpunim i treguesit 2.

Shembull si mund ta ndërtojnë nxënësit:

1. Organizmi
 2. Sis. e organeve
 3. Sis. nervor, muskolor, eshtror.
 2. Indi
 3. Muskolor, nervor, i zemrës, lidhor
2. Qeliza
 3. Bimore, shtazore, bakteriale, ekuariote, prokariote

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të niveleve të organizimit në trupin e njeriut dhe të bimëve.

Detyrë:

Reflektim për vejedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan organizimin shkallë-shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi dhe biosfera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 6, II. 1. 6, III. 7, IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sistemet e organeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton sistemet e organeve;
- Dallon organet që marrin pjesë në ndërtimin e këtyre sistemeve;
- Përcakton funksionin e të gjitha sistemeve të organeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlas, foto ilustruese, modele të ndryshme të sistemeve të organeve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Jeta dhe puna, Kimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Vendoset para nxënësve disa modele të sistemeve të organeve. Kërkohet nga ta që t'i identifikojnë organet që i njohin tashmë.

Parashtrihen pyetjet:


- Cilat organe i njihni?
- Çfarë funksioni kanë?




Si funksionon një sistemi i organeve?

P.sh., kur e futni ushqimin në gojë, prodhoni pështymë, në mënyrë që ju ta zbutni ushqimin dhe ta gëlltitni atë. Pështyma ndihmon që ushqimi të shkojë në lukth. Në lukth, ushqimi ndryshohet përsëri dhe, si i tillë, përcillet në zorrë të hollë, ku i nënshtrohet një ndryshimi edhe më të madh. Nga zorra e hollë përrhithen lëndët ushqyese të tretura në ushqim, ndërsa përmes zorrës së trashë largohen mbetjet e panevojshme. Ky është **sistemi i tretjes**.

Sistemi i qarkullimit të gjakut. Ky transporton të gjitha lëndët e tretshme të përthithura nga zorrët nëpër trup. Zemra pompon gjakun që qarkullon në e nët e gjakut, në arterie dhe vena. Bimët, ujin dhe lëndët ushqyese minerale i thithin nga dheu dhe përmes enëve të veçanta të tufës përçuese (ksilemës) të **sistemit përçues** i bartin në të gjitha pjesët e bimës, ndërsa lëndët organike që i krijojnë vetë përmes procesit të fotosintezës në gjethe i bartin në pjesët e tjera përmes enëve të tjera të veçanta (floemës).



Sistemi i tretjes të njeriut



Sistemi i qarkullimit të gjakut te njeriu dhe sistemi i qarkullimit të ujit te bima

Sistemi i frymëmarrjes përbëhet nga organet që shërbejnë për të furnizuar qelizat me oksigjen dhe për të hequr dyoksidin e karbonit, p.sh.: mushkëritë në gjitarë, vezrat në peshq. Gjethet e bimëve kanë të njëjtin funksion.

Sistemi sekretues. Mbetjet e prodhuara nga qelizat largohen nga trupi. Mbetjet të larguara nëpërmjet organeve janë urina, që largohet nga veshkat, dyoksidi i karbonit nga mushkëritë dhe djersa nga lëkura. Bimët heqin toksinat, mbetjet e ndryshme përmes gjethëve, sidomos kur hedhin gjethet në vjeshtë.

Sistemi nervor kontrollon reagimet e organizmit ndaj ngacmimeve, ku përfshih trurin dhe nervat. Bimët nuk kanë diçka të tillë, por kanë zona të ndryshme, p.sh., orientimin e kërceljeve dhe gjethëve në drejtim të rrezeve të diellit.

Sistemi eshtror (skeletor). Ky sistem te ne dhe te shtazet përbehet nga eshtrat për mbështetje dhe lëvizje. Kurse bimët kanë indet mbështetëse (mekanike), që ua japin mbështetjen, fortësinë dhe elasticitetin.

Sistemi muskuloz. Muskujt e trupit janë të ndarë në tri lloje kryesore: skeletorë, të butë dhe të zemrës. Muskujt skeletorë janë të lidhur me skeletin dhe lëvizin pjesë të ndryshme të trupit.

Përgjigjet e mundshme të nxënësve:

- Zemra, mushkëritë, lukthi, zorrët etj.
- Zemra pompon gjakun.
- Lukthi e tret ushqimin që ne hamë.
- Mushkëritë na shërbejnë për frymëmarrje.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditarii trepjesësh

Lexojnë njësinë mësimore për 10 min.

Gjatë leximit e plotësojnë ditarin trepjesësh. Sipër i shkruajnë konceptet dhe në tabelën poshtë i sqarojnë konceptet përkatëse.

Shembull se si mund të përgjigjen nxënësit:

Sistemet e organeve	Ndërtimi	Funksioni
<ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i frymëmarrjes - Sistemi nervor - Sistemi i qarkullimit të gjakut 	Mushkëritë, trakeja	Shkëmbimin e oksigjenit



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:
Rishikimi në dyshe

Nxënësit organizohen në dyshe: detyra e tyre është të diskutojnë, të shkëmbejnë mendime dhe t'u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në pjesën e dytë të orës mësimore. Po ashtu, paqartësitë plotësohen edhe me ndihmën e mësimdhënësit. Më pas nga një përfaqësues për çdo grup i tregon para nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit të grupit të tyre duke shkëmbyer ide, mendime dhe pyetje me dyshet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e emërtimit të sistemeve të organeve, identifikimit të organeve që i ndërtojnë këto sisteme dhe funksionin e tyre.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletore pune, faqe 9-10)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënës të temës: Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe të shtazëve (p.sh., invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdor këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh., invertebrorët-arthropodat-insektet; vertebrorët-gjitarët-primatët; bimët me farë-bimët me lule-bimët barishtore).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 2, 3, II. 6, III. 5, IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Karakteristikat e organizmit

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Tregon karakteristikat e gjallesave;
- Vlerëson rëndësinë e këtyre karakteristikave për qeniet e gjalla.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlaset, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit

[LINK](#)

Shënohet një koncept në mes të tabelës duke i lënë nxënësit për pak minuta t'i renditin lidhjet për këtë koncept.

1.3. KARAKTERISTIKAT E ORGANIZMIT

1.3.1. Çfarë është jeta?

Në fotografinë poshtë mund të shihni: shkëmbinj, lisa, një livadh, disa kafshë, retë, dheun etj. Për cilat themi që jetojnë?



Një peizazh

1.3.1. Çfarë është një organizëm?

Organizmi nënkupton një trup të veçantë të ndërtuar nga qelizat ku kryhen proceset jetësore. Organizmat e gjallë, qofshin njëqelizorë apo shumëqelizorë, kryejnë proceset themelore jetësore, siç janë: rritja, reagimi ndaj mjedisit të jashtëm, shumimi, ushqimi, frymëmarrja, lëvizja, sekretimi etj. Këto procese mundësojnë mbajtjen gjallë të organizmit. Organizmat pas një kohe ndërpresin proceset jetësore dhe vdesin.

Te qeniet e gjalla dallohen disa karakteristikat të veçanta. Proceset jetësore që e karakterizojnë një organizëm gjatë jetës së tij janë:

Frymëmarrja. Organizmat kanë nevojë për oksigjen, për të djegur ushqimin që e marrin. Gjatë djegies, lirohet dyoksidi i karbonit dhe uji. Ata marrin energjinë, e cila lirohet nga djegia e ushqimit.




Rritja. Organizmat rriten dhe kanë nevojë për materie ndërtimi. Bimët vazhdojnë të rriten gjatë gjithë jetës së tyre, ndërsa shtazët shpesh kanë një madhësi përfundimtare në një moshë të caktuar.

Lëvizja. Shumica e organizmave kanë aftësitë e tyre të lëvizjes. Shtazët lëvizin tërë trupin e tyre, ndërsa bimët mund të lëvizin vetëm pjesë të trupit të tyre, p.sh.: orientimi i lulës ose i gjetheve drejt diellit është një lloj lëvizjeje.

Riprodhimi. Organizmat mund të shumëfishohen, sepse kanë aftësi për të prodhuar pasardhës. Organizmat e vjetër vdesin, por mbijetesat e llojeve sigurohet duke u zëvendësuar nga pasardhësit.


Ndjeshmëria. Aftësia e organizmave për t'iu përgjigjur ndryshimeve në mjedisin rrethues. Bimët, p.sh., rriten në drejtim të burimit të dritës, ndërsa shtazët ikin kur ngacmohen ose kur shohin ndonjë grabitqar.



Shtazët duke ikur nga grabitqari

Sekretimi është aftësia e organizmave për të larguar materiet e panevojshme (mbetjet) nga organizmi. Sekretimi te njeriu dhe shtazët përfshin gazrat (dyoksidin e karbonit), urinën dhe ujin në formë djese. Bimët nxjerrin toksina, dyoksidin e karbonit, avull uji etj., nga gjetheet e tyre.

Në fletët A4, nxënësit duhet t'i paraqesin mendimet e tyre në këtë mënyrë. Nxënësit bashkëveprojnë për t'i shkëmbyer njohuritë ashtu edhe për ta zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi konceptin. Në fund ata duhet të shënojnë një përkufizim për konceptin.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Lexim i drejtuar

Njësia mësimore lexohet pjesë-pjesë dhe diskutohet pas çdo leximi.

Lexohet pjesa e parë: Çfarë është një organizëm?

Komentohet nga nxënësit dhe mësimdhënësi.

Diskutimi nxitet nga pyetjet:

- Çfarë është një organizëm?
- Cilat janë karakteristikat e organizmave të gjallë?

Nxënësi tjetër lexon "Frymëmarrja".

Mësimdhënësi parashtron pyetjet:

- Çfarë është frymëmarrja?
- Cili është reaksioni i frymëmarrjes?
- Pse është e rëndësishme frymëmarrja tek organizmat?

Nxënësi tjetër lexon "Rritja"

Mësimdhënësi: Si rriten organizmat?

Vazhdon në të njëjtën mënyrë edhe me pjesët e tjera.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Ndaj nxënësit në dyshe. Kërko nga ta që në mënyrë të strukturuar me anë të skicave ta paraqesin njësinë mësimore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të karakteristikave të qenieve të gjalla dhe e argumenton rëndësinë e këtyre karakteristikave për organizmat.

Detyrë:

(Plotësojnë fletore pune, faqe 11)

● *Reflektim përvojës dhe orës mësimore:*

● _____

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Identifikon rregullat themelore të emërimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla. - Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 2. 4, II. 1. 6, III. 1. 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sistematika - Klasifikimi i organizmave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan klasifikimin e botës së gjallë në kohën e hershme;
- Përshkruan klasifikimin sipas Aristotelit;
- Analizon rëndësinë e shkencës së sistematikës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlase, foto ilustruese, laptopi, projektori.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Jeta dhe puna, Gjeografi.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Imagjinatë e drejtuar

Vendos një foto ilustruese ose në projektor, ku paraqiten disa organizma të gjallë. Kërkohe nga nxënësit të imagjinojnë dhe t'i klasifikojnë organizmat.



1.4. SISTEMATIKA - KLASIFIKIMI I ORGANIZMAVE

Çka studion sistematika?

Sistematika është shkencë që merret me studimin e klasifikimit të organizmave të gjallë bazuar në afërsitë e tyre farefisnore, si dhe me klasifikimin e tyre në kategori sistematike. Qysh nga kohët e lashta, njeriu ka jetuar me natyrën dhe ka qenë i interesuar t'i grupojë llojet sipas ngjashmërive që kanë. Klasifikimet e para bazoheshin në vlera mjekësore, ekonomike ose në veçori të tjera të llojeve (u quajtën sisteme artificiale të klasifikimit) dhe nuk merrnin parasysh prejardhjen e as lidhjen gjenetike (farefisnore) midis gjallesave. Në klasifikimet e hershme, gjallesat ndaheshin në dy grupe:

- a) të dobishme dhe
- b) të dëmshme për njeriun.

Klasifikimi i parë i rëndësishëm i gjallesave (edhe pse pa ndonjë kriter të mirëfillt shkencor) u bë nga Aristoteli, rreth 2000 vjet më parë. Ai i ndau gjallesat në dy grupe të mëdha: **bimë dhe shtazë**. **Bimët** i ndau në tri grupe: bimët me trung të lartë - **drunore**; bimët me trung të shkurtër - **shkurrore** dhe bimët e vogla me kërcell të butë - **barishtore**. Shtazët gjithashtu i ndau në tri grupe: ato që jetojnë në ujë - **ujore**, në tokë - **tokësore** dhe në ajër - që **fluturojnë**. Ky klasifikim u përdor shumë shekuj, por me kalimin e kohës u bë i papërdorshëm, sepse vazhdimisht zbuloheshin dhe përshkruheshin gjallesa të reja.

Për emërtimin e llojeve bimore dhe shtazore, janë përdorur emërtime të ndryshme në gjuhën përkatëse, madje edhe në të njëjtën gjuhë për një lloj të caktuar janë përdorur emra të ndryshëm. P.sh., mjekët e popujve të ndryshëm kanë përdorur emërtime të ndryshme për bimët mjekuese, prandaj kur është propozuar një bimë për mjekim, nuk është ditur se për cilën bimë bëhet fjalë. Ky konfuzion në emërtimin e llojeve ka bërë të krijohet një sistem i përbashkët për emërtimin e llojeve.



Karl Linné

1.4.1. Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore

Nga parregullsia e emërimit të gjallesave ndër shekuj është ndier nevoja që të formohet një sistem, ku gjallesave do t'u jepeshin emrat e përbashkët ndërkombëtarë. Natyralisti suedez, **Karl Linné (Carl Linné)**, në vitin 1735, vuri bazën e klasifikimit modern të llojeve. Të gjitha llojeve u dha dy emra latinisht - sistemi i dyfishtë (**binomial**) i emërimit. Emri i gjinisë është i pari, ndërsa emri i dytë është i llojit.

1.4. SISTEMATIKA - KLASIFIKIMI I ORGANIZMAVE

Çkastudion sistematika?

Sistematika është shkencë që merret me studimin e klasifikimit të organizmave të gjallë bazuar në afërsitë e tyre farefisnore, si dhe me klasifikimin e tyre në kategori sistematike. Qysh nga kohët e lashta, njeriu ka jetuar me natyrën dhe ka qenë i interesuar t'i grupojë llojet sipas ngjashmërive që kanë. Klasifikimet e para bazoheshin në vlera mjekësore, ekonomike ose në veçori të tjera të llojeve (u quajtën sisteme artificiale të klasifikimit) dhe nuk merrnin parasysh prejardhjen e as lidhjen gjenetike (farefisnore) midis gjallesave. Në klasifikimet e hershme, gjallesat ndaheshin në dy grupe:

- a) të dobishme dhe
- b) të dëmshme për njeriun.

Klasifikimi i parë i rëndësishëm i gjallesave (edhe pse pa ndonjë kriter të mirëfilltë shkencor) u bë nga Aristoteli, rreth 2000 vjet më parë. Ai i ndau gjallesat në dy grupe të mëdha: **bimë dhe shtazë**. **Bimët** i ndau në tri grupe: bimët me trung të lartë - **drunore**; bimët me trung të shkurtër - **shkurrore** dhe bimët e vogla me kërcell të butë - **barishtore**. Shtazët gjithashtu i ndau në tri grupe: ato që jetojnë në ujë - **ujore**, në tokë - **tokësore** dhe në ajër - që **fluturojnë**. Ky klasifikim u përdor shumë shekuj, por me kalimin e kohës u bë i papërdorshëm, sepse vazhdimisht zbuloheshin dhe përshkruheshin gjallesa të reja.

Për emërtimin e llojeve bimore dhe shtazore, janë përdorur emërtime të ndryshme në gjuhën përkatëse, madje edhe në të njëjtën gjuhë për një lloj të caktuar janë përdorur emra të ndryshëm. Psh., mjekët e popujve të ndryshëm kanë përdorur emërtime të ndryshme për bimët mjekuese, prandaj kur është propozuar një bimë për mjekim, nuk është ditur se për cilën bimë bëhet fjalë. Ky konfuzion në emërtimin e llojeve ka bërë të krijohet një sistem i përbashkët për emërtimin e llojeve.



Karl Linnaeus

1.4.1. Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore

Nga parregullsia e emërimit të gjallesave ndër shekuj është ndër nevojë që të formohet një sistem, ku gjallesave do t'u jepeshin emrat e përbashkët ndërkombëtarë. Natyralisti suedez, **Karl Linnaeus (Carl Linné)**, në vitin 1735, vuri bazën e klasifikimit modern të llojeve. Të gjitha llojeve u dha dy emra latinisht - sistemi i dyfishtë (**binomial**) i emërimit. Emri i gjinisë është i pari, ndërsa emri i dytë është i llojit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Sistemi ndërveprues i shënimeve

Lexojnë njësinë mësimore. Pastaj, nxënësit duhet ta plotësojnë tabelën me shenjat përkatëse në bazë të informacioneve që gjetën gjatë lëximit.

“√” - kur informacioni pohon atë çka dini.

“+” - kur një pjesë e informacionit është e re për ju.

“-“ - kur informacioni është në kundërshtim me atë që dini ju ose mendoni se e dini.

“?” - kur ka informacion që është i paqartë ose doni të dini më shumë për të.

√	+
Ndahen në bimë dhe shtazë, njeri.	Të dobishme dhe të padobishme. Drunore, shkurrore, barishtore.
-	?
Ndahen në bimë dhe shtazë.	Si klasifikohen sot?



Përforsimi: Konsolidimi i të nxënës:

Diskutim në grup

Nxënësit organizohen në grupe me nga 4-5 nxënës: detyra e tyre është të diskutojnë, shkëmbejnë mendime dhe u japin përgjigje paqartësive që shënuan në tabelën e tyre në pjesën e dytë të orës. Po ashtu, paqartësitë plotësohen edhe me ndihmën e mësimdhënësit. Më pas, nga një përfaqësues për çdo grup u tregon nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit të gjallesave dhe gjykimit të rëndësisë së sistematikës si lëndë shkencore.

Detyrë:

• Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Identifikon rregullat themelore të emërimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla.

Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, 4, II. 1, 6, III. 1, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan klasifikimin sipas Karl Lineut dhe e përcakton nomenklaturën binomiale;
- Jep shembuj të klasifikimit të gjallesave sipas klasifikimit binomial.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlaset, foto ilustruese, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Ekologjia dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjeografia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Parashitrohen pyetjet para nxënësve:

- Çka studion sistematika?
- Si është bërë klasifikimi i gjallesave në kohët e lashta?
- Si i klasifikoj Aristoteli gjallesat?
- Çfarë mendoni, vlen edhe sot ky klasifikim i gjallesave?

Disa përgjigje të mundshme të nxënësve:

- Sistematika i klasifikon organizmat në bazë të afërsisë farefisnore.

1.4. SISTEMATIKA - KLASIFIKIMI I ORGANIZMAVE

Çka studion sistematika?

Sistematika është shkencë që merret me studimin e klasifikimit të organizmave të gjallë bazuar në afërsitë e tyre farefisnore, si dhe me klasifikimin e tyre në kategori sistematike. Qysh nga kohët e lashta, njeriu ka jetuar me natyrën dhe ka qenë i interesuar t'i grupojë llojet sipas ngjashmërive që kanë. Klasifikimet e para bazoheshin në vlera mjekësore, ekonomike ose në veçori të tjera të llojeve (u quajtën sisteme artificiale të klasifikimit) dhe nuk merrnin parasysh prejardhjen e as lidhjen gjenetike (farefisnore) midis gjallesave. Në klasifikimet e hershme, gjallesat ndaheshin në dy grupe:

- të dobishme dhe
- të dëmshme për njeriun.

Klasifikimi i parë i rëndësishëm i gjallesave (edhe pse pa ndonjë kriter të mirëfillt shkencor) u bë nga Aristoteli, rreth 2000 vjet më parë. Ai i ndau gjallesat në dy grupe të mëdha: **bimë dhe shtazë**. Bimët i ndau në tri grupe: bimët me trung të lartë - **drunore**; bimët me trung të shkurtër - **shkurrore** dhe bimët e vogla me kërcell të butë - **barishtore**. Shtazët gjithashtu i ndau në tri grupe: ato që jetojnë në ujë - **ujore**, në tokë - **tokësore** dhe në ajër - që **fluturojnë**. Ky klasifikim u përdor shumë shekuj, por me kalimin e kohës u bë i papërdorshëm, sepse vazhdimisht zbuloheshin dhe përshkruheshin gjallesa të reja.

Për emërtimin e llojeve bimore dhe shtazore, janë përdorur emërtime të ndryshme në gjuhën përkatëse, madje edhe në të njëjtën gjuhë për një lloj të caktuar janë përdorur emra të ndryshëm. P.sh., mjekët e popujve të ndryshëm kanë përdorur emërtime të ndryshme për bimët mjekuese, prandaj kur është propozuar një bimë për mjekim, nuk është ditur se për cilën bimë bëhet fjalë. Ky konfuzion në emërtimin e llojeve ka bërë të krijohet një sistem i përbashkët për emërtimin e llojeve.




Karl Linné

1.4.1. Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore

Nga parregullsia e emërimit të gjallesave ndër shekuj është ndier nevoja që të formohet një sistem, ku gjallesave do t'u jepeshin emrat e përbashkët ndërkombëtarë. Natyralisti suedez, **Karl Linné (Carl Linné)**, në vitin 1735, vuri bazën e klasifikimit modern të llojeve. Të gjitha llojeve u dha dy emra latinisht - sistemi i dyfishtë (**binomial**) i emërimit. Emri i gjinisë është i pari, ndërsa emri i dytë është i llojit.

Kështu, për shembull, manaferra dhe mjedra janë shumë të ngjashme, por ato janë lloje të ndryshme e që i takojnë një gjinie. Në gjuhën shkencore dardhë e egër shënohet (**Pyrus pyrastrer**), ndërsa dardhë e butë (**Pyrus domestica**). Po ashtu, kullumbria (**Prunus spinosa**) dhe qershia (**Prunus avium**), i takojnë së njëjtës gjinie, por janë lloje të ndryshme. Këto gjini (**Pyrus** dhe **Prunus**) kanë disa karakteristika të ngjashme dhe i takojnë së njëjtës familje trëndafillore (**Rosaceae**). Lineu të njëjtin veprim e kabërdë dhe për shtazët.

Në sistemin hierarkik të klasifikimit biologjik, **llojet e afërta** grupohen në **gjini**, gjinitë e afërta grupohen në **familje**, familjet e afërta grupohen në **rendë**, rendet e afërta në **klasë**, klasat e afërta në **tipa**, kurse tipat (ndajet) e afërta në grupe të mëdha gjallesash apo mbretëri. Ky sistem klasifikimi është natyror dhe bazohet në prejardhjen dhe lidhjen gjenetike mes llojeve. *Njësi themelore në sistematikë është lloji.* Lloji - përfshin një grup organizmash të ngjashëm mes vete dhe të afërta për t'u mbarështuar dhe për të dhënë pasardhës pjellorë.



Llojet e afërta në gjini të njëjtë, gjinitë e afërta në familje të njëjtë.

23

- Klasifikimi më herët ka qenë: të dobishme dhe të dëmshme, kurse më vonë Aristoteli i klasifikoi në bimë (drunore, shkurre dhe barishtore) dhe shtazë (ajrore, tokësore dhe ujore).
- Jo, sot klasifikimi bëhet në bazë të afërsisë farefisnore, taksonomisë që e ka dhënë Karl Lineu.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Analiza e tipareve semantike

Lexojnë njësinë mësimore për 10 min.

Ndërtojnë një tabelë në fletore, ku mësimdhënësi zgjedh kategori konceptesh që duhen analizuar.

Kërkohet nga nxënësit që gjatë leximit ta plotësojnë tabelën, duke e klasifikuar një organizëm bimor dhe një shtazor në bazë të klasifikimit të Karl Lineut.

	Majmuni	Qershia
Mbretëria		
Tipi		
Klasa		
Rendi		
Familja		
Gjinia		
Lloji		



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:

Diskutim i përbashkët

Pasi nxënësit ta kenë plotësuar tabelën, ftohen për diskutim lidhur me sqarimet e klasifikimeve sipas Lineut. Mësimdhënësi paraqet në ekran modele fotosh të printuara të shembujve të ndryshëm të klasifikimeve. Jep sqarime shtesë nëse nxënësit nuk e kanë plotësuar saktë tabelën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e kryerjes së detyrës për klasifikimin e organizmave në bazë të klasifikimit të Karl Lineut.

Detyrë:

(Pyetje-përgjigje, faqe 24 (libri bazë))

● Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 10

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Përdor çelësa të thjeshtë dikotomikë për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë.

Ndjek rregullat e sigurisë gjatë aktiviteteve në natyrë dhe punës në terren. - Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lumë, pyll, livadh etj.) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 2. 3. 6, II. 1. 6, III. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje - (Sistematika - Klasifikimi i organizmave)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Jep shembuj të klasifikimit të gjallesave në bazë të Karl Lineut;
- Argumenton rëndësinë e sistematikës për lëndën e biologjisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, foto ilustruese, atlaset.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Jeta dhe puna, Kimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Plotësojmë së bashku me nxënësit fletore pune me ndihmën e librit bazë.

1.3. SISTEMATIKA - KLASIFIKIMI I ORGANIZMAVE

1. Plotësoji fjalitë me shprehjet përkatëse, duke u bazuar në librin bazë.

- Sistematika është shkencë që merret me studimin _____ bazuar në afërsitë e tyre _____, si dhe me klasifikimin e tyre në kategori _____.
- Klasifikimet e hershme, gjallesat i ndanin në dy grupe:
 - _____.
 - _____.
- Klasifikimi i parë i rëndësishëm i gjallesave u bë _____ rreth _____ vjet më parë.
- Aristoteli i ndau gjallesat në dy grupe të mëdha: _____ dhe _____.
- Klasifikimin e gjallesave në baza shkencore për herë të parë e ka bërë natyralisti suedez _____, në vitin _____.

2. A janë këto pohime të sakta?

- Klasifikimi i gjallesave bazohet në tiparet e rëndësishme, siç janë lidhjet farefisnore dhe prejardhja e tyre. **PO JO**
- Bazën e klasifikimit modern e vuri Çarls Darvini. **PO JO**
- Në bazë të klasifikimit shkencor, të gjitha llojeve u jepen dy emra latinisht. Emri i parë është i gjinisë, ndërsa i dyti ai i llojit. **PO JO**
- Njësi themelore në sistematikë është gjinia. **PO JO**

1.3. SISTEMATIKA - KLASIFIKIMI I ORGANIZMAVE

1. Plotësoji fjalitë me shprehjet përkatëse, duke u bazuar në librin bazë.

- Sistematika është shkencë që merret me studimin _____ bazuar në afërsitë e tyre _____, si dhe me klasifikimin e tyre në kategori _____.
- Klasifikimet e hershme, gjallesat i ndanin në dy grupe:
 - _____.
 - _____.
- Klasifikimi i parë i rëndësishëm i gjallesave u bë _____ rreth _____ vjet më parë.
- Aristoteli i ndau gjallesat në dy grupe të mëdha: _____ dhe _____.
- Klasifikimin e gjallesave në baza shkencore për herë të parë e ka bërë natyralisti suedez _____, në vitin _____.

2. A janë këto pohime të sakta?

- Klasifikimi i gjallesave bazohet në tiparet e rëndësishme, siç janë lidhjet farefisnore dhe prejardhja e tyre. **PO JO**
- Bazën e klasifikimit modern e vuri Çarls Darvini. **PO JO**
- Në bazë të klasifikimit shkencor, të gjitha llojeve u jepen dy emra latinisht. Emri i parë është i gjinisë, ndërsa i dyti ai i llojit. **PO JO**
- Njësi themelore në sistematikë është gjinia. **PO JO**

1.4. SISTEMATIKA - KLASIFIKIMI I ORGANIZMAVE

Çkastudion sistematika?

Sistematika është shkencë që merret me studimin e klasifikimit të organizmave të gjallë bazuar në afërsitë e tyre farefisnore, si dhe me klasifikimin e tyre në kategori sistematike. Qysh nga kohët e lashta, njeriu ka jetuar me natyrën dhe ka qenë i interesuar t'i grupojë llojet sipas ngjashmërive që kanë. Klasifikimet e para bazoheshin në vlera mjekësore, ekonomike ose në veçori të tjera të llojeve (u quajtën sisteme artificiale të klasifikimit) dhe nuk merrnin parasysh prejardhjen e as lidhjen gjenetike (farefisnore) midis gjallesave. Në klasifikimet e hershme, gjallesat ndaheshin në dy grupe:

- a) të dobishme dhe
- b) të dëmshme për njeriun.

Klasifikimi i parë i rëndësishëm i gjallesave (edhe pse pa ndonjë kriter të mirëfillte shkencor) u bë nga Aristoteli, rreth 2000 vjet më parë. Ai i ndau gjallesat në dy grupe të mëdha: **bimë dhe shtazë**. **Bimët** i ndau në tri grupe: bimët me trung të lartë - **drunore**; bimët me trung të shkurtër - **shkurrore** dhe bimët e vogla me kërcell të butë - **barishtore**. Shtazët gjithashtu i ndau në tri grupe: ato që jetojnë në ujë - **ujore**, në tokë - **tokësore** dhe në ajër - që **fluturojnë**. Ky klasifikim u përdor shumë shekuj, por me kalimin e kohës u bë i papërdorshëm, sepse vazhdimisht zbuloheshin dhe përshkruheshin gjallesa të reja.

Për emërtimin e llojeve bimore dhe shtazore, janë përdorur emërtime të ndryshme në gjuhën përkatëse, madje edhe në të njëjtën gjuhë për një lloj të caktuar janë përdorur emra të ndryshëm. Psh., mjekët e popujve të ndryshëm kanë përdorur emërtime të ndryshme për bimët mjekuese, prandaj kur është propozuar një bimë për mjekim, nuk është ditur se për cilën bimë bëhet fjalë. Ky konfuzion në emërtimin e llojeve ka bërë të krijohet një sistem i përbashkët për emërtimin e llojeve.



Karl Linnaeus


1.4.1. Klasifikimi i gjallesave në baza shkencore

Nga parregullsia e emërimit të gjallesave ndër shekuj është ndier nevoja që të formohet një sistem, ku gjallesave do t'iu jepeshin emrat e përbashkët ndërkombëtarë. Natyralisti suedez, **Karl Linnaeus (Carl Linné)**, në vitin 1735, vuri bazën e klasifikimit modern të llojeve. Të gjitha llojeve u dha dy emra latinisht - sistemi i dyfishtë (**binomial**) i emërimit. Emri i gjinisë është i pari, ndërsa emri i dytë është illojit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Krijojmë një skicë grafike me nxënësit në tabelën e shkrimit. Në secilën skicë shkruaj nga një pyetje. Plotësoj skicën me përgjigjet e nxënësve.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Analiza e tipareve semantike

Nxënësit ndahen në grupe (3-4 nxënës). Detyra është të marrin një shembull të klasifikimit të gjallesave sipas Lineut.

Mbretëria	
Tipi	
Klasa	
Rendi	
Familja	
Gjinia	
Lloji	

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit të gjallesave dhe argumentimit për rëndësinë e sistematikës për lëndën e biologjisë.

Detyrë:

○ *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike. - Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh., invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdor këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh., invertebrorët-arthropodat-insektet; vertebrorët-gjitarët-primatët; bimët me farë-bimët me lule-bimët barishtore).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2. 3. 4, II. 1. 6, III. 1, IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbretëritë e botës së gjallë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton mbretëritë e botës së gjallë;
- Identifikon karakteristikat e monereve dhe protistëve;
- Gjykon rëndësinë e klasifikimit të botës së gjallë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit
 Di-Dua të di-Mësova më shumë

Në fillim, shënohet njësia mësimore në tabelë “Mbretëritë e botës së gjallë”. Nxënësit ndërtojnë një tabelë në fletoret e tyre të ndarë në tri kolona: D-D-M. Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë

1.5. MBRETËRITË E BOTËS SË GJALLË

Mendoni pse në vetëshërbime janë vendosur gjësendet në mënyrë të organizuar! Ato që janë të ngjashme gjenden pranë njëra-tjetrës. Kjo e bën më të lehtë gjetjen e artikuljeve që duam dhe mund t'i krahasojmë lehtë



Grupet kryesore të organizmave

Në Tokë, deri më tani, janë të evidentuara rreth 1.8 milionë lloje të gjallesave. Për të treguar ngjashmëritë që kanë gjallesat mes vete, shkencëtarët ato i klasifikojnë në grupe. Me klasifikim nënkuptohet grupimi i gjallesave bazuar në ngjashmëritë e tyre. Organizmat me karakteristika të ngjashme grupohen në grupe të veçanta dhe, në bazë të atyre karakteristikave, edhe grupi e merr emrin përkatës. Kjo bëhet me qëllim që të lehtësohet studimi dhe krahasimi i tyre.

Në bazë të ndërtimit dhe të funksionimit qelizor, si dhe mënyrës së të ushqyerit, organizmat klasifikohen në pesë grupe të mëdha - mbretëri. Mbretëria është grupi më i lartë në të cilin gjallesat janë klasifikuar.


Mbretëritë janë:

- Mbretëria e monereve - monera (Prokariote),** (baktereve dhe algave të kaltra në të gjelbër),
- Mbretëria e protistëve - Protista** (algave, parashazorëve dhe kërpudhave jargore),
- Mbretëria e kërpudhave (Fungi),**
- Mbretëria e bimëve (Plantae),**
- Mbretëria e shtazëve (Animalia).**

Pastaj, secila mbretëri ndahet në grupe më të vogla ose tipa (ndarjet), tipat në klasa, klasat në rende, rendet në familje, familjet në gjini dhe gjinitë në lloje individuale.

1.5.1. Mbretëria e monereve (Prokariote)

Moneret janë gjallesa të thjeshta njëqelizore pa bërthamë të diferencuar, prandaj quhen **prokariote**. Në këtë mbretëri bëjnë pjesë bakteret dhe algat e kaltra në të gjelbër. Jetojnë në tokë, në ujë, në hapësira me pluhur dhe në gjallesa të ndryshme.



Bakteret

Algat e kaltra në të gjelbër

1.5.2. Mbretëria e protistëve (Protista)

Këtu bëjnë pjesë gjallesat njëqelizore ose koloniale, që kanë bërthamë të diferencuar (**eukariotët**). Jetojnë në mjediset ujore ose në vende të lagështa. Këtu bëjnë pjesë algat (vetushqyese - autotrofe), parashazorët (protozoarët) dhe kërpudhat jargore (ushqim marrëse - heterotrofe).



Volvoksi

Alga e kuqe

Ameba

atë çfarë dinë apo mendojnë se dinë për njësinë në kolonën e parë D (Di).

D - D - M		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
Mbretëria është niveli më i lartë i klasifikimit të gjallesave. Klasifikimin e sotëm e ka bërë Karl Lineu.		



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbytjes
Di-Dua të di-Mësova më shumë

Pas plotësimit të kolonës së parë me mendimet e nxënësve rreth njësisë, ata fillojnë t'i lexojnë paragrafët në libër, gjatë leximit i formulojnë pyetjet dhe i shënojnë të gjitha paqartësitë apo fjalët e panjohura që kanë hasur. Këto paqartësi zgjidhen me ndihmën e mësimit-dhënësit, duke bashkëbiseduar dhe duke i plotësuar pastaj me përgjigjet e pyetjeve, në kolonën e fundit në pjesën e fundit të orës mësimore.

D - D - M		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
Mbretëria është niveli më i lartë i klasifikimit të gjallesave. Klasifikimin e sotëm e ka bërë Karl Lineu. Mbretëritë janë: bimore dhe shtazore.	Cilat janë mbretëritë e botës së gjallë? Cilat janë kriteret për klasifikim të gjallesave?	



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve:
Di-Dua të di-Mësova më shumë

D - D - M		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
Mbretëria është niveli më i lartë i klasifikimit të gjallesave. Klasifikimin e sotëm e ka bërë Karl Lineu. Mbretëritë janë: bimore dhe shtazore.	Cilat janë mbretëritë e botës së gjallë? Cilat janë kriteret për klasifikim të gjallesave?	Mbretëritë janë monerët, protistët, bimët, shtazët dhe e kërpudhave. Monerët-njëqelizorë, pa bërthamë të diferencuar - algat e kaltra në të gjelbra.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e emërimit të mbretërive dhe identifikimit të karakteristikave të monerëve dhe protistëve.

Detyrë:

(Vizatojnë disa anëtarë të mbretërisë monera dhe protista)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike. - Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 2. 6, II. 6, III. 3, IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbretëritë (fungji, animalia, plantea)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Klasifikon gjallesat nëpër mbretëri;
- Përcakton karakteristikat e gjallesave në mbretëri;
- Identifikon dallimet në mes të organizmave të mbretërive të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlaset, foto ilustruese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Krijojmë një skicë grafike me nxënësit në tabelën e shkrimit. Në secilën skicë shkruaj nga një mbretëri. Plotësoj skicën me përgjigjet e nxënësve për mbretëritë që i kemi mësuar, kurse pjesën tjetër e plotësojmë në fund të orës mësimore pasi t'i kenë lexuar mbretëritë e tjera.

1.5.3. Mbretëria e kërpudhave (Fungi)

Këtu bëjnë pjesë myku, kërpudhat e vërteta dhe tharmet. Këto nuk kanë klorofil dhe nuk e kryejnë procesin e fotosintezës, ushqehen në mënyrë të gatshme (heterotrofe). Sipas mënyrës së të ushqyerit, kërpudhat ndahen në saprofite - ushqehen me materie organike të bimëve e të shtazëve të vdekura - dhe parazitë - të cilat marrin ushqimin e gatshëm nga organizmat e gjallë. Në këtë mbretëri hyjnë dhe likenet.




Kërpudha




Likeni

1.5.4. Mbretëria e bimëve (Plantae)

Këtu bëjnë pjesë bimët. Ndahen në dy grupe: bimë që riprodhohen me spore (myshqet dhe fiernat) dhe ato që riprodhohen me farëra (farëzhveshurat dhe farëveshurat). Myshqet janë bimë të thjeshta barishtore, kanë kërcell dhe gjethë, ndërsa në vend të rrënjës kanë rizoide. Fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat kanë rrënjë, kërcell e gjethë. Farëzhveshurat janë bimë drunore ose shkurrore, me lule të thjeshtë. Gjethet e tyre janë gjilpërore (halore) ose luspore. Farëveshurat kanë lule të vërtetë. Ndahen në dy grupe: njëthelbore (monokotiledone) dhe dythelbore (dikotiledone), dhe dallohen si bimë barishtore, shkurrore ose drunore.





1.5.5. Mbretëria e shtazëve (Animalia)

Mbretëria e shtazëve përfshin të gjithë organizmat shumëqelizorë. Këta organizma ndahen në dy grupe: **pakurrizorët** (nuk kanë shtyllë kurrizorë), ku bëjnë pjesë: grykorët, krimbat, butakët, lëkurëgjemborët, këmbënyjëtarët, dhe **kurrizorët** (që kanë shtyllë kurrizorë), ku bëjnë pjesë: peshqit, ujëtokësorët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët.

Shtazët


Të mbahet në mend!

Gjallesat në planetin tonë klasifikohen në pesë mbretëri: e monereve, protistëve, kërpudhave, bimëve dhe e shtazëve. Virusët nuk përfshihen në sistemin e klasifikimit biologjik.

Pyetje

1. Pse bakteret dhe algat e kaltra në të gjelbra quhen prokariote?
2. A kanë bërthamë protistët?
3. Si e sigurojnë ushqimin algat?
4. Ku ndryshojnë kërpudhat nga bimët?
5. Cilat janë tiparet dalluese të bimëve?
6. Ku qëndron dallimi ndërmjet bimëve farëzveshura dhe farëzveshura?

28



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë mësimore të ndarë në paragrafë.

Nxënësi 1 e lexon mbretërinë e kërpudhave (fungi).

Nxënësi 2 e lexon mbretërinë e bimëve (plantea).

Nxënësi 3 e lexon mbretërinë e shtazëve (animalia).

Diskutohet rreth informacionit të marrë në tekst dhe informacioneve të sjella nga vetë nxënësit.




Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:

Analiza e tipareve semantike

Pakurrizorë (grykorët, krimbat, lëkurëgjemborët, butakët, këmbënyjëtarët); kurrizorët (gjitarët, shpendët, zvarranikët, ujëtokësorët, peshqit)

Nuk kanë klorofil. Myku, kërpudhat e vërteta, tharmet. Saprofitë dhe parasite.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për klasifikimin e gjallesave nëpër mbretëri dhe identifikimin e karakteristikave të secilës mbretëri.

Detyrë:

(Plotësojnë fletore pune, faqe 13-14)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënës të temës: Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke e përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II. 6, III. 3, 5, IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:

- Përkufizon biodiversitetin;
- Identifikon përfitimet ekonomike të biodiversitetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto ilustruese, atlaset, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit

Imagjinatë e drejtuar:

Prezantohet para klasës një video për biodiversitetin. Pasi ta shikojnë videon, kërkohet nga nxënësit t'i mbyllin sytë dhe t'i imagjinojnë të gjithë organizmat që vërejtën në video. Disa nxënës tregojnë disa prej gjallesave që imagjinuan.

https://www.youtube.com/watch?v=b6Ua_zWDH6U

1.6. BIODIVERSITETI - VLERA MË E LARTË E NATYRËS

1.6.1. Ç'është biodiversiteti?

Biodiversiteti është vlera më e lartë e natyrës, është vetë jeta në planetin tonë. Në botë deri tani janë të njohura rreth 1.8 milion lloje të ndryshme të organizmave. Vlerësohet se mund të ekzistojnë një numër prej gjithsej 5 milionë - 80 milionë, kryesisht insekte dhe mikroorganizma. Biodiversiteti përfshin larminë (diversitetin) e qenieve të gjalla.

Biodiversiteti është bazë për ekzistencën e jetës në Tokë, prej tij varet cilësia dhe mirëqenia e jetës sonë. Është e njohur se nga biodiversiteti plotësohen rreth 80 % të nevojave të njeriut dhe rreth 40 % e ekonomisë botërore.

Nga biodiversiteti përfitimet janë të shumfishta, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe ekologjik e edhe të tjera.

Përfitimet ekonomike

Ushqimi që ne e përdorim vjen nga shumë bimë dhe shtazë të egra, por dhe nga ato që i kultivojmë dhe i rrisim.

Barnat që ne i përdorim për shërimin e sëmundjeve, shumica përfitohen prej bimëve dhe shtazëve.

Ndërtimet përmes bimëve drunore.

Lëndët e tekstit përmes bimëve, p.sh. liri etj.

Letra përmes bimëve drunore.

Lëndët e para për laboratorët hulumtues, p.sh. algat etj.



Përfitimet nga kultivimi i patates janë të shumta



Disa produkte nga përpunimi i drurit

Përfitimet ekologjike

Qarkullimi i materies dhe i energjisë zhvillohet përmes ekosistemit.

Zbërthimi i mbeturinave bëhet përmes mikroorganizmave (disa baktereve dhe kërpudhave).

Pastrimi i ajrit përmes bimëve.



Zona rekreative në Peizazhin e Mbrojtur të Gërmisë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

DRTA

Lexojnë njësinë mësimore në pjesë. Lexojnë pjesën e parë e pastaj i mbyllin librat dhe e diskutojnë. Vazhdojnë njësoj edhe me pjesët e tjera të njësisë. Mësimdhënësi e orienton diskutimin me anë të pyetjeve:

- Çfarë është biodiversiteti?
- Sa lloje të organizmave janë të njohur deri më tash?
- Cilat janë përfitimet e biodiversitetit?

Pastaj mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta lexojnë edhe pjesën e dytë, i mbyllin librat. Përsëri, mësimdhënësi i orienton nxënësit përmes pyetjeve:

- Cilat janë përfitimet ekonomike nga biodiversiteti?
- Jep disa shembuj të përfitimeve ekonomike nga biodiversiteti!



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Shkrim i shpejtë

Nxënësit shkruajnë në fletore disa përfitime ekonomike që kemi nga biodiversiteti.

Përfitimet ekonomike nga biodiversiteti:

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të biodiversitetit dhe identifikimit të përfitimeve ekonomike nga biodiversiteti.

Detyrë:

(Hulumtojnë në internet për biodiversitetin e Kosovës - <https://www.ammk-rks.net/repository/docs>)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojlojshmëri e jetës në Tokë, duke e përfshirë llojlojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peizazhit fizik që i mbështet ato.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2. 3, II. 1. 6, III. 5, IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përfitimet ekologjike nga biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon përfitimet ekologjike nga biodiversiteti;
- Arsyeton pse hapësirat me vlera të larta të biodiversitetit shpallen zona të mbrojtura;
- Rendit zonat e mbrojtura në Kosovë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto ilustruese, atlaset.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Harta e koncepteve

Ndaj nxënësit në dyshe.

Paraqes konceptin “Biodiversiteti”, nxënësit në dyshe e krijojnë hartën e koncepteve, duke i përdorur informacionet që ata kanë mësuar më parë për biodiversitetin.



Disa produkte nga përpunimi i drurit

Përfitimet ekologjike


Qarkullimi i materies dhe i energjisë zhvillohet përmes ekosistemit.

Zbërthimi i mbeturinave bëhet përmes mikroorganizmave (disa baktereve dhe kërpudhave).

Pastrimi i ajrit përmes bimëve.



Zona rekreative në Pezashkinë e Mbrojtur të Gërmisë



Rregullimi i klimës përmes ekosistemeve, veçmas atyre pyjore.

Biodiversiteti përveç vlerave që u përmendën, është i vlefshëm edhe për shkak të rëndësisë shkencore, arsimore, kulturore, rekreative, estetike, ekonomike etj. Prandaj shfrytëzimi i biodiversitetit duhet të bëhet meshumë kujdes: në baza ekologjike, i planifikuar, i kontrolluar dhe i qëndrueshëm.

Për t'i shfrytëzuar në baza të tilla, hapësirat me vlera të larta të biodiversitetit, kudo në botë, shpallen zona të mbrojtura (rezervate natyrore, parqe kombëtare, monumente natyrore, peizazhe të mbrojtura etj.). Për vlerat dhe rëndësinë që kanë, ato vizitohen sot nga numër i madh i njerëzve, p.sh., Peizazhin e Mbrojtur të Gërmisë brenda vitit e vizitojnë rreth 1 milion njerëz, kryesisht nga Prishtina. Parkun Kombëtar të Josemitit në ShBA e vizitojnë rreth 5 milionë, ndërsa ujëvarat Niagara ndërmjet kufirit Kanada-ShBA i vizitojnë rreth 12 milionë turistë. Nga vizitat në zona të mbrojtura përfiton komuniteti lokal, p.sh., nga vizitat që iu bëhen gorillave në Ruandë (Africë) fitohen rreth 4 milionë dollarë në vit, ndërsa nga turizmi në rrifet koralore të Australisë fitohen rreth 2.2 miliardë dollarë përvit.



Parku Kombëtar i Josemitit



Rrifet koralore në Australi



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Ditari dypjesësh

Lexojnë njësinë mësimore rreth 10-12 min. Gjatë leximit nxënësit i nënvizojnë citimet më të rëndësishme. Pas leximit kërkohet nga ta që ta ndërtojnë një ditar dypjesësh.

Shkruajnë një vijë vertikale në mes të fletores, në njërën anë i shkruajnë përfitimet ekologjike dhe në anën tjetër sqarimin për to.

Përfitimet ekologjike	
Pastrimi i ajrit	
Zbërthimi i materieve	
Rregullimi i klimës	



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Rrjeti i diskutimit

Nxit diskutimin me pyetjen: Cilat janë zonat e mbrojtura në Kosovë? Pse shpallen zona të mbrojtura? Cila është rëndësia e tyre?



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e përfitimeve ekologjike, përcaktimin e zonave të mbrojtura në Kosovë dhe argumentimin për rëndësinë e shpalljes së këtyre zonave të mbrojtura.

Detyrë:

○ *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

○ _____

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (p.sh., për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invazive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit).

Vlerëson rolin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit - niveli global.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 3, 4, 5, II. 1, III. 3, IV. 3, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cilat rreziqe e kërcënojnë biodiversitetin dhe cilat janë masat mbrojtëse?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Rendit faktorët që e rrezikojnë biodiversitetin;
- Analizon masat mbrojtëse për biodiversitetin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: atlaset, foto ilustruese, fletë të vogla.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Pema e mendimeve

Shpërndahen fletë të vogla te nxënësit. Kërkohet që secili të shkruajë nga një mendim se çka e rrezikon biodiversitetin. Mësimdhënësi e vizaton më parë një pemë në hamer. Vendosen idetë e nxënësve në pemën e mendimeve.

1.6.2. Cilat rreziqe e kërcënojnë biodiversitetin dhe cilat janë masat për mbrojtje?

Rreziqet kryesore që kërcënojnë biodiversitetin janë të ndryshme:

- Shfrytëzimi i pakontrolluar i llojeve bimore dhe shtazore (p.sh., peshkimi i pakontrolluar, mbledhja e pakontrolluar e bimëve, prerja pa plan e pyjeve, gjuetia pa leje etj.);
- Humbja e sipërfaqeve shumë të mëdha të pyjeve, livadheve etj., duke i kthyer në sipërfaqe të tokave të punuara ose të betonuara. Me zhdukjen e pyjeve dhe livadheve, zhduken edhe shumë lloje bimore e shtazore me rëndësi të madhe shkencore, ekonomike, turistike etj.;
- Ndotja e lumenjve, liqeneve, deteve dhe oqeanëve.

Dëmtimet e ekosistemeve dhe humbja e biodiversitetit ka pasojë të shumta për: burimet e ushqimit, ndryshimet e klimës, erozionet etj.

Masat për mbrojtje duhet të jenë:

- a. Shfrytëzimi i planifikuar dhe i qëndrueshëm i llojeve dhe ruajtja e biotopeve;
- b. Ruajtja strikte e llojeve endemike dhe bashkësive të atyre llojeve;
- c. Ruajtja nga shfrytëzimi i pakontrolluar i ekosistemeve ujore (lumenjve, liqeneve, deteve) dhe mbrojtja e tyre nga ndotja.

Të gjitha këto masa janë të rregulluara me ligje përkatëse. Ndërsa për llojet e zhdukura dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore përpilohen Listat e Kuqe, të cilat janë dokumente që ofrojnë të dhëna për këto lloje të shtazëve dhe bimëve.

Kuriozitet

Një bimë drunore mund të prodhojë rreth 2,000,000 dollarë nëse llogariten vlerat ekologjike, siç janë: prodhimi i oksigjenit, pastrimi i ajrit, riciklimi i ujit, fertilizimi i tokës, kontrolli i erozionit, sigurimi i vendbanimit ("shtëpisë") për botën e egër, zbutjen e efekteve toksike të gazrave, ndërsa vlera monetare e tij në treg, nëse shitet si dru industrial, mund të jetë rreth 200 dollarë. Sot, në botë, brenda një minute zhduken rreth 20 hektarë pyje. I llogaritet se në botë, sot, në prag të zhdukjes janë: 1/4 apo 25 % e gjitarëve, 1/3 apo 34 % e peshqve, 11 % e zogjve, 20 % e zvarranikëve dhe 25 % e ujëtokësorëve.

1.6.2. Cilat rreziqe e kërcënojnë biodiversitetin dhe cilat janë masat për mbrojtje?

Rreziqet kryesore që kërcënojnë biodiversitetin janë të ndryshme:

- Shfrytëzimi i pakontrolluar i llojeve bimore dhe shtazore (p.sh., peshkimi i pakontrolluar, mbledhja e pakontrolluar e bimëve, prerja pa plan e pyjeve, gjuetia pa leje etj.);
- Humbja e sipërfaqeve shumë të mëdha të pyjeve, livadheve etj., duke i kthyer në sipërfaqe të tokave të punuara ose të betonuara. Me zhdukjen e pyjeve dhe livadheve, zhduken edhe shumë lloje bimore e shtazore me rëndësi të madhe shkencore, ekonomike, turistike etj.;
- Ndotja e lumenjve, liqeneve, deteve dhe oqeanëve.

Dëmtimet e ekosistemeve dhe humbja e biodiversitetit ka pasoja të shumta për: burimet e ushqimit, ndryshimet e klimës, erozionet etj.

Masat për mbrojtje duhet të jenë:


- Shfrytëzimi i planifikuar dhe i qëndrueshëm i llojeve dhe ruajtja e biotopeve;
- Ruajtja strikte e llojeve endemike dhe bashkësive të atyre llojeve;
- Ruajtja nga shfrytëzimi i pakontrolluar i ekosistemeve ujore (lumenjve, liqeneve, deteve) dhe mbrojtja e tyre nga ndotja.

Të gjitha këto masa janë të rregulluara me ligje përkatëse. Ndërsa për llojet e zhdukura dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore përpilohen Listat e Kuqe, të cilat janë dokumente që ofrojnë të dhëna për këto lloje të shtazëve dhe bimëve.

Kuriozitet

Një bimë drunore mund të prodhojë rreth 2,000,000 dollarë nëse llogariten vlerat ekologjike, siç janë: prodhimi i oksigjenit, pastrimi i ajrit, riciklimi i ujit, fertilizimi i tokës, kontrolli i erozionit, siguria e vendbanimit ("shtëpisë") për botën e egër, zbutjen e efekteve toksike të gazrave, ndërsa vlera monetare e tij në treg, nëse shitet si dru industrial, mund të jetë rreth 200 dollarë. Sot, në botë, brenda një minute zhduken rreth 20 hektarë pyje. Llogaritet se në botë, sot, në prag të zhdukjes janë: 1/4 apo 25 % e gjitarëve, 1/3 apo 34 % e peshqve, 11 % e zogjve, 20 % e zvarranikeve dhe 25 % e ujëtokësorëve.

32



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënit me këmbime

Nxënësit do të mbajnë shënime për informacionin e duhur në skicën e grafikut, duke përshkruar dhe duke analizuar faktorët që e rrezikojnë biodiversitetin dhe masat mbrojtëse. Kërkohet nga nxënësit që ta respektojnë plotësimin e kutive në rrugë logjike, pasi të kenë lexuar në dyshe një fragment të caktuar nga materiali që u është dhënë. Është me rëndësi që çdo kuti të ketë të dhëna të caktuara, fakte që ata i gjejnë në material dhe i plotësojnë hap pas hapi. Plotësimin e organizuesit grafik e ndihmon shumë edhe shikimi i fotografive që kanë përpara.

Çka e rrezikon?

Biodiversiteti

Cilat janë masat mbrojtëse?



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Shkrim i shpejtë

Kërkoj nga nxënësit të shkruajnë 5 mënyra se si ata mund të ndikojnë në ruajtjen e biodiversitetit.

Si mund ta ruash
biodiversitetin?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të faktorëve që e rrezikojnë biodiversitetin dhe rekomandimit të masave mbrojtëse që duhen marrë për mbrojtjen e biodiversitetit.

Detyrë:

(Pyetje-përgjigje, faqe 33 (libri bazë))

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (p.sh., për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invazive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit). - Vlerëson rolin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit - niveli global.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4. 6, II. 1, III. 1. 5, IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje (Biodiversiteti)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon zonat e mbrojtura në Kosovë;
- Shkruan disa karakteristika të zonave të mbrojtura në Kosovë;
- Vlerëson rëndësinë e biodiversitetit për njeriun dhe mjedisin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Atlaset, foto ilustruese.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënëtit
Shkrim i lirë

Udhëzohen nxënësit ta plotësojnë ushtrimin në fletore pune.

3. A janë këto pohime të sakta?

- | | |
|---|-------|
| a. Biodiversiteti përfshin të gjitha format e jetës. | PO JO |
| b. Për cilësinë dhe mirëqenien e jetës sonë, nuk ka ndonjë rëndësi biodiversiteti. | PO JO |
| c. Në kuadër të zonave të mbrojtura, biodiversiteti shfrytëzohet në baza ekologjike dhe të qëndrueshme. | PO JO |
| d. Biodiversiteti rrezikohet nga shfrytëzimi i pakontrolluar i llojeve bimore, shtazore dhe humbja e biotopeve. | PO JO |
| e. Ndotja e lumenjve, liqeneve, deteve dhe e oqeanëve nuk rrezikon humbjen e biodiversitetit. | PO JO |
| f. Mbrojtja e llojeve dhe e biotopeve nuk rregullohet në ligje, sepse mjafton vetëdija ekologjike. | PO JO |

4. Shkruaj përshtypjet tuaja nga ndonjë vizitë në parqet kombëtare të Kosovës (Sharr, Bjeshkë të Nemuna) apo në ndonjë zonë tjetër të mbrojtur (Gërmia, Liqenët e Mirushës etj.).

4. Shkruaj përshtypjet tuaja nga ndonjë vizitë në parqet kombëtare të Kosovës (Sharr, Bjeshkë të Nemuna) apo në ndonjë zonë tjetër të mbrojtur (Gërmia, Liqenët e Mirushës etj.).

1.6. BIODIVERSITETI - VLERA MË E LARTË E NATYRËS

1.6.1. Ç'është biodiversiteti?

Biodiversiteti është vlera më e lartë e natyrës, është vetë jeta në planetin tonë. Në botë deri tani janë të njohura rreth 1.8 milion lloje të ndryshme të organizmave. Vlerësohet se mund të ekzistojë një numër prej gjithsej 5 milionë - 80 milionë, kryesisht insekte dhe mikroorganizma. Biodiversiteti përfshin larminë (diversitetin) e gjenieve të gjalla. Biodiversiteti është bazë për ekzistencën e jetës në Tokë, prej tij varet cilësia dhe mirëqenia e jetës sonë. Është e njohur se nga biodiversiteti plotësohen rreth 80 % të nevojave të njeriut dhe rreth 40 % e ekonomisë botërore. Nga biodiversiteti përfitimet janë të shumfishta, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe ekologjikë edhe të tjera.

Përfitimet ekonomike

Ushqimi që ne e përdorim vjen nga shumë bimë dhe shtazë të egra, por dhe nga ato që i kultivojmë dhe i rrisim.

Barnat që ne i përdorim për shërimin e sëmundjeve, shumica përfitohen prej bimëve dhe shtazëve.

Ndërtimet përmes bimëve drunore.

Lëndët e tekstit përmes bimëve, p.sh. liri etj.

Letra përmes bimëve drunore.

Lëndët e para për laboratorët hulumtues, p.sh. algat etj.



Përfitimet nga kultivimi i patates janë të shumta

29



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënit me këmbime

Organizohen në grupe nga 4-5 nxënës. Përgatiten "fletët e ekspertit", të cilat shoqërohen me termat që do të plotësohen. Më pas, grupet e ekspertëve e fillojnë studimin. Rigrupohen nxënësit sipas përcaktimit të pjesës së njëjtë të përzgjedhur, mbledhen bashkë dhe e diskutojnë pjesën që u është caktuar si detyrë. U kërkohet anëtarëve të grupit ta analizojnë informacionin e mbledhur nga çdo anëtar, të cilin do ta bashkojnë në një përmbledhje tërësore të çështjeve kryesore. Ata i diskutojnë përfundimet e tyre dhe vendosin për mënyrën se si do t'ua shpjegojnë këtë pjesë të tjerëve kur të shkojnë në grupet fillestare. Pastaj, të gjithë nxënësit që kanë të njëjtin numër, ekspertët, raportojnë në grupet fillestare për t'i shpjeguar çështjet më të rëndësishme të pjesës së tyre të tekstit.

Kështu duken fletët e ekspertit:

EKSPERTI A
Biodiversiteti:

EKSPERTI B
Përfitimet
ekonomike:

EKSPERTI C
Përfitimet
ekologjike:



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Diskutim në grup

Grupet e ekspertëve e prezantojnë punën e tyre. Nxënësit e tjerë shkëmbejnë mendime dhe u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në fazën e dytë të orës. Po ashtu, paqartësitë plotësohen edhe me ndihmën e mësimitdhënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e kryerjes së detyrës për zonat e mbrojtura në Kosovë dhe biodiversitetin.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon një çështje lokale të lidhur me biodiversitetin (p.sh., efektet e aktiviteteve të njeriut në biodiversitetin urban). Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, I. 2, II. 1, III. 5, IV. 3

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biodiversiteti në Kosovë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan llojloshmërinë e gjallesave në Kosovë;
- Emërton zonat më të pasura me biodiversitet në Kosovë;
- Analizon shkaqet që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në Kosovë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto të bimëve dhe shtazëve etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Ekologjia dhe mjedisi, Gjeografia.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ja e shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë, paraqet disa foto të bimëve dhe shtazëve që jetojnë në vendin tonë dhe vazhdon me pyetje. Nga nxënësit merr informacione për njohuritë paraprake.

Disa nga pyetjet e mundshme:

- A është i pasur vendi ynë me lloje bimore dhe shtazore?

1.7. BIODIVERSITETI I KOSOVËS

1.7.1. Cilat janë vlerat e biodiversitetit në Kosovë?

Kosova ka sipërfaqe të vogël dhe zë rreth 1.6 % të Gadishullit Ballkanik. Edhe pse me sipërfaqe të vogël, është një nga vendet më të pasura me lloje në Ballkan dhe Evropë. Biodiversiteti i pasur i Kosovës është rezultat i faktorëve të llojloshëm ekologjikë. Zonat më të pasura me biodiversitet janë mali Sharr, Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare), mali Pashtrik dhe mali Koritnik. Në Kosovë janë të listuara rreth 1800 lloje të bimëve me lule, por supozohet se numri i tyre mund të jetë rreth 2500 lloje. Deri tani janë të njohura rreth 210 lloje të egra të kurrizorëve, kurse numri i pakurrizorëve është shumë më i madh, p.sh. deri tani janë të njohura afro 200 lloje të fluturave.

Cilat janë shkaqet që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në Kosovë? Në të kaluarën, por edhe tash humbja e biodiversitetit është si pasojë e dëmtimit të pyjeve, livadheve, lumenjve etj., gjë që është rezultat i ndërtimeve të paplanifikuara dhe të pakontrolluara në sektorin e industrisë, komunikacionit, infrastrukturës urbane dhe vetëdijesë ulët ekologjike etj.



Bornmullera e Dieckit



Krokusi i Sharrit



Dioskorea e Ballkanit



Sideritisi i Sharrit

Disa lloje të bimëve endemike në Kosovë



Gjinështra e Hasertit

1.7. BIODIVERSITETI I KOSOVËS
1.7.1. Cilat janë vlerat e biodiversitetit në Kosovë?

Kosova ka sipërfaqe të vogël dhe zë rreth 1.6 % të Gadishullit Ballkanik. Edhe pse me sipërfaqe të vogël, është një nga vendet më të pasura me lloje në Ballkan dhe Evropë. Biodiversiteti i pasur i Kosovës është rezultat i faktorëve të llojlojshëm ekologjikë. Zonat më të pasura me biodiversitet janë mali Sharr, Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare), mali Pashtrik dhe mali Koritnik. Në Kosovë janë të listuara rreth 1800 lloje të bimëve me lule, por supozohet se numri i tyre mund të jetë rreth 2500 lloje. Deri tani janë të njohura rreth 210 lloje të egra të kurrizorëve, kurse numri i pakurrizorëve është shumë më i madh, p.sh. deri tani janë të njohura afro 200 lloje të fluturave.

Cilat janë shkaqet që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në Kosovë? Në të kaluarën, por edhe tash humbja e biodiversitetit është si pasojë e dëmtimit të pyjeve, livadheve, lumenjve etj., gjë që është rezultat i ndërtimeve të paplanifikuara dhe të pakontrolluara në sektorin e industrisë, komunikacionit, infrastrukturës urbane dhe vetëdijesë ulët ekologjike etj.



Gjineshtra e Hasertit



Bornmullera e Dieckit



Krokusi i Sharrit



Dioskorea e Ballkanit



Sideritisi i Sharrit

Disa lloje të bimëve endemike në Kosovë

- Në cilat rajone të Kosovës janë të përhapura më shumë bota bimore dhe shtazore?
- Cilat janë shkaqet e humbjes së biodiversitetit në vendin tonë?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë mësimore të ndarë në paragrafë dhe pas çdo ndalesë mësimdhënësi/ja kujdeset për t'i sqaruar konceptet kryesore gjatë leximit, kështu vazhdohet deri në fund të tekstit. Diskutohet rreth informacionit të marrë në tekst dhe informacioneve të sjella nga vetë nxënësit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Shkrim i shpejtë

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja u jep detyrë nxënësve që të shkruajnë për "Vlerat e biodiversitetit në Kosovë". Tutje, disa nga nxënësit i lexojnë shkrimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe për përshkrimin e temës së dhënë.

Detyrë:

(Të hulumtojnë në internet për Biodiversitetin e Kosovës)

○ *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon bimët dhe shtazët endemike, të rrezikuara për zhdukje që jetojnë në Kosovë. Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 1, II. 6, III. 5 IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet endemike në Kosovë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon lloje dhe nënloje endemike dhe endemorelikte të gjallesave në Kosovë.
- Tregon rëndësinë e llojeve endemike dhe endemorelikte.
- Rekomandon masat që duhet t'i marrim për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit në vendin tonë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Ekologjia dhe mjedisi, Jeta dhe puna, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Përvijim i të menduarit

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë temën mësimore. Nxënësit nxiten që t'i shkruajnë në fletoret e tyre të gjitha njohuritë që kanë lidhur me temën. Pastaj, mësimdhënësi/ja i merr mendimet e tyre dhe i shkruan në tabelë.

Pranohen edhe idetë që nuk janë shumë të sakta. Nxënësit nxiten të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit.



Disa lloje të bimëve endemike në Kosovë

1.7.2. Llojet endemike në Kosovë - një vlerë e madhe shkencore

Në Kosovë gjenden rreth 200 lloje dhe nënloje bimore endemike të Ballkanit. Endemike janë llojet bimore ose shtazore që banojnë në një territor të kufizuar. Vetëm në vendin tonë, e askund tjetër në botë, gjenden 8 lloje dhe nënloje bimore endemike. Këto lloje quhen stenoendemike (endemike lokale). Nga llojet shtazore si endemik është rrëqebulli ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), që rritet vetëm në Ballkan (Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi).

1.7.3. Masat për ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë

Mënyra më e mirë e ruajtjes së biodiversitetit është shpallja e hapësirave të pasura me biodiversitet si zona të mbrojtura. Deri tani në Kosovë janë të shpallura 273 zona të mbrojtura, përmes të cilave veçmas ruhen llojet endemike, endemorelikte, të rralla dhe interesante. Kosova ka ligjin për mbrojtjen e natyrës, kështu shfrytëzimi i bimëve të mbrojtura ose gjuetia e shtazëve të mbrojtura është e ndaluar.



Barpezmia mbretit Aleksandër



Rreqebulli ballkanik

Sikurse në vendet e tjera, edhe në Kosovë, megjithëse gjenden nën mbrojtje, shumë lloje bimore dhe shtazore janë të rrezikuara nga veprimet tona. Kështu është e nevojshme që të merren këto masa të duhura për ruajtjen e tyre:

- ruajtja e vendbanimeve natyrore të llojeve bimore dhe shtazore,
- ndërprerja e prerjes së pyjeve pa kriter dhe çfarëdo dëmtimi tjetër i tyre,
- ripërtëritja e pyjeve të shkatërruara,
- mbrojtja e llojeve bimore dhe shtazore endemike dhe atyre të rrezikuara nga çfarëdo shfrytëzimi,
- mbrojtja e llojeve shtazore që kanë rëndësi ndërkombëtare (rreqebulli ballkanik, dhia e egër, ariu i murrmë etj.),
- monitorimi dhe mbrojtja e zonave më të rëndësishme të biodiversitetit,
- edukimi dhe ngritja e vetëdijes së shoqërisë për mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secilit grup i jepen pyetjet (copëzat e thyera) dhe u kërkohet që fillimisht ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta shkruajnë përgjigjen. Pastaj, lideri i grupit e lexon dhe kështu vazhdohet me të gjitha grupet, po ashtu nxënësit e grupeve të tjera i bëjnë pyetje grupit që prezanton. Kështu vazhdohet deri në prezantimin e grupit të fundit.

Grupi 1:

Përshkruaj llojet endemike dhe endemorelikte!

Grupi 2:

Emërto lloje të shtazëve dhe bimëve që rriten në Kosovë!

Grupi 3:

Përmend masat që duhen ndërmarrë për ruajtjen e biodiversitetit!

Grupi 4 :

Trego rolin dhe rëndësinë e llojeve dhe nënlojeve endemike dhe endemorelikte!



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:

Harta e konceptit

Në këtë fazë të orës nxënësit udhëzohen të plotësojnë një hartë koncepti në fletoret e tyre. Pastaj, disa nga nxënësit i paraqesin në tabelë shkrimet e tyre.

Llojet endemike në Kosovë

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për përfshirjen gjatë gjithë orës mësimore, saktësinë e përgjigjeve të dhëna si dhe bashkëpunimin në grup.

Detyrë:

(Të punojnë një projekt për llojet endemike dhe endemorelikte në Kosovë)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 1, II. 6, III. 5 IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ku jetojnë qeniet e gjalla?

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan përshtatjen e organizmave të gjallë në mjedisin jetësor.
 - Tregon ndikimin e mjedisit në organizma të ndryshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, ilustrime, videoprojektor etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Ekologjia dhe mjedisi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi: Përgatitja për të nxënë**
Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të shikojnë me vëmendje foto ose video të mjedisëve të ndryshme jetësore dhe pastaj t'i japin përgjigjet e tyre në lidhje me atë se çfarë shohin.

Disa përgjigje të mundshme:

Një shkretëtirë, një pyll, një liqen etj.

2. ORGANIZIMI I QENIEVE TË GJALLA

2.1. Ku jetojnë qeniet e gjalla?

Si përshtaten qeniet e gjalla në mjedisin e tyre? Çdo qenie e gjallë ose popullatë është e lidhur me mjedisin ku ndodhet dhe përshtatet për të jetuar aty. Një kaktus apo deve nuk do të mund të mbijetonin në një shkretëtirë të ftohtë (në viset polare), sepse janë përshtatur prej shekujsh në mjediset me klimë të nxehtë dhe të thatë. Në natyrë ekzistojnë marrëdhënie të caktuara në mes të organizmave (bimëve, shtazëve dhe mikroorganizmave) në një anë dhe kushteve të mjedisit të jashtëm, në anën tjetër, por dhe marrëdhënie të caktuara mes vetë organizmave. Shkenca që studion këto marrëdhënie quhet **ekologji**.

2.1.1. Organizma të ndryshëm me përshtatje të ngjashme në mjedisin e njëjtë

Përshtatjet e organizmave për të jetuar në vendbanime të caktuara shpesh na duken të çuditshme, por janë të domosdoshme për ta.

Për të parë se si organizmat përshtaten ndaj ndikimeve të mjedisit të jashtëm, marrim shembullin e një kaktusi dhe të një deveje, vendjetesa e të cilëve është shkretëtira. Dihet se kaktusi është bimë, ndërsa deveja shtazë, pra krejtësisht lloje të ndryshme, por meqë jetojnë në mjedis të njëjtë (shkretëtirë), kanë fituar përshtatshmëri për të balancuar rezervat e ujit në trupin e tyre. Që të dy marrin sasi të madhe të ujit, kur ai është i bollshëm, dhe e ruajnë ujin. Gjatë thatësisë, ngjashëm me devenë, por, kuptohet, në mënyrë tjetër, kaktusi i shfrytëzon këto rezerva të ujit dhe mund të përballojë periudha të gjata të thatësisë. Prandaj, kaktusi quhet si "bima deve".



Shkretëtira është vendbanim i kaktusit dhe i deveve. Edhe pse njëra bimë, tjetra shtazë, janë përshtatur për të ruajtur ujin në trupin e tyre.

2. ORGANIZIMI I QENIEVE TË GJALLA

2.1. Ku jetojnë qeniet e gjalla?

Si përshtaten qeniet e gjalla në mjedisin e tyre? Çdo qenie e gjallë ose popullatë është e lidhur me mjedisin ku ndodhet dhe përshtatet për të jetuar aty. Një kaktus apo deve nuk do të mund të mbijetonin në një shkretëtirë të ftohtë (në viset polare), sepse janë përshtatur prej shekujsh në mjediset me klimë të nxehtë dhe të thatë. Në natyrë ekzistojnë marrëdhënie të caktuara në mes të organizmave (bimëve, shtazëve dhe mikroorganizmave) në një anë dhe kushteve të mjedisit të jashtëm, në anën tjetër, por dhe marrëdhënie të caktuara mes vetë organizmave. Shkenca që studion këto marrëdhënie quhet **ekologji**.

2.1.1. Organizma të ndryshëm me përshtatje të ngjashme në mjedisin e njëjtë

Përshtatjet e organizmave për të jetuar në vendbanime të caktuara shpesh na duken të çuditshme, por janë të domosdoshme për ta.

Përtë parë se si organizmat përshtaten ndaj ndikimeve të mjedisit të jashtëm, marrim shembullin e një kaktusi dhe të një deveje, vendjeteja e të cilëve është shkretëtira. Dihet se kaktusi është bimë, ndërsa deveja shtazë, pra krejtësisht lloje të ndryshme, por meqë jetojnë në mjedis të njëjtë (shkretëtirë), kanë fituar përshtatshmëri për të balancuar rezervat e ujit në trupin e tyre. Që të dy marrin sasi të madhe të ujit, kur ai është i bollshëm, dhe e ruajnë ujin. Gjatë thatësisë, ngjashëm me devenë, por, kuptohet, në mënyrë tjetër, kaktusi i shfrytëzon këto rezerva të ujit dhe mund të përballojë periudha të gjata të thatësisë. Prandaj, kaktusi quhet si "bima deve".



Shkretëtira është vendbanim i kaktusit dhe i deveve. Edhe pse njëra bimë, tjetra shtazë, janë përshtatur për të ruajtur ujin në trupin e tyre.

39



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Leximi i drejtuar

Pas një ligjërate të shkurtër nga mësimdhënësi/ja nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë mësimore të ndarë në paragrafë dhe pas çdo ndalesë mësimdhënësi nxit me pyetje drejtuar nxënësve.

Kështu vazhdohet deri në fund të njësisë mësimore. Pyetje të mundshme:

Cilat janë vendjetezat e gjallesave?

A mund të jetojnë organizmat e llojeve të ndryshme në të gjitha mjediset?

Trego shembuj të përshtatjes së organizmave ndaj mjedisit jetësor!

Pse organizmat ujorë nuk mund të jetojnë në mjedisin tokësor?



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Shënime mbi shënime

Nxënësit udhëzohen ta shkruajnë për një kohë të shkurtër temën "Përshtatja e gjallesave në mjedisin jetësor të tyre". Lexohen disa prej shkrimeve dhe komentohen nga nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për përfshirjen gjatë gjithë orës mësimore, saktësinë e përgjigjeve të dhëna, argumentet e përdorura në përshkrimin e temës.

Detyrë:

(Të plotësojnë fletore pune)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Biodiversiteti

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon një çështje lokale të lidhur me biodiversitetin (p.sh., efektet e aktiviteteve të njeriut në biodiversitetin urban). Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë. Identifikon bimët dhe shtazët endemike, të rrezikuara për zhdukje që jetojnë në Kosovë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4, II. 6, III. 7, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje (Biodiversiteti)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan vlerat e llojllojshmërisë së organizmave në Kosovë.
- Vlerëson rolin e llojeve endemike në vendin tonë.
- Propozon masa që duhen ndërmarrë për ruajtjen e biodiversitetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ja parashtron disa pyetje dhe kështu merr informacione për njohuritë paraprake. Disa nga pyetjet e mundshme:

Si rezultat i kujt është llojllojshmëria e organizmave në Kosovë?

1.7. BIODIVERSITETI I KOSOVËS

1.7.1. Cilat janë vlerat e biodiversitetit në Kosovë?

Kosova ka sipërfaqe të vogël dhe zë rreth 1.6 % të Gadishullit Ballkanik. Edhe pse me sipërfaqe të vogël, është një nga vendet më të pasura me lloje në Ballkan dhe Evropë. Biodiversiteti i pasur i Kosovës është rezultat i faktorëve të llojllojshëm ekologjikë. Zonat më të pasura me biodiversitet janë mali Sharr, Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare), mali Pashtrik dhe mali Koritnik. Në Kosovë janë të listuara rreth 1800 lloje të bimëve me lule, por supozohet se numri i tyre mund të jetë rreth 2500 lloje. Deri tani janë të njohura rreth 210 lloje të egra të kurrizorëve, kurse numri i pakurrizorëve është shumë më i madh, p.sh. deri tani janë të njohura afro 200 lloje të fluturave.

Cilat janë shkaqet që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit në Kosovë? Në të kaluarën, por edhe tash humbja e biodiversitetit është si pasojë e dëmtimit të pyjeve, livadheve, lumenjve etj., gjë që është rezultat i ndërtimeve të paplanifikuara dhe të pakontrolluara në sektorin e industrisë, komunikacionit, infrastrukturës urbane dhe vetëdijesë ulët ekologjike etj.



Gjinshetra e Hasertit



Bornmullera e Dieckit



Krokusi i Sharrit



Dioskorea e Ballkanit



Sideritisi i Sharrit

Disa lloje të bimëve endemike në Kosovë



Bishtmii shqiptar



Zambaku shqiptar



Ylli shqiptar



Zorrëca e dorflerit

Disa lloje të bimëve endemike në Kosovë

1.7.2. Llojet endemike në Kosovë - një vlerë e madhe shkencore

Në Kosovë gjenden rreth 200 lloje dhe nënloje bimore endemike të Ballkanit. Endemike janë llojet bimore ose shtazore që banojnë në një territor të kufizuar. Vetëm në vendin tonë, e askund tjetër në botë, gjenden 8 lloje dhe nënloje bimore endemike. Këto lloje quhen stenoendemike (endemike lokale). Nga llojet shtazore si endemik është rrëqebulli ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), që rritet vetëm në Ballkan (Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi).

1.7.3. Masat për ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë

Mënyra më e mirë e ruajtjes së biodiversitetit është shpallja e hapësirave të pasura me biodiversitet si zona të mbrojtura. Deri tani në Kosovë janë të shpallura 273 zona të mbrojtura, përmes të cilave veçmas ruhen llojet endemike, endemorelikte, të rralla dhe interesante. Kosova ka ligjin për mbrojtjen e natyrës, kështu shfrytëzimi i bimëve të mbrojtura ose gjuetia e shtazëve të mbrojtura është e ndaluar.



Barpezmi i mbretit Aleksander

Sa lloje të bimëve me lule janë të njohura në vendin tonë deri më sot?

Cilat shtazë endemike jetojnë në Kosovë?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe. Mësimdhënësi/ja ia shpërndan pyetjet e përgatitura më parë secilit grup, pas përfundimit të detyrës së dhënë përfaqësuesit e secilit grup prezantojnë dhe kështu vazhdohet deri në fund të të gjitha prezantimeve.

Grupi 1:

Trego vlerat e biodiversitetit në Kosovë!

Grupi 2:

Pse në vendin tonë kohët e fundit po humb biodiversiteti?

Grupi 3:

Përshkruaj llojet endemike në Kosovë!

Grupi 4:

Shpjego masat që duhen ndërmarrë për ruajtjen e biodiversitetit në vendin tonë!



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënimit:

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të orës mësimore pasi që nxënësit e kanë përfunduar prezantimin do të udhëzohet që secili grup t'u bëjë pyetje grupeve të tjera lidhur me detyrën e prezantuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin në grup, saktësinë e përgjigjeve të dhëna, formulimin e pyetjeve drejtuar njëri-tjetrit.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletore punën)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi - karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit - tipat e organizmave të tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, zbërthyesit).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II. 1, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çështje mjedisi?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon ndikimet që vijnë nga bota e gjallë dhe jo e gjallë.
- Përshkruan rolin e faktorëve biotikë dhe abiotikë.
- Vlerëson faktorët ekologjikë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ja e shënon titullin e njësise mësimore në tabelë, vazhdon me pyetje drejtuar nxënësve dhe nga ta merr informacione për njohuritë paraprake.

Disa nga pyetjet e mundshme:

Çka kuptoni me mjedisi?

2.1.2. Ç'është mjedisi?

Me mjedis nënkuptojmë kushtet fizike, kimike dhe biologjike të një zone në të cilën një organizëm jeton, apo gjithçka që e rrethon dhe ndikon në atë organizëm. Dallohen dy lloje ndikimesh: **abiotike** dhe **biotike**. Këto ndikime njihen si **faktorë ekologjikë**.

Ndikimet abiotike - janë ndikimet që vijnë nga bota jo e gjallë, të tilla si:

- klima (drita, temperatura e ajrit dhe tokës, uji, ajri dhe lagështia e tij),
- përbërja e tokës (vetitë fizike, kimike, biologjike të tokës) dhe
- relievi (lartësia mbidetare, ekspozicioni, pjerrtësia e terrenit) etj.

Veçoria themelore e ndikimeve abiotike (faktorëve ekologjikë abiotikë) është ndryshueshmëria e tyre në kohë dhe hapësirë. Ndryshimet kohore shprehën përmes luhatjeve të tyre gjatë ditës, gjatë stinëve të vitit, nga viti në vit, p.sh., temperatura ndryshon gjatë ditës dhe natës, gjatë stinëve të vitit, si dhe nga viti në vit. Nëse një vit është më i ftohtë se një tjetër, mund të vdesin më shumë bimë ose shtazë.


Ndryshimet hapësinore varen nga lartësia mbidetare, ekspozicioni, gjerësia dhe gjatësia gjeografike etj., p.sh., temperatura ndryshon në mënyrë horizontale dhe vertikale, me ç'rast zvogëlohet duke shkuar prej ekuatorit kah polët, por dhe prej rrezës së masivit malor kah maja e tij. Kjo ndikon në shtrirjen e llojeve të caktuara të bimëve dhe shtazëve si në pikëpamje horizontale, prej ekuatorit deri në pole, ashtu dhe vertikale nga rreza deri në majë të masivit malor.

Ndikimet biotike - janë ndikimet që vijnë nga qeniet e gjalla (**bimët, kafshët** apo **mikroorganizmat**). Dallohen ndikimet e ndërsjella në mes qenieve të gjalla, ndikimet e qenieve të gjalla në mjedisin jetësor dhe ndikimi i njeriut në qenie të gjalla dhe në mjedis jetësor.

Ndikimi i njeriut në botën e gjallë ushtrohet në dy mënyra:

- i drejtpërdrejtë, p.sh., krijimi i sipërfaqeve të reja të tokës për mbjellje nga shkatërrimi i pyjeve, livadheve, kënetave etj. dhe
- jo i drejtpërdrejtë, duke i ndryshuar kushtet fiziko-kimike dhe biologjike të mjedisit, p.sh., ndotja e ajrit, ujit, tokës, shirat acidike etj.

Më gjerësisht do të mësoni në fund të pjesës së dytë të "Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor".



Në këtë diagram janë prezantuar: ndikimet abiotike (faktorët ekologjikë abiotikë - të jashtëm) dhe ndikimet biotike (faktorët ekologjikë biotikë - qeniet e gjalla) në organizëm; ndikimet e ndërsjella në mes qenieve të gjalla (bimëve, shtazëve dhe mikroorganizmave); ndikimet e ndërsjella në mes faktorëve ekologjikë të jashtëm (dritës, temperaturës, lagështisë, tokës, relievit, ajrit) dhe ndikimet e ndërsjella në mes faktorëve të jashtëm - abiotikë dhe faktorëve biotikë - qenieve të gjalla. Pra, këtu në mënyrë skematike është paraqitur mjedisi në të cilin një organizëm jeton, apo gjithçka që e rrethon dhe ndikon në atë organizëm.

Të mbahet në mend!

- Qeniet e gjalla ose popullatat janë të lidhura me mjedisin ku ndodhen dhe përshtaten për të jetuar aty.
- Mjedisi nënkupton kushtet fizike, kimike dhe biologjike, në të cilat një organizëm jeton.
- Ndikimet e mjedisit të jashtëm janë abiotike - që vijnë nga bota jo e gjallë dhe biotike - që vijnë nga qeniet e gjalla.

41

Nga kush ndikohen organizmat për rritje dhe zhvillim? A ndikon njeriu në zhvillimin e botës së gjallë?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secilit grup mësimdhënësi/ja ia jep pyetjet e përgatitura paraprakisht. U kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta shkruajnë përgjigjen. Së fundi, drejtuesi i secilit grup e lexon dhe kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

Grupi 1:

Përkrahja faktorët ekologjikë!

Grupi 2:

Trego rolin e ndikimeve abiotike!

Grupi 3:

Përkrahja ndikimet abiotike!

Grupi 4:

Përkrahja ndikimin e njeriut ndaj botës së gjallë!



Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit:

Tabela e koncepteve

Nxënësit udhëzohen që fletoren ta ndajnë më dysh dhe të shkruajnë:

Ndikimet abiotike	Ndikimet biotike

Pastaj, disa nga nxënësit i lexojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për bashkëpunim në grupe, saktësi të përgjigjeve të dhëna.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletore pune)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e ekosistemit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II. 8, II. 7, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biosfera dhe njësitë që e përbëjnë atë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon ndërtimin e biosferës.
- Përshkruan ndërtimin e ekosistemit.
- Emërton përbërësit e një ekosistemi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Ekologjia dhe mjedisi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ja parashtron disa pyetje dhe kështu merr informacione për njohuritë paraprake.


Disa nga pyetjet e mundshme:

Çka përfshin biosfera?

Nga kush përbëhet një ekosistem?

Përmend disa ekosisteme!


2.2. BIOSFERA DHE NJËSITË QË E PËRBËJNË ATË




Planeti Tokë - biosfera

Sot, ekologjia trajtohet edhe si shkencë që merret me studimin e strukturës dhe funksionimin e biosferës. Biosfera është shtresë shumë e hollë në sipërfaqe të planetit Tokë, në të cilën zhvillohet jeta. Kufiri i sipërm i biosferës shkon lart në qiell, deri atje ku zogjtë fluturojnë, dhe thellë në oqean, deri atje ku organizmat zhvillohen. Pra, biosfera përfshin të gjithë organizmat dhe çdo hapësirë ku ka jetë në Tokë.

Hapësira e caktuar në të cilën organizmat ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mjedisin e tyre të jashtëm, quhet **ekosistem**. Ekosistemi ndërtohet nga dy përbërës: njëri është jo i gjallë, i cili njihet me emrin **biotop (vendjetesë)**, dhe tjetri paraqet tërësinë e individëve të të gjitha llojeve që jetojnë në ekosistem dhe njihet me emrin **biocenozë (bashkësi jetësore)**.




Individët e një lloji zakonisht nuk jetojnë si të vetmuar, por jetojnë në grupe, që quhen **popullata**. Popullatat e të gjitha llojeve në një vendbanim të veçantë formojnë një **komunitet** (shoqëri). Popullatat e ndryshme të bimëve brenda një ekosistemi formojnë shoqëri bimore, kurse popullatat e ndryshme të shtazëve formojnë një shoqëri shtazore. **Shoqëritë** bimore, shtazore dhe mikroorganizmat (biocenoza), së bashku me faktorët e mjedisit të caktuar (biotopi) përbëjnë **ekosistemin** si njësi ndërtuese të biosferës. Ekosistemet përafërsisht të ngjashme formojnë **biomet**.



Ekosistemet janë njësi ndërtuese të biosferës.

Biosfera është shuma e të gjitha ekosistemeve në planetin Tokë. Si shembuj ekosistemesh mund të përmendim një lumë, liqen, moçal, livadh, një pyll, det, oqean etj. Ekosistemet mund të jenë shumë të vogla, siç është rasti i një cungu të drurit të kalbur, por dallohen dhe ekosisteme të mëdha, siç është oqeani.



Ekosistem pyjor



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe. Mësimdhënësi/ ja i udhëzon nxënësit ta lexojnë në heshtje njësinë mësimore, pastaj ia shpërndan pyetjet e përgatitura më parë secilit grup. Pas përfundimit të detyrës së dhënë prezantojnë përfaqësuesit e secilit grup dhe kështu vazhdohet deri në fund të të gjitha prezantimeve.

Grupi 1:
Përshkruaj biosferën!

Grupi 2:
Analizo një ekosistem!

Grupi 3:
Përshkruaj biomet!

Grupi 4:
Trego rolin dhe rëndësinë e një ekosistemi!



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Imagjinata e drejtuar**

Në këtë fazë të orës mësimore pasi që nxënësit e kanë përfunduar prezantimin do të udhëzohet që secili nxënës të vizatojë në fletoren e tij një ekosistem dhe ta përshkruajë atë. Disa nga nxënësit prezantojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin në grup, përshkrimin e ekosistemit, saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen ta plotësojnë fletore punën)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesve, konsumuesve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 6, II. 8, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Funksionimi i ekosistemit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon se si funksionon një ekosistem.
- Identifikon nivelet trofike të ekosistemit.
- Përshkruan zinxhirin ushqimor dhe rrjetën ushqimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë


Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ ja e shënon titullin e njësisë mësimore në tabelë, vazhdon me pyetje dhe nga nxënësit merr informacione për njohuritë paraprake.
 Disa nga pyetjet e mundshme:

2.2.1. Funksionimi i ekosistemit

Si funksionon ekosistemi?

Në ekosistem vazhdimisht qarkullojnë elemente të ndryshme (përbërës të materies) nga organizmat e gjallë (biotikë: bimët, kafshët dhe mikroorganizmat) te mjedisi jo i gjallë (abiotik: toka, uji ajri etj.) dhe anasjelltas. Organizmat e gjallë, varësisht prej rolit që kanë në ekosistem, i klasifikojmë në tri nivele ushqimore (trofike): **prodhuesit, konsumuesit dhe zbërthyesit.**





Nivelin e parë trofik në çdo ekosistem e përbëjnë bimët e gjelbra (**prodhuesit**). Bimët e marrin energjinë diellore përmes procesit të fotosintezës, për të prodhuar molekula të pasura me energji - glukozë, të cilat më vonë shndërrohen në amidon, yndyrë dhe proteina, si dhe lirojnë oksigjenin, që janë të domosdoshme për nivelet e tjera trofike.

Nivelin e dytë trofik e përbëjnë shtazët (**konsumuesit**). Ato marrin energjinë nga organizmat e tjerë. Shtazët që hanë prodhuesit (bimët), quhen konsumuesit (harxhuesit) e rendit të parë. Shtazët që hanë konsumuesit e rendit të parë quhen konsumues të rendit të dytë. Pastaj vijnë konsumuesit e rendit të tretë e kështu mer radhë.

Nivelin e tretë trofik e përbëjnë **zbërthyesit**, ku bëjnë pjesë disa lloje bakteresh, e disa lloje kërpudhash. Këta i zbërthejnë mbetjet e të gjithë organizmave të vdekur.

Organizmat e niveleve të mësipërme janë të renditur njëri pas tjetrit në formë të hallkave të zinxhirit dhe quhet **zinxhiri ushqimor**. Në natyrë zinxhirët zakonisht janë të përbërë nga 3-4 hallka dhe tregojnë se si organizmat në rende janë të varur nga njëri-tjetri. Shigjetat që lidhin organizmat në nivelet trofike tregojnë drejtimin nga shkon ushqimi. Lidhjet e tilla ushqimore (trofike) sigurojnë qarkullimin e materies dhe të energjisë në ekosistem.



Në ekosisteme, shumë zinxhirë ushqimorë shkojnë paralelisht ose gërrshetohen me njëri-tjetrin, duke formuar ato që quhen rrjeta ushqimore. Rrjeta, ashtu si zinxhiri ushqimor, ka prodhuesit në bazë. Rrjetat krijohen për shkak se një lloj i kafshës në ekosistem bën pjesë në më shumë se një zinxhir ushqimor. Në figurën anash, shigjetat tregojnë kush me kë ushqehet dhe në çfarë drejtimi rrjedh energjia. Në grupin e konsumuesve, edhe pse janë të rrallë, ka dhe organizma gjithçkangrënës (omnivorë), të cilët ushqehen edhe me ushqim bimor, edhe me ushqim shtazor, p.sh., ariu, vjedulla, njeriu etj.

Si ndikon largimi ose shtimi i një lloji në zinxhirin ushqyes? Nese largohet, apo futet ndonjë lloj i ri në zinxhirin ushqyes, do të prishet balanca ekologjike në ekosistem. Mbrojtja e bimëve dhe e shtazëve, si dhe mbrojtja e biotopit në të cilin ndodhin qeniet e gjalla, është me rëndësi të madhe.

Si funksionon një ekosistem?

Çka bëjnë bimët e gjelbra përmes procesit të fotosintezës?

Çfarë roli kanë zbërthyesit në ekosistem?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secilit grup mësimdhënësi/ja ia jep pyetjet e përgatitura paraprakisht, u kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta shkruajnë përgjigjen. Së fundi, drejtuesi i secilit grup e lexon dhe kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

Grupi 1:

Përkruaj nivelin e parë trofik!

Grupi 2:

Përkruaj nivelin e dytë trofik!

Grupi 3:

Analizo nivelin e tretë trofik!

Grupi 4:

Shpjego si funksionon një rrjetë ushqimore!



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Harta e konceptit

Gjatë kësaj faze mësimore nxënësit udhëzohen të modelojnë një zinxhir ushqimor.

Prodhues → konsumues → zbërthyes

Disa nga nxënësit e prezantojnë punën e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për përfshirjen gjatë gjithë orës mësimore, saktësinë e përgjigjeve të dhëna, bashkëpunimin në grup.

Detyrë:

(Të plotësojnë fletore pune, të hulumtojnë në internet për funksionimin e ekosistemit)

Reflektim për vejedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zërthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit, duke i shpjeguar nocionet prodhuesi dhe konsumuesi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 6, II. 6, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qarkullimi ciklik i materieve në ekosistem

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson qarkullimin e materieve në ekosistem.
- Përshkruan qarkullimin e lëndëve minerale në ekosistem.
- Tregon rëndësinë e materieve organike për organizmat e gjallë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Diskutim për njohuritë paraprake

Pasi mësimdhënësi/ja e shënon titullin e njësisë në tabelë, vazhdon me pyetje dhe nga nxënësit merr informacione për njohuritë paraprake të tyre.
 Disa nga pyetjet e mundshme:
 Nga kush prodhohen lëndët organike?

2.2.2. Qarkullimi ciklik i materieve në ekosistem

Në ekosisteme përherë bëhet qarkullimi i materieve në mes natyrës së gjallë dhe jo të gjallë, gjë që mundëson që jeta të vazhdojë pandërprerë dhe të ruhet uniteti i natyrës.

Lëndët organike që prodhohen nga bimët, shërbejnë për rritjen dhe mbijetesën e vetë bimëve dhe si ushqim për organizmat heterotrofe. Kur organizmat e gjallë vdesin, lëndët e tyre organike, nën veprimin e disa baktereve dhe disa kërpudhave zërthehen në lëndë minerale, të cilat përsëri përdoren nga bimët për të sintetizuar lëndë organike. Dhe kështu vazhdimisht, në mënyrë ciklike, bëhet shndërrimi i materies joorganike (ujit, karbonit, oksigjenit, azotit, fosforit, natriumit, kaliumit etj.) në organike dhe anasjelltas. Materia riciklohet vazhdimisht në ekosistem dhe në kushte normale nuk ka humbje të saj (është sistem i mbyllur).



Shigjetat na tregojnë sesi materiet minerale dhe uji qarkullojnë në cikël brenda një ekosistemi



Të mendohet

Njerëzit mund të ndihmojnë qarkullimin e materies në ekosistem. Ata mund t'i ndajnë mbeturinat organike (gjetnet e bimëve, barin, mbetjet e ushqimit etj.) nga mbeturinat e tjera. Mbeturinat organike do të shpërbëhen nga zbrërtuesit dhe pastaj mund të përdoren për plehërimin e tokës në kopsht, mbjelljen e luleve etj.

Pyetje

1. Trego nivelet trofike në ekosistem!
2. Dallo zinxhirin ushqimor dhe rrjetin ushqyes.
3. Shpjego rolin e zbrërtuesve në qarkullimin e lëndëve ushqyese në ekosistem.
4. Sqaro qarkullimin e materieve/mineraleve (joorganike) në ekosistem!
5. A riciklohet materia në ekosistem?

Detyrë

Pas një ekskursioni, p.sh., në një pyll, mundohu të bësh një zinxhir ushqimor. Vini re se çfarë është në fillim. Gjithashtu, bëje skemën e një rrjeti ushqimor nga ato që përmban një ekosistem i caktuar. Këto i komentoni në orën e biologjisë së bashku me nxënësit e tjerë dhe me mësimdhënësin.

49

Për çka shërbejnë lëndët organike?
Nga kush zbrërthehen lëndët organike?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Lexim i drejtuar

Pas një ligjërata të shkurtër nga mësimdhënësi/ja nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë mësimore të ndarë në paragrafë dhe pas çdo ndalesë mësimdhënësi nxit me pyetje drejtuar nxënësve.

Kështu vazhdohet deri në fund të njësisë mësimore. Pyetje të mundshme:

Nga e marrin ushqimin konsumuesit e rendit të parë?

Në çka i zbrërthejnë lëndët organike disa lloje të baktereve dhe kërpudhave?

Çka ndodh me materien në ekosistem?



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Organizuesi grafik i analogjisë

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja u jep detyrë nxënësve ta përshkruajnë “Qarkullimin e materieve në ekosistem” duke e paraqitur edhe në formë vizatimi, bazuar në libër. Pastaj, disa nga nxënësit prezantojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, për përshkrimin e temës së dhënë.

Detyrë:

(T'u përgjigjen pyetjeve në fund të njësisë mësimore)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zbrërthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit, duke i shpjeguar nocionet prodhuesi dhe konsumuesi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 4, II. 6, III. 1, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Qarkullimi i energjisë në ekosistem

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon se si energjia qarkullon në ekosistem.
- Përshkruan si kalon energjia nga një nivel trofik në nivelin tjetër.
- Vlerëson piramidat ekologjike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fletë A4, foto.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Kimi, Jeta dhe puna, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Diskutim për njohuritë paraprake

Pasi që mësimdhënësi/ja e shënon titullin e njësisë mësimore në tabelë, parashtron disa pyetje dhe kështu merr informacione për njohuritë paraprake.

Disa nga pyetjet e mundshme:



A mund të riciklohet energjia që rrjedh në ekosistem?

Nga e marrin bimët energjinë e dritës?

Me cilin proces energjinë që e marrin bimët nga dielli e shndërrojnë në energji kimike?

2.2.3. Qarkullimi i energjisë në ekosistem


Përkundër materies që riciklohet (sistem i mbyllur), energjia rrjedh në ekosistem (është sistem i hapur), kjo do të thotë se ajo humbet duke kaluar nga njëri nivel trofik, në tjetrin, pra nuk riciklohet. Vetëm rreth 1 % e energjisë diellore, që arrin në sipërfaqen e Tokës në formë të dritës, përdoret nga bimët. Këtë energji që bimët e marrin nga Dielli në saje të procesit të fotosintezës, e shndërrojnë në energji kimike përmes prodhimit të sheqerit (glukoza - molekula të pasura me energji) dhe lirohet oksigjeni. Gjatë kalimit të energjisë prej njërit nivel trofik në tjetrin, rreth 90 % e energjisë humbet në formë të nxehtësisë, rritjes dhe riprodhimit etj. Pra, vetëm rreth 10 % e energjisë së mbetur mund të shërbejë si ushqim për nivelin pasues trofik. Pasi humbja e energjisë është përafërsisht 90 % ndërmyjet çdo halke të zinxhirit ushqimor, nuk mbetet energji e mjaftueshme për konsumuesit e lartë.



Energjia e diellit që merret nga bimët, humbet përgjatë halkave të zinxhirit ushqimor

Mënyra më e mirë e paraqitjes së niveleve trofike janë **piramidat ekologjike - ushqimore**. Ato janë modele që tregojnë biomasën, numrin e organizmave apo energjinë në nivele trofike. Varesisht se çka merret për bazë për ndërtimin e tyre, dallojmë piramidat e biomasës, energjisë dhe të numrave.

Në bazën e të gjitha llojeve të piramidave gjenden prodhuesit, pastaj vijnë bimëngrënësit, konsumuesit primarë (mishngrënësit) dhe konsumuesit sekundarë (mishngrënësit e mishngrënëseve). Duke shkuar nga niveli i poshtëm e deri tek ai më i lartë, biomasë, energjia dhe numri i individëve shkon duke u zvogëluar. Zvogëlimi i biomasës, i energjisë apo i numrit të individëve mund të zvogëlohet deri në 90 %. Kjo ndodh për shkak se gjatë kalimit të energjisë nga një nivel në tjetrin, një sasi e energjisë humbet. Prandaj, në majë të piramidës kemi konsumues të paktë.



Të mbahet në mend!

- Një piramidë e ushqimit fillton me një bazë të gjerë individësh dhe përfundon me një individ.
- Duhet të ketë një ekuilibër midis të gjitha niveleve të piramidës së ushqimit, në mënyrë që një marrëdhënie ushqyese e niveluar të zgjasë në afat të gjatë.
- Me ndërhyrjen e pakontrolluar të njeriut, ndodh zhdukja e llojeve të ndryshme të bimëve e shtazëve në nivelet e piramidës ushqimore dhe mund të çrregullohet ekuilibri ekologjik: në ato raste, shtazët e varura nga niveli paraprak nuk mund të ekzistojnë më.

Pyetje

- A është sistem i hapur apo i mbyllur qarkullimi i energjisë në ekosistem?
- Sa është sasia e energjisë diellore që e përdorin bimët për kryerjen e procesit të fotosintezës?
- Duke analizuar figurën, shpjego rrjedhën e energjisë në zinxhirin ushqimor nga prodhuesi deri të konsumuesi më i lartë!
- Çfarë piramidash ushqyese dallojmë. Përshkruaj ato.

Detyrë

Pas vizitës në pyll, kompleto edhe një piramidë ushqimore. Për përgatitjen e një piramide ushqimore, nevojiten: letër kartoni, lapsi, vizorja, ngjyrrat. Pas ta vizatosh piramidën në karton, nga baza fillo dhe prezanto bimët, pastaj bimëngrënësit dhe mishngrënësit. Përshkruaj këtë piramidë ushqimore në orën e biologjisë.

51



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secilit grup mësimdhënësi/ja ia jep pyetjet e përgatitura paraprakisht, u kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta shkruajnë përgjigjen. Së fundi, drejtuesi i secilit grup lexon dhe kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

Grupi 1:
Përshkruaj qarkullimin e energjisë në ekosistem!

Grupi 2:
Çka ndodh gjatë kalimit të energjisë nga një nivel trofik në tjetrin?

Grupi 3:
Analizo piramidat e biomasës!

Grupi 4:
Përshkruaj piramidat e energjisë dhe të numrave!



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:
Harta e konceptit**

Në këtë fazë të orës krijohet një hartë koncepti që bashkon të gjithë informacionin që kanë për qarkullimin e energjisë në ekosistem. Disa nga nxënësit dalin te tabela dhe shkruajnë për të.

Qarkullimi i energjisë në ekosistem

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim në grup, saktësinë e përgjigjeve.

Detyrë:

(Të punojnë me mjete ricikluese një piramidë ushqimore)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Bën dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.
 - Organizmi është qenie e gjallë. - Popullata definohehet si grup i bimëve ose i shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të caktuar.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II. 1, II. 8, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekologjia e popullatave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan popullatat.
- Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në madhësinë e popullatave.
- Shpjegon faktorët demografikë, cilësinë e vendjetesës, grabitshmërinë, marrëdhëniet brenda dhe ndërlojore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Fizikë, Jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim i përbashkët

Mësimdhënësi/ja e pasi shënon titullin e njësisë në tabelë vazhdon me pyetje drejtuar nxënësve dhe nga ta merr informata për njohuritë paraprake. Disa nga pyetjet e mundshme:
 Çka kuptoni me termin popullatë?

2.3. EKOLOGJIA E POPULLATAVE

2.3.1. Ç'kuptojmë me popullatë?

Me popullatë kuptojmë tërësinë e individëve të një lloji, në një vendbanim (habitat) të caktuar, p.sh. popullata e arinjve në Kosovë. Individët e një popullate çifëzohen për t'u riprodhuar, hyjnë në konkurrencë për të shfrytëzuar të njëjtat burime të mjedisit si ushqim, vendstrehim etj. Individët e një popullate bashkëprojnë për të shfrytëzuar sa më mirë rezervat ushqimore, por dhe për t'u mbrojtur nga grabitqarët. Në një popullatë individët vdesin, por dhe riprodhohen, prandaj madhësia e popullatës ndryshon vazhdimisht.



Njëkoqe buajsh duke u mbrojtur nga grabitqari

2.3.2. Madhësia e popullatës

Madhësia e popullatës zakonisht përcaktohet nga numri i individëve që hyjnë në përbërjen e asaj popullate. Madhësia e popullatave varet nga shumë faktorë, si nga:

1. **Proceset demografike.** Veçori e rëndësishme e popullatave është lindshmëria - aftësia riprodhuese. Disa lloje, p.sh., insektet, peshqit, krimbat parazitare, kanë aftësi riprodhuese të lartë, sepse prodhojnë numër të madh vezësh, ndërsa disa lloje të tjera karakterizohen me aftësi të ulët riprodhuese (p.sh., shpendët dhe gjitarët). Aftësia e ulët riprodhuese e tyre është rezultati

numrit të vogël të të vegjëlvë që lindin dhe i ciklit të gjatë të jetës që kanë. Gjithashtu, emigrimi (ikja) dhe pleqëria zvogëlojnë potencialin për rritjen e popullatës nëpërmjet riprodhimit. Në madhësinë dhe dendësinë e popullatave ka rëndësi të madhe edhe ardhja (imigrimi) i individëve të rinj.



Peshqit llojnë numër të madh të vezëve



Shpendët bëjnë numër të vogël të vezëve

Ndryshimi i madhësisë së popullatës = lindshmëria - vdekshmëria + imigrimi - emigrimi

- Cilësia e vendjetesës** (habitatit, mjedisit). Është njëri prej faktorëve që përcakton madhësinë e popullatës, p.sh., popullata e një lloj bime, varet nga hapësira që ka në dispozicion dhe kushtet që ajo ofron për zhvillim, pastaj popullata e një lloji të shtazës varet fillimisht nga madhësia e popullatës së bimës dhe faktorëve të tjerë të mjedisit rrethues e kështu me radhë.
- Marrëdhëniet brenda llojit dhe ndërmjet llojeve** janë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë madhësinë dhe dendësinë e popullatës. Këtu hyjnë konkurrenca, e cila paraqet garën e individëve të llojit të njëjtë ose të llojeve të ndryshme për burime të ushqimit, të hapësirës etj.
- Grabitshmëria.** Grabitqarët zvogëlojnë popullatën e shtazëve përkatësisht të bimëve. Meqë nuk ekziston një dallim i qartë ndërmjet të ushqyerit me organizëm të gjallë bimor dhe shtazor, shpeshherë edhe bimëngrënësit konsiderohen grabitqarë. P.sh., një shtazë omnivore ushqehet edhe me bimë, edhe me shtazë dhe në këtë rast nuk mund të dallohen dy mënyra të të ushqyerit.

Përmend disa popullata që njihni!
Pse disa organizma kanë numër të madh të individëve?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditarët e të nxënët

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë (duke mbajtur shënime) dhe të interpretojnë (duke e plotësuar modelin e ditarit dypjesësh), si në tabelë. Në njërën anë, do t'i shkruajnë konceptet kryesore dhe përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptimplota. Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Popullatë	
Proceset demografike	Lindshmëria, vdekshmëria, imigrimi, emigrimi
Cilësia e vendjetesës	
Marrëdhëniet brenda llojit dhe ndërmjet llojit	
Grabitshmëria	
Sëmundjet	



Përforsimi: Konsolidimi i të nxënët:
Rrjeti i diskutimit

Në pjesën përfundimtare, mësimdhënësi/ja i fton nxënësit që të marrin pjesë në diskutimin e hapur për gjithë klasën, kërkon nga nxënësit që, bazuar në atë që kanë lexuar deri tani dhe sa kanë kuptuar, ta japin shpjegimin përkatës (duke u përgjigjur në konceptet për të cilat kanë shkruar).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, përfshirjen gjatë orës mësimore.

Detyrë:

(T'u përgjigjen pyetjeve në fund të njësisë mësimore)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shfrytëzon organizues grafikë për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 4, II. 8, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Dinamika e popullatave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon faktorët që ndikojnë në dendësinë e popullatave.
- Analizon diagramet si tregues të ndryshimit të popullatave.
- Shpjegon dinamikën e popullatës njerëzore ndër vite.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Jeta dhe puna, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Diskutim për njohuritë paraprake

Pasi që mësimdhënësi/ja e shënon titullin e njësisë mësimore në tabelë, parashtron disa pyetje dhe kështu merr informacione për njohuritë paraprake.


Disa nga pyetjet e mundshme:

Cilët janë faktorët që ndikojnë në numrin e individëve brenda një popullate?

Pse te disa popullata numri i individëve zvogëlohet?

Trego arsyen pse disa gjallesa kanë numër të madh të individëve!

2.3.3. Dinamika e popullatës - ndryshimet afatshkurtra dhe afatgjata të popullatës



Faktorët që ndihmojnë në dendësinë e popullatës


2.3.3.1. Si zhvillohet dinamika e popullatës?

Popullatat nuk mund të rriten pambarimisht. Disa popullata pasi arrijnë një madhësi të caktuar, stabilizohen (kanë luhatje të vogël të numrit të individëve), ndërsa të tjerat karakterizohen me rritje dhe rënie të shpejtë të numrit të individëve. Kjo ndodh te popullatat e llojeve bimore dhe atyre shtazore.

2.3.3.2. Diagramet - tregues të ndryshimit të popullatave


Me dinamikë të popullatës kuptojmë ndryshimet që pëson dendësia e popullatës me kalimin e kohës. Kryesisht, popullata rritet për shkak të lindjeve (lindshmërisë) dhe zvogëlohet për shkak të

vdekjeve (vdekshmërisë). Shumë organizma bimorë dhe shtazorë kanë aftësi të prodhojnë numër të madh të pasardhësve për një kohë të shkurtër (potencial biologjik të lartë). Nëse këta organizma do të kenë në dispozicion ushqim dhe hapësirë të pakufizuar, popullatat e tyre do të rriten me një shpejtësi të madhe. Nëse e vendosim në grafik rritjen e këtyre popullatave, lakorja do të marrë formën e shkronjës J. Mirëpo asnjë popullatë në natyrë nuk ka ushqim dhe hapësirë të pakufizuar, kjo ndikon në rritjen e konkurrencës për hapësirën dhe për burime të tjera për jetë mes organizmave që jetojnë në të njëjtin vend. Si rezultat i kësaj, rritja e popullatës do të ngadalësohet dhe madhësia e popullatës fillon të stabilizohet, ndërsa lakorja merr formën e shkronjës S.



Lakorja reflekton rritje të shpejtë dhe stabilizim të popullatës

Kur rritet dendësia e popullatës më shumë sesa ka hapësirë dhe ushqim, ose për shkak të përkeqësimit të faktorëve të mjedisit të jashtëm, atëherë shtohet numri i vdekjeve dhe popullata fillon të zvogëlohet. Kjo bën që popullata të ketë rritje dhe rënie të numrit të individëve dhe lakorja merr formën e shkronjës M. Forma M e lakores është te popullatat jostabile, individët e të cilëve kanë zakonisht jetë të shkurtër, p.sh., te insektet, gjatë dimrit, si rezultat i temperaturave të ulëta dhe i mungesës së ushqimit, popullata zvogëlohet. Ata individë të paktë që mbijetojnë deri në pranverë, shtohen gjatë verës.



Lakorja reflekton rritjen e shpejtë me katastrofën pasuese

2.3.3.3. Si e kemi dinamikën e popullatës njerëzore

Zhvillimi i popullatës njerëzore në përgjithësi ka ndjekur një trend të qartë rritës. Rritja aktualisht është e formës J. Kjo ka ndodhur për shkak të kushteve të mira si ushqimi, hapësira, përkujdesi mjekësor etj. Kjo rritje do të vazhdojë deri sa Toka nuk do të ketë më kapacitet të mbajë më shumë njerëz. Kur të arrihet numri maksimal i individëve në Tokë, atyre do t'u zvogëlohet hapësira dhe ushqimi e si rrjedhojë dendësia e popullatës fillon të stabilizohet dhe lakorja do të bëhet së shpejti e formës S. Besohet se kjo mund të ndodhë kur popullata njerëzore të arrijë midis nëntë dhe dhjetë miliardë. Ndoshta këtë rritje do ta arrijë rreth vitit 2040!



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Sistemi ndërvetprues i shënimeve (INSERT)

Nxënësit udhëzohen fillimisht ta lexojnë tekstin pastaj jepen sqarimet për përdorimin e shenjave:

V - pohon se ajo që lexuan është e njohur prej tyre (popullata);

+ - një pjesë e informacionit është i ri për nxënësit (dinamika e popullatës, diagram-tregues i ndryshimit të popullatës);

? - informacion i paqartë ose ka diçka më shumë që duhet të dinë rreth këtij informacioni.

Pasi nxënësit e lexojnë tekstin dhe i vendosin shenjat, mësimdhënësi/ja parashtrohet pyetjet:

Cilat njohuri që i kishit më parë janë pohuar në tekst?

Çfarë informacioni të ri nxorët gjatë leximit?

Cilat janë pyetjet që keni?

V, +, dhe ?, mësimdhënësi/ja e bën përmbledhjen e informacionit në tabelë, pasi nxënësit i kanë bërë komentet dhe diskutimet e tyre. Ndalet në shpjegimin dhe sqarimin e atij informacioni, për të cilin nxënësit kanë nevojë.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët: Harta e konceptit

Mësimdhënësi/ja i fton nxënësit të punojnë një hartë koncepti në formë të përmbledhjes me njohuritë që nxënësit i kanë marrë gjatë orës mësimore, pastaj disa nga nxënësit dalin te tabela dhe i shkruajnë ato.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim, saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrë:

(Të hulumtojnë në internet për dinamikën e popullatës njerëzore ndër vite)

Reflektim përvojëdhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 6, II. 8, III. 1, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndërveprimet mes qenieve të gjalla

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon ndërveprimet mes gjallesave të ndryshme.
- Përshkruan ndërveprimet e dëmshme dhe të dobishme mes organizmave.
- Vlerëson rëndësinë e simbiozës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Jeta dhe puna, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Imagjinata e drejtuar

Mësimdhënësi/ja prezanton disa ndërveprime mes organizmave me anë të fotove ose me video. Pastaj, fillon diskutimi lidhur me atë se çfarë kanë parë nxënësit.

Pyetje për diskutim:

Cila është arsyeja pse organizmat i bëjnë konkurrencë njëri-tjetrit?

A janë të gjitha shtazët grabitqare?

2.3.4. Ndërveprimet mes qenieve të gjalla

Përveç faktorëve abiotikë të mjedisit, organizmat ndikohen edhe nga ndërveprimet që ata kanë mes vete. Ndërveprimet në mes organizmave mund të jenë të **dëmshme** (kur njëri organizëm përfiton, ndërsa tjetri dëmtohet, p.sh.: konkurrenca, grabitja dhe parazitizmi), të **dobishme** (ndihma e ndërsjellët (kur dy organizmat përfitojnë nga marrëdhënia e tyre, p.sh.: simbioza (mutualizmi) dhe **neutrale**.

Konkurrenca është marrëdhënie ekologjike kur në të njëjtën kohë organizmat e ndryshëm, ose popullatat përpigën të përdorin të njëjtat burime të ushqimit dhe hapësirës. Konkurrenca ndodh mes individëve të të njëjtit lloji (brendallojore), por dhe individëve të llojeve të ndryshme (ndërllojore), të cilët kanë kërkesa të përbashkëta. Konkurrenca brendallojore gjithmonë është më e ash për sesa ajo ndërllojore, sepse individët që i takojnë të njëjtit lloj varen nga i njëjti lloj ushqimi, e njëjta hapësirë, i njëjti material ndërtimor, p.sh., për fole të etj. Zakonisht konkurrenca ndodh kur organizmat garojnë mes vete për ushqime, hapësirë dhe gjetjen e partnerit seksual. Konkurrenca është forcë e rëndësishme evolutive, p.sh. bimët bëhen më të gjata duke konkurruar mes vete për dritë.


Grabitshmëria është një ndërveprim i dëmshëm kur individi i një lloji (grabitqari) ha individ të një lloji tjetër (prejë).



Shajponja dhe preja e saj



Eshka - kërpuha që paraziton në drunjt



Likeni - simbiozë e përhershme. Është gjallesë e veçantë që përbëhet nga një lloj kërpuha dhe një lloj alge. Algat furnizohen me ujë dhe materie minerale nga hifet e kërpuhave, ndërsa kërpuha nga alga merr ushqimin që ajo e krijon me fotosintezë.



Pjalnimi i bimëve dhe marrja e nektarit nga insektet - simbiozë e përkohshme

Parazitizmi është ndërveprim kur një organizëm ushqehet me ushqim të gatshëm nga nikoqiri i vet, por zakonisht nuk e shkatërron atë. Një shembull parazitizmi janë kërpuhat parazite që rriten në trunjtet e bimëve ku marrin ushqimin e gatshëm, p.sh., eshka.

Ndërveprimet me përfitime të dyanshme janë dukuri kur individët e llojeve të ndryshme bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të dobishme dhe kjo quhet **simbiozë**. Kjo marrëdhënie është forma më e avancuar e bashkëveprimit ndërmjet dy llojeve, ku secili mund të jetojë, të zhvillohet dhe të shumohet vetëm në praninë e llojit tjetër. Simbioza mund të jetë e përhershme ose e përkohshme. Shembulli më i mirë i një ndërveprimi (simbiozë) të përhershëm janë **likenet**. Dukurinë e simbiozës me përfitim të dyanshëm, por të përkohshëm, e kemi edhe ndërmjet bimëve dhe shtazëve, p.sh., bimët me lule gjatë kohës së lulëzimit vizitohen nga insektet, të cilat nga lulet marrin ushqimin, ndërsa bimët pjalmohen nga insektet.

Neutralizmi është dukuria kur individët e llojeve të ndryshme bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, por nuk kanë as dëme as përfitime nga njëri-tjetri.

2.3.4.1. Nisha ekologjike

Konkurrenca ndërmjet individëve të llojeve të ndryshme është më e vogël, sesa konkurrenca ndërmjet individëve të llojit të njëjtë. Pse është kështu? Çdo lloj bimor apo shtazor preferon ushqim të ndryshëm, ka armiqtë e ndryshëm dhe kërkon një hapësirë të ndryshme jetese.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secilit grup mësimdhënësi/ja ia jep pyetjet e përgatitura paraprakisht. U kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta shkruajnë përgjigjen, mandej drejtuesi i secilit grup e lexon dhe kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

Grupi 1:
Përkrahja e konkurrencës!

Grupi 2:
Analizo grabitshmërinë dhe parazitizmin!

Grupi 3:
Përkrahja e ndërveprimeve me përfitime të dyanshme!

Grupi 4:
Analizo neutralizmin!



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve: Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Në këtë fazë të orës nxënësit udhëzohen të shkruajnë “Roli dhe rëndësia e simbiozës”. Disa prej shkrimeve lexohen dhe komentohen nga nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim në grup, saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen të hulumtojnë në internet për ndërveprimet mes gjallesave)

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II. 6, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nisha ekologjike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan nishën ekologjike.
- Vlerëson rolin dhe rëndësinë e nishës ekologjike për organizmat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Jeta dhe puna, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Diskutim për njohuritë paraprake


Mësimdhënësi/ja parashtron pyetje dhe nga nxënësit merr informata për njohuritë që kanë. Disa nga pyetjet e mundshme:

A jetojnë të gjithë organizmat në kushte të njëjta mjedisore?
 Armiqtë i kanë të njëjtë organizmat?

A mund të jetojnë pranë njëri-tjetrit organizmat e llojeve të ndryshme edhe pa i bërë konkurrencë?



Eshka - kërpudha që paraziton në drunjt



Likeni - simbiozë e përhershme. Është gjallesë e veçantë që përbëhet nga një lloj kërpudhe dhe një lloj alge. Algat furnizohen me ujë dhe materie minerale nga hifet e kërpudhave, ndërsa kërpudha nga alga merr ushqimin që ajo e krijon me fotosintezë.



Pjalnimi i bimëve dhe marrja e nektarit nga insektet - simbiozë e përkohshme

Parazitizmi është ndërveprim kur një organizëm ushqehet me ushqim të gatshëm nga nikoqiri i vet, por zakonisht nuk e shkatërron atë. Një shembull parazitizmi janë kërpudhat parazitare që rriten në trunjtet e bimëve ku marrin ushqimin e gatshëm, p.sh., eshka.

Ndërveprimet me përfitime të dyanshme janë dukuri kur individët e llojeve të ndryshme bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të dobishme dhe kjo quhet **simbiozë**. Kjo marrëdhënie është forma më e avancuar e bashkëveprimit ndërmjet dy llojeve, ku secili mund të jetojë, të zhvillohet dhe të shumohet vetëm në praninë e llojit tjetër. Simbioza mund të jetë e përhershme ose e përkohshme. Shembulli më i mirë i një ndërveprimi (**simbiozë**) të përhershëm janë **likenet**. Dukurinë e simbiozës me përfitim të dyanshëm, por të përkohshëm, e kemi edhe ndërmjet bimëve dhe shtazëve, p.sh., bimët me lule gjatë kohës së lulëzimit vizitohen nga insektet, të cilat nga lulet marrin ushqimin, ndërsa bimët pjalmohehen nga insektet.

Neutralizmi është dukuria kur individët e llojeve të ndryshme bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, por nuk kanë as dëme as përfitime nga njëri-tjetri.

2.3.4.1. Nisha ekologjike

Konkurrenca ndërmjet individëve të llojeve të ndryshme është më e vogël, sesa konkurrenca ndërmjet individëve të llojit të njëjtë. Pse është kështu? Çdo lloj bimor apo shtazor preferon ushqim të ndryshëm, ka armiqtë e ndryshëm dhe kërkon një hapësirë të ndryshme jetese.



Nisha (vatra) ekologjike paraqet pozicionin që një lloj organizmi zë në vendbanimin e caktuar. Në pyll llojet i shmangen konkurrencës për ushqim, banim duke zënë nisha të ndryshme ekologjike. Në këtë mënyrë llojet bëjnë jetën pranë njëri-tjetrit, por nuk i bëjnë njëri-tjetrit konkurrencë dhe njëri lloj nuk e detyron tjetrin të largohet.

Nisha (vatra) ekologjike të ndryshme të zogjve në një pyll

Të mbahet në mend!

- Ndërveprimet në mes individëve të llojit të njëjtë dhe atyre të llojeve të ndryshme mund të jenë: të dëmshme, të dobishme dhe neutrale.
- Ndërveprimet e dëmshme janë: konkurrenca, grabitshmëria dhe parazitizmi, ndërsa e dobishme është simbioza.
- Konkurrenca bëhet për ushqim, territor, gjetjen e partnerit seksual dhe është më e ashpër brenda llojeve ndërmjet llojeve.
- Nisha ekologjike është çetësi i jetës së egër. P.sh., një lis në një pyll iu ofron llojeve të ndryshme vendbanim të veçantë. Kjo pengon konkurrencën ndërmjet llojeve.

Pyetje

1. Përmendi ndërveprimet në mes qenieve të gjalla.
2. Kur mund të lindë konkurrenca ndërmjet individëve të të njëjtit lloj ose llojeve të ndryshme?
3. Pse konkurrenca brendallojore është më e ashpër sesa ajo ndërllojore?
4. Çkupton me grabitshmëri?
5. Ç'është parazitizmi?
6. Shpjego rëndësinë e simbiozës!
7. Çkupton me termin nisha ekologjike dhe ku qëndron rëndësia e saj?

60



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Leximi i drejtuar

Pas një ligjërate të shkurtër nga mësimdhënësi/ja nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë mësimore të ndarë në paragrafë dhe pas çdo ndalese mësimdhënësi nxit me pyetje drejtuar nxënësve.

Kështu vazhdohet deri në fund të njësisë mësimore. Pyetje të mundshme:

Konkurrenca mes individëve të llojeve të ndryshme a është më e madhe apo më e vogël, sesa mes individëve të të njëjtit lloj?

A ushqehen me ushqim të njëjtë llojet bimore dhe shtazore?

Çka paraqet nisha ekologjike?



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Shënime mbi shënime

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që të shkruajnë një shembull të nishës ekologjike duke u bazuar në libër, pastaj disa nga nxënësit i lexojnë shembujt.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, përfshirjen në diskutim.

Detyrë:

(T'u përgjigjen pyetjeve në fund të njësisë mësimore)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shfrytëzon organizues grafikë për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme. Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 3, II. 8, III. 3, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan faktorët që e rregullojnë dendësinë e popullatave të ndryshme.
- Vlerëson ndërveprimet mes qenieve të gjalla.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Jeta dhe puna, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ja parashtron disa pyetje lidhur me njësitë e kaluara mësimore dhe kështu merr informacione për njohuritë që kanë nxënësit.

2.3.3. Dinamika e popullatës - ndryshimet afatshkurtra dhe afatgjata të popullatës



2.3.3.1. Si zhvillohet dinamika e popullatës?

Popullatat nuk mund të rriten pambarimisht. Disa popullata pasi arrijnë një madhësi të caktuar, stabilizohen (kanë luhatje të vogël të numrit të individëve), ndërsa të tjerat karakterizohen me rritje dhe rënie të shpejtë të numrit të individëve. Kjo ndodh te popullatat e llojeve bimore dhe atyre shtazore.

2.3.3.2. Diagramet - tregues të ndryshimit të popullatave

Me dinamikë të popullatës kuptojmë ndryshimet që pëson dendësia e popullatës me kalimin e kohës. Kryesisht, popullata rritet për shkak të lindjeve (lindshmërisë) dhe zvogëlohet për shkak të

2.3.4. Ndërveprimet mes qenieve të gjalla

Përveç faktorëve abiotikë të mjedisit, organizmat ndikohen edhe nga ndërveprimet që ata kanë mes vete. Ndërveprimet në mes organizmave mund të jenë të **dëmshme** (kur njëri organizëm përfiton, ndërsa tjetri dëmtohet, p.sh.: konkurrenca, grabitja dhe parazitizmi), të **dobishme** (ndihma e ndërsjellët (kur dy organizmat përfitojnë nga marrëdhënia e tyre, p.sh.: simbioza (mutualizmi) dhe **neutrale**.

Konkurrenca është marrëdhënie ekologjike kur në të njëjtën kohë organizmat e ndryshëm, ose popullatat përqipen të përdorin të njëjtat burime të ushqimit dhe hapësirës. Konkurrenca ndodh mes individëve të të njëjtit lloj (brendallojore), por dhe individëve të llojeve të ndryshme (ndërllojore), të cilët kanë kërkesa të përbashkëta. Konkurrenca brendallore gjithmonë është më e ashpër sesa ajo ndërlojore, sepse individët që i takojnë të njëjtit lloj varen nga i njëjti lloj ushqimi, e njëjta hapësirë, i njëjti material ndërtimor, p.sh., për foletë etj. Zakonisht konkurrenca ndodh kur organizmat garojnë mes vete për ushqime, hapësirë dhe gjetjen e partnerit seksual. Konkurrenca është forcë e rëndësishme evolutive, p.sh. bimët bëhen më të gjata duke konkurruar mes vete për dritë.

Grabitshmëria është një ndërveprim i dëmshëm kur individi i një lloji (grabitqari) ha individ të një lloji tjetër (prenë).



Shqiponja dhe preja e saj

58



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të orës mësimore pasi që nxënësit e kanë përfunduar prezantimin do të udhëzohet që secili grup t'u bëjë pyetje grupeve të tjera lidhur me detyrën e prezantuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përfshirjen gjatë orës mësimore, saktësinë e përgjigjeve të dhëna, bashkëpunimin në grup.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen të hulumtojnë në internet për nishën ekologjike)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Disa nga pyetjet e mundshme:

Si njihen ndryshimet afatshkurtra dhe afatgjata në një popullatë?

Trego arsyen pse ka rritje popullata njerëzore viteve të fundit!

Nga kush ndikohen organizmat, përveç faktorëve abiotikë të mjedisit?

Kur ndodh konkurrenca mes llojeve të njëjta?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe. Mësimdhënësi/ja ia shpërndan pyetjet e përgatitura më parë secilit grup. Pas përfundimit të detyrës së dhënë përfaqësuesit e secilit grup prezantojnë dhe kështu vazhdohet deri në fund të të gjitha prezantimeve.

Grupi 1:

Përshkruaj dinamikën e popullatës!

Grupi 2:

Trego faktorët që ndikojnë në dendësinë e popullatës!

Grupi 3:

Përshkruaj ndërveprimet e dëmshme mes organizmave, jep shembuj!

Grupi 4:

Përshkruaj ndërveprimet e dobishme mes popullatave, jep shembuj!

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënët të temës:
 Përshkruan se si përshtatjet shërbejnë për ta mundësuar mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjellje - sigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi duke e gjetur ose tërhequr partnerin ose shpërndarja e farave-fryteve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 6, II. 1, III. 5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sjelljet e shtazëve

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Përcakton sjelljet e shtazëve.
- Shpjegon sjelljet e lindura dhe të fituara të shtazëve.
- Bën krahasimin mes sjelljeve të lindura, të fituara dhe të arsyeshme të shtazëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Ekologjia dhe mjedisi, Jeta dhe puna.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Përvijim i të menduarit

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë temën mësimore. Nxënësit nxiten që t'i shkruajnë në fletoret e tyre të gjitha njohuritë që kanë lidhur me temën. Pastaj, mësimdhënësi/ja i merr mendimet e tyre dhe i shkruan në tabelë. Pranoen edhe idetë që nuk janë shumë të sakta. Nxënësit nxiten të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit.

2.4. SJELLJET E SHTAZËVE

Një karakteristikë e veçantë e llojeve shtazore është sjellja e tyre ndaj organizmave të tjerë, si dhe ndaj mjedisit të jashtëm, p.sh., nga drita, nxehtësia, veprimet kimike dhe fizike, mashkulli rival, grabitqari, nga uria etj.

Sjelljet e shtazëve përfshijnë: mënyrën e strehimit, gjetjen e ushqimit, sigurimin e gjumit, shmangien e grabitqarëve, zgjedhjen e partnerit, mbrojtjen e të vegjëlve, ushqyerjen dhe kujdesin ndaj tyre etj. Në shumicën e rasteve, këto aktivitete janë të lindura (të trashëguara ose instinkte), e në raste të caktuara edhe të fituara (nga përvoja). Shkenca që merret me studimin e sjelljeve të shtazëve quhet etologji.

2.4.1. Sjelljet e lindura të shtazëve dhe të njeriut

A ju ka ndodhur që të shihni harabelat si individ apo në tufë që posa e vërejnë macen, fluturojnë - ikin? Në saje të sjelljeve të lindura, shtazët mund të kryejnë një varg veprimesh për të cilat nuk janë mësuar më parë.

Dallojmë sjelljet e lindura të thjeshta dhe ato komplekse. Ato të thjeshta quhen **reflekse**, janë reagime automatike ndaj ngacmimit të jashtëm, si për shembull: largimi i shpejtë i dorës kur prekim diçka të nxehtë etj.

Sjelljet e lindura komplekse quhen **instinkte**. Për shembull, mëzi i pelës sapo të lindë, edhe pse shumë i lëkundur, vendoset në këmbët e veta. Për disa orë, ai mund ta ndjekë nënën dhe të thithë. Gjithashtu, thurja e rrjetës nga merimanga është proces i komplikuar, të cilin merimanga mund ta bëjë pa problem që në herën e parë. Pra, llojet e ndryshme të shtazëve instinktivisht bëjnë ndërtimin e strofkave dhe të foleve. Kujdesi për pasardhës i shtazëve gjithashtu është një dukuri natyrore e bazuar në instinkte që janë të trashëguara nga prindërit. Edhe te njeriu dallojmë sjellje instinktive, siç janë: mbyllja e kapakëve të syve, teshtima, tajiia e pëshymës, thithja e qumështit nga të porsalindurit etj.




Sjellja e mëzit të kalit



2.4.2. Sjellet e fituara

Këto sjellje fitohen gjatë jetës dhe janë rezultat i procesit të të mësuarit, përvojës dhe praktikës. Aftësinë që kanë shtazët për të arritur sjellje të fituara, njeriu e shfrytëzon për dresimin e tyre. Janë të njohura sjelljet e fituara me mësim nga dresimet, p.sh., e luanit, ariut, delfinit, kalit, elefantit, papagallit etj. Aktivitetet e njeriut siç janë noti, vozitja e automjetit, luajtja me piano etj., paraqesin punë të automatizuara, të cilat gradualisht fitohen dhe shndërrohen në sjellje të fituara.

Thurja e errjetës nga marimanga




Ndërtimi i strofkës nga urithi



Kujdesi për të vegjlit



Dresura e delfinit



Vozitja e automjetit - sjellje e ftuar



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Ditarët e të nxënët

Mësimdhënësi/ja organizon në dyshe grupet e punës. Udhëzon nxënësit se çfarë duhet të lexojnë, duke mbajtur shënime, dhe të interpretojnë, duke e plotësuar modelin e ditarit dy pjesësh, si në tabelë.

Në njëerën anë do t'i shkruajnë konceptet kryesore, e përkrah saj do t'i sqarojnë këto koncepte me fjali të shkurtra dhe kuptimplota.

Shembull:

Konceptet	Sqarimet
Sjelljet e lindura	Të thjeshta dhe komplekse
Sjelljet e fituara	
Sjelljet e arsyeshme	



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët: Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që në fletoret e tyre të shkruajnë shembuj për sjelljet e shtazëve. Disa nga nxënësit prezantojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, përfshirjen në diskutim.

Detyrë:

(Të plotësojnë fletore punën dhe të hulumtojnë në internet për sjelljet e shtazëve)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh., ujqit udhëtojnë në grup për ta mbrojtur territorin e tyre, rritin të vegjlit (këlyshët) e tyre dhe e gjuajnë prenë e madhe).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, I. 4, II. 6 III. 5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon sjelljet bashkëvepruese të shtazëve.
 - Krahason sjelljet në mes të grupeve të ndryshme të shtazëve.
 - Numëron mënyrat e komunikimit mes shtazëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto të shtazëve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuha dhe komunikimi, Jeta dhe puna, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Diskutim për njohuritë paraprake

Mësimdhënësi/ja e shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë dhe vazhdon me pyetje. Nga nxënësit merr informacione për njohuritë paraprake.
 Disa nga pyetjet e mundshme:
 Pse shumica e shtazëve jetojnë në grupe?

2.4.3. Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve - gjuha komunikuese e tyre

Disa lloje të shtazëve jetojnë të vetmuara, llojet e tjera një periudhë të vitit jetojnë të ndara, ndërsa periudhën tjetër janë në çift, kurse disa lloje të tjera të shtazëve jetojnë në grupe ose në bashkësi. Sjelljet e kafshëve që jetojnë në bashkësi, quhen sjellje bashkëvepruese. Sjelljet bashkëvepruese janë të ndryshme, si: sjelljet shoqërore, sjelljet territoriale, komunikimi, sjelljet ciklike etj.
Sjelljet shoqërore. Kafshët kryesisht jetojnë në grupe shoqërore për të siguruar më lehtë ushqimin, mbrojtjen, migrimin, gjetjen e partnerit etj., dhe kjo e mundëson mbijetesën e llojit. Dallohen shoqërizime të ndryshme, të llojeve të shtazëve, siç janë: shoqëria e bletëve, kolonia e thneglave, tufa e peshqve, shpendëve, llavat e ujqve, deleve, drerëve, kopetë e gjedhëve etj. Shoqërizimet e shtazëve dallohen si të përhershme dhe të përkohshme. Të përhershme janë, p.sh., shoqëria e bletëve dhe kolonia e thneglave. Të përkohshme janë shoqërizimet e shpendëve që bëhen zakonisht në kohën kur ndërtojnë fole në afërsi të njëri-tjetrit dhe gjatë shtegtimeve. Gjithashtu, disa gjarë, siç janë, p.sh., hienat, luanët, ujqit, me rastin e kërkimit të ushqimit, tubohen në grupe me qëllim që ta zënë më lehtë gjuhën. Edhe bimëngrënësit e savanave të Afrikës, siç janë zeburat, buajt, antilopat etj., jetojnë në kope, sepse kjo u ndihmon të mbrohen prej armiqve.




Shoqëria e bletëve



Kolonia e thneglave


Territori. Shumica e shtazëve pjesën më të madhe të jetës, veçmas në kohën e shumimit, e kalojnë në territore të caktuara. Grupet e ndryshme të shtazëve caktojnë territorin e vet, në mënyrë instinktive. Për shënimin e territorit, lloje të ndryshme kafshësh shfrytëzojnë lëndët me erë karakteristike, të cilat vetë i tajojnë, p.sh., qeni, ujqiu, ariu, dhepra etj. Kufirin e territorit e shënojnë me anë të urinimit. Ndërsa lepuri kufirin e përcakton me anë të jashtëqitjes. Në raste të dëpërtimit të individëve të tjerë brenda kufirit të shënuar, në mënyrë instinktive, shtazët shprehin reagimet e tyre me pamjen e jashtme të bishtit, të veshëve, rrethëthjeve, puplave etj., p.sh. mund të shihni sjelljet e qenit varësisht prej situatave.



Sjelljet e qenit varësisht prej situatave: a. I vetësigurt, b. Agresiv, c. I frikësuar



Ujqit duke komunikuar përmes ulërimit



Vardisja e pallot mashkull ndaj femrës

Disa shtazë nuk kanë territor të përhershëm, si p.sh. kërmijtë, hardhucat, disa brejtësetj.

Komunikimi. Shtazët në bashkësi komunikojnë në mënyra të ndryshme. Komunikimi me zë është karakteristikë për shumicën e shtazëve. Ato lirojnë zëra të ndryshëm për tërheqjen e partnerit, caktimin e territorit, paralajmërimin e rrezikut nga grabitqarët. Kështu, p.sh., ujqit komunikojnë mes vete përmes ulërimit dhe lehtësisht komunikojnë mes vete përmes këngës ose klithjeve etj. Klithjet sinjalizojnë rrezikun nga ndonjë grabitqar ose ndonjë rrezik tjetër. Përmes këngës, shpendët edhe argetohen, por edhe sinjalizojnë të tjerët për kufijtë e territorit të tyre etj.

Vardisja. Sjelljet e ndryshme që bëjnë individët për gjetjen e partnerit të tyre, quhen vardisje. Kështu, p.sh., shpendët meshkuj, si pëllumbi, palloi, gjeli, bilbili, fazani etj., përdorin ngjyrën dalluese, këngën, zërin dhe lëvizjet e ndryshme për lojërat martesore. Te giatarët gjithashtu ngajnë ndryshime në sjelljet e tyre gjatë kohës së shumimit. Kështu, dreri në këtë kohë është më i lëvizshëm, më agresiv, ka zë këmbues etj., gjë që bën të tërheqë vëmendjen e drenushës për çiftëzim.

Komunikimi kimik. Ky lloj komunikimi bëhet përmes substancave të ndryshme kimike aromatike, të cilat i lëshojnë organizmat e një lloji. Kështu, p.sh., bleta amë liron substanca kimike, përmes të cilave bletët punëtore e njohin kosheren e vet, ose qeni me anë të erës mund ta identifikojë praninë e ndonjë qeni tjetër në atë vend, edhe nëse nuk e sheh.

65



**Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënësve:**
Harta e konceptit

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja u jep detyrë nxënësve të punojnë një hartë koncepti. Disa nga nxënësit e prezantojnë.

Sjelljet bashkëvepruese - Gjuha komunikuese e tyre

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve të dhëna, bashkëpunimin dhe përshkrimin e temës.

Detyrë:

(Pyetjet në fund të njësisë mësimore)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

Çka paraqet territori?

Si komunikojnë disa shtazë mes vete?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje, punë në grupe

Nxënësit janë të ndarë në grupe dhe secilit grup mësimdhënësi/ja ia jep pyetjet e përgatitura paraprakisht, u kërkon nxënësve që ta lexojnë njësinë mësimore dhe pastaj ta shkruajnë përgjigjen. Së fundi, drejtuesi i secilit grup e lexon dhe kështu vazhdohet me të gjitha grupet.

Grupi 1:

Përshkruaj sjelljet shoqërore, jep shembuj!

Grupi 2:

Përshkruaj territorin!

Grupi 3:

Analizo komunikimin te shtazët e ndryshme!

Grupi 4:

Trego rolin e vardisjes te shtazët e ndryshme!

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënët të temës:
 Përshkruan se si përshtatjet shërbejnë për ta mundësuar mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjellje - sigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi, duke e gjetur dhe tërhequr partnerin ose shpërndarja e farave-fryteve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II. 8, III. 5, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Struktura trupore përcaktuese e sjelljeve të shtazëve

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Përshkruan karakteristikat strukturore të trupit të maces dhe të lepurit.
- Shpjegon sjelljen e maces si grabitqare dhe lepurit si viktimë, bazuar në strukturën trupore të tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: foto, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Përvijim i të menduarit

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë temën mësimore. Nxënësit nxiten që të shkruajnë në fletoret e tyre të gjitha njohuritë që kanë lidhur me temën. Pastaj, mësimdhënësi/ja merr mendimet e tyre dhe i shkruan në tabelë. Pranoen edhe idetë që nuk janë shumë të sakta. Nxënësit nxiten të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit.


2.4.4. Struktura trupore përcaktuese e sjelljes te shtazët

Marrim dy shembuj për të kuptuar se si përshtaten shtazët në aspektin struktural, kohor dhe të lindshmërisë dhe si bazohen sjelljet e tyre në raportin grabitqar-pre (viktimë) dhe pre-grabitqar:

2.4.4.1. Macja - një kërcyese e shkathët

Macja bën kërcime të larta e të gjera dhe ngjitet lehtësisht në pemë dhe në gardhe. Nëse ajo bie nga një lartësi, ajo kthehet rreth boshtit të saj me shpejtësi të rrafshme dhe në tokë bie në mënyrë të sigurt në të katër këmbët.

Si e kap gjahun? Një mace që e shohim në arë ose në livadh, kuptojmë se ajo është në gjueti. Ajo gjuan minj, lepuj, zhapinj dhe bretkosa. Ajo është grabitqare. Megjithatë, ajo nuk nxiton si qeni pas viktimës së saj. Përkundrazi, ajo zvarritet përpara dhe kap pre në kërcim. Ajo është një sulmuese e shkathët. Shikoni poshtë një mace duke e kapur pre në saj! Ajo ec ngadalë më afër viktimës me sytë e saj gjithmonë në gatishmëri. Me kujdes, ajo vë këmbët e saj. Kthetrat i ka të fshehura në mbështjellës të lëkurës. Pra, ajo nuk shkakton asnjë zhurmë dhe gjithmonë qëndron. Kur arrihet distanca e kërcimit, macja hidhet në shtazën (viktimën) dhe e kap me putrat e para. Me kthetrat e mprehta e mban viktimën të shtrënguar. Me kafshimin që i bën në qafë, zakonisht pre në vret shpejt. Me kthetrat e mprehta dhe dhëmbët grabitqarë, macja është e pajisur mirë për gjueti. Po ashtu, ajo ka dëgjim të mirë.




Sjellja e maces gjatë gjuajtjes së presë

2.4.4.2. Lepujt - kërcyes të shkathtët dhe me numër të madh të vegjlish

Çdo femër lepur lind disa herë në vit. Në këtë mënyrë, mund të ketë deri në 60 pasardhës. Numri i madh i lepujve parandalon zhdukjen.

Lepujt e egër janë të pambrojtur, por kanë dhe shumë armiq, të tillë si dhelprat, zogjtë grabitqarë etj. Kjo është arsyeja pse ata ushqehen kryesisht në muzg ose gjatë natës. Në rast rreziku, kafshët paralajmërojnë njëra-tjetrën. Gjatë vrapimit, ata i mbështesin këmbët e tyre të pasme në tokë. Ata janë të shpejtë dhe mund të kërcëjnë lart, falë ndërtimit të këmbëve të pasme të tyre. Kur ata rrezikohen, ikja është e vetmja mënyrë për të mbijetuar.

Me hundën e ndjeshme, ai percepton çdo aromë. Kështu lepurit dallon rreziqet e mundshme. Veshët e gjatë nuk lënë asnjë tingull pa e kapur.



Sjellja e lepurit duke ikur si viktimë

68



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Leximi i drejtuar

Pas një ligjërata të shkurtër nga mësimdhënësi/ja nxënësit udhëzohen ta lexojnë njësinë mësimore të ndarë në paragrafë dhe pas çdo ndalese mësimdhënësi nxit me pyetje drejtuar nxënësve.

Kështu vazhdohet deri në fund të njësisë mësimore.

Pyetje të mundshme:

A mund ta përcaktojë struktura e trupit të shtazëve sjelljen e tyre?

Çka i ndikon lepurit si viktimë lindshmëria e madhe?



Përforcimi:

Konsolidimi i të nxënit:

Shkrim i shpejtë

Në këtë fazë të orës nxënësit udhëzohen të shkruajnë “Sjellja e macës në gjuajtjen e presë dhe sjellja e lepurit duke ikur si viktimë”. Disa prej shkrimeve lexohen dhe komentohen nga nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen për përfshirjen gjatë gjithë orës mësimore, saktësinë e përgjigjeve të dhëna si dhe në përshkrimin e temës.

Detyrë:

(Të plotësojnë fletore pune)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënët të temës:
 Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh., ujqit udhëtojnë në grup për ta mbrojtur territorin e tyre, rritin të vegjlit e tyre dhe e gjuajnë prentë e madhe).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 1; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Shpjegon arsyet e sjelljeve shoqërore dhe territoriale të shtazëve.
- Krahason sjelljet mes shtazëve të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë të vogla ngjitëse, kompjuter, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Diskutim për njohuritë paraprake

Shënohet titulli në tabelë, pastaj shpërndahen fletë të vogla ngjitëse dhe nxënësit individualisht duhet të shënojnë për njohuritë paraprake që kanë për sjelljet bashkëvepruese të shtazëve. Fletët ngjiten në tabelë përreth titullit dhe komentohen.

Jetojnë në grupe për të siguruar ushqim dhe strehim

Janë instinktive dhe trashëgohen nga prindërit

Shtazët komunikojnë përmes këngës, ulërimës, vardisjes, dritës etj.

2.4.3. Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve - gjuha komunikuese e tyre

Disa lloje të shtazëve jetojnë të vetmuara, llojet e tjera një periudhë të vitit jetojnë të ndara, ndërsa periudhën tjetër janë në çift, kurse disa lloje të tjera të shtazëve jetojnë në grupe ose në bashkësi. Sjelljet e kafshëve që jetojnë në bashkësi, quhen sjellje bashkëvepruese. Sjelljet bashkëvepruese janë të ndryshme, si: sjelljet shoqërore, sjelljet territoriale, komunikimi, sjelljet ciklike etj.

Sjelljet shoqërore. Kafshët kryesisht jetojnë në grupe shoqërore për të siguruar më lehtë ushqimin, mbrojtjen, migrimin, gjetjen e partnerit etj., dhe kjo e mundëson mbijetesën e llojit. Dallohen shoqëzime të ndryshme, të llojeve të shtazëve, siç janë: shoqëria e bletëve, kolonia e thneglave, tufa e peshqve, shpendëve, llavat e ujqve, deleve, drerëve, kopetë e gjedhëve etj. Shoqërimet e shtazëve dallohen si të përhershme dhe të përkohshme. Të përhershme janë, p.sh., shoqëria e bletëve dhe kolonia e thneglave. Të përkohshme janë shoqërimet e shpendëve që bëhen zakonisht në kohën kur ndërtojnë fole në afërsi të njëri-tjetrit dhe gjatë shtegtimeve. Gjithashtu, disa gjitarë, siç janë, p.sh., hienat, luanët, ujqit, me rastin e kërkimit të ushqimit, tubohen në grupe me qëllim që ta zënë më lehtë gjahun. Edhe bimëngrënësit e savanave të Afrikës, siç janë zebra, buajt, antilopat etj., jetojnë në kope, sepse kjo u ndihmon të mbrohen prej armiqve.




Shoqëria e bletëve



Kolonia e thneglave


Territori. Shumica e shtazëve pjesën më të madhe të jetës, veçmas në kohën e shumimit, e kalojnë në territore të caktuara. Grupet e ndryshme të shtazëve caktojnë territorin e vet, në mënyrë instinktive. Për shënimin e territorit, lloje të ndryshme kafshësh shfrytëzojnë lëndët me erë karakteristike, të cilat vetë i tajojnë, p.sh., qeni, ujqiu, ariu, dhepra etj. Kufirin e territorit e shënojnë me anë të urinimit. Ndërsa lepuri kufirin e përcakton me anë të jashtëqitjes. Në raste të dëpërtimit të individëve të tjerë brenda kufirit të shënuar, në mënyrë instinktive, shtazët shprehin reagimet e tyre me pamjen e jashtme të bishtit, të veshëve, rrëqethjeve, puplave etj., p.sh. mund të shihni sjelljet e qenit varësisht prej situatave.



Sjelljet e qenit varësisht prej situatave: a. I vetësigurt, b. Agresiv, c. I frikësuar



Ujqit duke komunikuar përmes ulërimit



Vardisja e palloit mashkull ndaj femrës

Disa shtazë nuk kanë territor të përhershëm, si p.sh. kërmijtë, hardhucat, disa brejtësetj.

Komunikimi. Shtazët në bashkësi komunikojnë në mënyra të ndryshme. Komunikimi me zë është karakteristikë për shumicën e shtazëve. Ato lirojnë zëra të ndryshëm për tërheqjen e partnerit, caktimin e territorit, paralajmërimin e rrezikut nga grabitqarët. Kështu, p.sh., ujqit komunikojnë mes vete përmes ulërimit dhe lehjes, shpendët komunikojnë mes vete përmes këngës ose klithjeve etj. Klithjet sinjalizojnë rrezikun nga ndonjë grabitqar ose ndonjë rrezik tjetër. Përmes këngës, shpendët edhe argëtohen, por edhe sinjalizojnë të tjerët për kufijtë e territorit të tyre etj.

Vardisja. Sjelljet e ndryshme që bëjnë individët për gjetjen e partnerit të tyre, quhen vardisje. Kështu, p.sh., shpendët meshkuj, si pëllumbi, palloi, gjeli, bilbili, fazani etj., përdorin ngjyrën dalluese, këngën, zërin dhe lëvizjet e ndryshme për lojërat martesore. Te gjiatarët gjithashtu ngajnë ndryshime në sjelljet e tyre gjatë kohës së shumimit. Kështu, dreri në këtë kohë është më i lëvizshëm, më agresiv, ka zë këmbues etj., gjë që bën të tërheqë vëmendjen e drenushës për çiftëzim.

Komunikimi kimik. Ky lloj komunikimi bëhet përmes substancave të ndryshme kimike aromatike, të cilat i lëshojnë organizmat e një lloji. Kështu, p.sh., bleta amë liron substanca kimike, përmes të cilave bletët punëtore e njohin kosheren e vet, ose qeni me anë të erës mund ta identifikojë praninë e ndonjë qeni tjetër në atë vend, edhe nëse nuk e sheh.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Sistemi ndërveprues i shënimeve

√	+	-	?
Sjelljet bashkëvepruese bëhen për ta siguruar më lehtë ushqimin, mbrojtjen, migrimin, gjetjen e partnerit etj.	Sho-qërizimet e shtazëve dallohen si të përhershme dhe të për-kohshme.	"e drejta e të fortit".	A janë këto sjellje bashkëvepruese të shtazëve të përafërta me sjelljet e njeriut?

Prezantohet një video rreth sjelljes bashkëvepruese të shtazëve dhe kërkohet që të analizohet videoja. Pastaj, nxënësit duhet ta plotësojnë tabelën me shenjat përkatëse në bazë të informacioneve që gjetën gjatë shikimit të videos.

“√” - kur informacioni pohon atë çka dini.

“+” - kur një pjesë e informacionit është e re për ju.

“-” - kur informacioni është në kundërshtim me atë që dini ose mendoni se e dini.

“?” - kur ka informacion që është i paqartë ose doni të dini më shumë për të.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve: Diskutim në grup

Nxënësit organizohen në katër grupe me nga pesë nxënës: detyra e tyre është të diskutojnë, të shkëmbejnë mendime dhe t'u japin përgjigje paqartësive që shënuan në tabelën e tyre. Po ashtu, paqartësitë plotësohen edhe me ndihmën e mësimdhënësit. Më pas nga një përfaqësues për çdo grup u tregon nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit, duke dhënë shembuj për sjelljet e ndryshme të shtazëve që kanë hasur nga jeta e përditshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të arsyeve të sjelljeve shoqërore dhe territoriale të shtazëve dhe krahasimit të sjelljeve mes shtazëve të ndryshme.

Detyrë:

(Shëno në fletore shembuj të sjelljeve bashkëvepruese të shtazëve që keni hasur në natyrë)

Reflektim përvojëdhënës e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2; III. 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Sjelljet ciklike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan sjelljet ciklike të shtazëve dhe faktorët që ndikojnë në këto sjellje.
- Analizon sjelljet e bimëve dhe të shtazëve si përgjigje ndaj ndryshimit të mjedisit të jashtëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, kompjuter, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Imagjinata e drejtuar

Prezantohet para nxënësve videoja rreth migrimit të ngjalës <https://www.youtube.com/watch?v=BR1enXROmgA>.


Gjatë shikimit të videos nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë kuptuat nga kjo video?
- Pse shtazët migrojnë?


Disa nga përgjigjet e mundshme, janë:

2.4.5. SJELLJET CIKLIKE

Sjelljet ciklike janë sjellje të lindura, të cilat vazhdimisht përsëriten brez pas brezi. Këto sjellje ndodhin si përgjigje ndaj ndryshimit të mjedisit. Sjelljet e tilla ndodhin për shkak të lëvizjes së tokës ditë-natë (cikli 24 orësh) dhe ndryshimeve që ndodhin përgjatë stinëve gjatë një viti. Shembuj të sjelljeve ciklike janë migrimet e shtazëve.



Shtegtimi i lellekut



Peripeçitë e ngjalës gjatë rrugëtimit

Migrimi i shtazëve. Në vendin tonë disa nga shpendët, si për shembull, lellekun apo dallëndyshen, i shohim vetëm në pranverë dhe verë. A thua, pse? Arsyeja është se ata brenda vitit ndërrojnë mjedisin e tyre jetësor. Vijnë në pranverë, kur fillon të ngrohet moti, dhe largohen në vjeshtën e vonë, kur fillon të ftohet moti. Këto lëvizje të shtazëve i quajmë migrime ose dyndje. Lëvizjet e tilla janë sjellje instinktive ciklike të lindura dhe të trashëguara nga paraardhësit dhe janë të lidhura me stinët. Janë karakteristike për shumë lloje si karkaleca, flutura, peshq (ngjala, lososët), shpendë (lellekët, korrilat, dallëndyshit) dhe gjitarët (lakuriqet, zebat etj.). Arsyet e migriimeve janë: ndryshimi i temperaturës, kohëzgjatja ditë-natë, mungesa e ushqimit, ndikimi i hormoneve seksuale. Çdo migrim sipas kohëzgjatjes qëndron në lidhje me shumimin dhe ekzistimin e llojit.


Migrimi i ngjalës. Ngjala është peshk me gjatësi prej rreth 50 cm të mashkullit deri në 150 cm të femrës; ka peshë mesatare prej 0.5 kg. Jeton 14 deri në 16 vjet. Katrup të gjatë elastik, të përshatshëm për udhëtime të gjata, ngjyra e të

cilit ndryshon sipas vjetërsisë prej asaj të verdhë (larvat) e deri tek ajo e kafentë ose e zezë. Ajo që të zgjon kureshtjen është cikli jetësor i ngjalës. Ngjalat bëhen të pjekura seksualisht prej moshës 10 deri 15 vjeçe derisa qëndrojnë në ujë të freskët. Pastaj fillojnë të migrojnë.



Ngjala duke lëshuar vezët në fund të detit

Ngjalat seksualisht të pjekura migrojnë nga lumenjtë e Evropës, siç është Drini etj., në Oqeanin Atlantik. Ato notojnë drejt Detit Sargas. Kjo është 4000 deri 8000 km varësisht prej cilit lumë nisen nga bregu perëndimor i Evropës. Gjatë rrugëtimit të gjatë rreth i vit, ngjalat nuk ushqehen. Ato jetojnë nga yndyra që trupi i tyre ka ruajtur më parë. Ngjala është gjatë e natës, ndërsa gjatë ditës fshihet në thellësi të ujit. Zakonisht fshihet nën rrënjë të ndryshme, në vrime dhe në lym. Me të arritur në cakun e saj, ajo i lëshon vezët në thellësi të mëdha të ujit (deri në 3000 m). Pas lëshimit të vezëve, ngjala vdes. Pasi të dalin nga vezët, larvat e reja marrin rrugën e kthimit në vendin ku kanë jetuar prindërit e tyre. Ato rrugëtojnë për në Evropë përgjatë tre vjetësh.



Rrugëtimi i ngjalës së pjekur seksualisht nga Evropa në Detin Sargas dhe kthimi i ngjalës së re nga Deti Sargas në Evropë

Endë nuk është e qartë se si ngjalat e reja arrijnë të gjejnë rrugën e kthimit deri te lumenjtë e Evropës. Gjatë rrugëtimit nëpër lumenj, ngjalat kanë peripeci të shumta si rezultat i ujëvarave të larta, nga digat e ndryshme që janë ndërtuar për grumbullimin e ujit, ndotja e lumenjve etj.

Këshillë:

Kujdes gjatë përgatitjes së ngjalës: gjaku i saj është helmues. Gjatë kapjes së saj, duhet pasur kujdes që ajo të mos lëndohet. Me përgatitjen e ngjalës në vaj ose në tymosje, gjaku i saj humb helmën.

- Kuptuam që ngjala udhëton shumë larg për t'i lëshuar vezët.
- Shtazët migrojnë për ushqim, strehim, partnerë etj. Kështu nxënësit i ndajnë idetë e tyre dhe i komentojnë përgjigjet e ndryshme me nxënësit e tjerë.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditarët e të nxënit (Ditari dypjesësh)**

Nxënësit organizohen të punojnë në dyshe. Në fletoret e tyre duhet ta paraqesin tabelën si më poshtë.


Citim	Koment
- Sjelljet ciklike janë sjellje që përsëriten vazhdimisht. - Ngjala migron në detin Sargas për t'i lëshuar vezët.	- Sjelljet ciklike janë të lindura dhe ndodhin për shkak të lëvizjes së tokës ditë-natë dhe ndryshimeve që ndodhin në periudha më të gjata kohore (stinë).

Prezantohet pjesa për lexim dhe u thuhet nxënësve që në fillim t'i nënvizojnë pjesët që u bëjnë përshtypje gjatë leximit apo në qoftë se kanë pyetje. Pas leximit dhe nxjerrjes së citimeve, u jepet kohë të bëjnë komentet e tyre.

Pastaj, u kërkohet t'i tregojnë pjesët që kanë zgjedhur dhe t'i lexojnë komentet e tyre. Mësimdhënësi mund të bëjë pyetje gjatë leximit të komenteve nga nxënësit në mënyrë që ata të nxiten të flasin dhe të aftësohen për t'u përgjigjur pyetjeve sipas mënyrës që u kërkohet.



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Harta semantike**



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të sjelljeve ciklike të shtazëve, faktorëve që ndikojnë në këto sjellje dhe analizës së sjelljeve të bimëve dhe shtazëve si përgjigje ndaj ndryshimit të mjedisit të jashtëm.

Detyrë:

(Të plotësohet fletore pune në faqet 40-41)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Shfrytëzon organizues grafikë për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 4; II. 7; III. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Organizimi i biocenzave dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon organizimin e biocenzave në hapësirë dhe në kohë.
- Krahason katëzimin mbiotokësor dhe atë nëntokësor.
- Shpjegon organizimin kohor të biocenzave përmes aspekteve që ndryshojnë gjatë periudhave të ndryshme të vitit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Di-Dua të di-Mësova më shumë

Shënohet njësia mësimore në fillim të tabelës, e ndarë në tri kolona: D-D-M. Kërkohet nga nxënësit të thonë atë çfarë dinë apo mendojnë se dinë për njësinë.

D - D - M Organizimi i biocenzave dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
- Biocenzat janë të organizuara në hapësirë dhe në kohë.		

2.5. ORGANIZIMI I BIOCENOZAVE DHE QËNDRUESHMËRIA E EKOSISTEMEVE

2.5.1. Struktura dhe dinamika e biocenzave (bashkësi jetësore)

Biocenzat janë sisteme të organizuara në hapësirë dhe kohë. Organizimi hapësor nënkupton përbërjen (llojet), numrin dhe renditjen e llojeve bimore e shtazore në një biocenzë, ndërsa ai kohor (dinamizmi) nënkupton ndryshimet që ndodhin te banorët e biocenzës gjatë një ose më shumë vjetësh.




Katëzimi në pyllin e ahut: kati I - i përbërë prej kërpudhave, myshqeve dhe likeneve dhe kati II - i përbërë kryesisht prej llojit të ahut

2.5.1.1. Organizimi hapësor - struktura e biocenzës

Organizimi hapësor i biocenzës shprehet përmes katëzimit, do të thotë renditjes së llojeve në kate. Dallojmë katëzimin mbiotokësor dhe nëntokësor. Katëzimi dallohet si në pyje ashtu dhe në livadhe, ku bimët që kanë nevoja jetësore të njëjta, formojnë një kat. Se sa do jetë numri i kateve në një pyll, varet prej faktorëve abiotikë, veçmas prej dritës, dhe faktorëve biotikë, përkatësisht llojeve bimore drunore, që i përbëjnë katet e sipërme të pyllit. P.sh., në pyllin e dushkut dallohen katër kate, sepse kurorat e drurëve janë të rralla, ku drita depërton më lehtë në shtresat e poshtme dhe mundëson zhvillimin e më shumë llojeve bimore e me të edhe të më shumë kateve. Kurse në pyllin e ahut dallohen dy kate, sepse kurorat e drurëve të ahut janë më të dendura dhe pengojnë depërtimin e dritës në shtresat e poshtme të pyllit. Shtazët, veçmas gjitarët dhe shpendët, përdorin kate të ndryshme të bashkësisë bimore, prandaj mund të themi që edhe te shtazët ekziston një lloj katëzimi.



Katëzimi i livadhit



Katëzimi nëntokësor. Në përgjithësi, bimët që kanë trup të lartë, kanë sistem rrënjor që shkon më thellë dhe anasjelltas.

2.5.1.2. Organizimi kohor i biocenozës

Me siguri keni vërejtur një livadh në stinë të ndryshme. Çfarë keni vërejtur? A keni parë bimë të ndryshme në stinë të ndryshme? A dalloni aspekte të ndryshme dhe pse?



Livadhi në fazën e lulëzimit të lulëshurdhës

Organizimi kohor i biocenozës më së miri mund të përcillet të bashkësisë barishtore. Në organizimin kohor apo dinamizmin e biocenozës ndikim të madh kanë faktorët ekologjikë e veçmas ata klimatikë. Në varësi të temperaturës, rrezatimit diellor, lartësisë mbidetare, kohëzgjatjes së borës, bimët mund të fillojnë zhvillimin e tyre më herët apo më vonë.

Nëse vërojmë me kujdes ekosistemin e livadhit, vërejmë se ai ndryshon vazhdimisht gjatë periudhave të ndryshme të vitit: në pranverën e hershme livadhi merr ngjyrë të gjelbër, meqë bimët barishtore fillojnë të rriten, pastaj merr ngjyrë të ndryshme varësisht prej fazave të lulëzimit të bimëve që dominojnë aty, dhe në fund kositet. Livadhi mund të kositet disa herë gjatë vitit, kurse gjatë dimrit hyn në fazën e qetësisë.

Të mbahet në mend!

- Biocenozat janë të organizuara në hapësirë dhe në kohë.
- Organizimi hapësinor i biocenozës nënkupton përbërjen, numrin dhe renditjen e llojeve bimore e shtazore dhe shprehjet përmes renditjes së llojeve në kate.
- Renditja në kate mundëson që në një vend të kufizuar të jetojë numër i madh i llojeve me kërkesa të ndryshme ekologjike.
- Në ekosistemet pyjore dhe livadhave dallojmë katëzimin mbitokësor dhe nëntokësor.
- Organizimi kohor nënkupton ndryshimet që ndodhin të banorët e biocenozës gjatë një ose më shumë vjetësh.
- Në organizimin e biocenozës ndikim të madh kanë faktorët ekologjikë e veçmas ata klimatikë.

Pyetje

1. Trego format e organizimit të biocenozave.
2. Cilët faktorë ndikojnë në organizimin e biocenozave?
3. Duke bashkëbiseduar me mësimdhënësin/en, gjeni cilat janë shkaqet që në pyllin e dushkut kemi katër kate bimësh e në atë të ahut dy kate.

74



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Di-Dua të di-Mësova më shumë

Pas plotësimit të kolonës së parë me mendimet e nxënësve rreth njësisë, ata fillojnë t'i lexojnë paragrafët në libër. Gjatë leximit i formulojnë pyetjet dhe i shënojnë të gjitha paqartësitë apo fjalët e panjohura që kanë hasur gjatë leximit. Pas përfundimit të formulimit të pyetjeve, nxënësit i lexojnë paqartësitë e tyre të cilat më pas shënohen nga mësimdhënësi në tabelë në kolonën e mesit D (Dua të di).

D - D - M		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
Biocenozat janë të organizuara në hapësirë dhe në kohë.	- Kush ndikon në organizimin e biocenozave?	



Përforsimi: Konsolidimi i të nxënët:

Di-Dua të di-Mësova më shumë

Pas përfundimit të leximit, vazhdojnë ta plotësojnë edhe kolonën e tretë M (Mësova).

D - D - M		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
- Biocenozat janë të organizuara në hapësirë dhe në kohë.	Kush ndikon në organizimin e biocenozave?	- Faktorët ekologjikë e veçmas ata klimatikë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të organizimit të biocenozave në hapësirë dhe në kohë, krahasimit të katëzimit mbitokësor dhe nëntokësor dhe shpjegimit të organizimit kohor të biocenozave përmes aspekteve që ndryshojnë gjatë periudhave të ndryshme të vitit.

Detyrë:

(Të plotësohet fletore pune në faqet 43-44)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Shfrytëzon organizues grafikë për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 7; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Suksesionet (njëpasnjshmëritë) ekologjike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon suksesionet ekologjike.
- Dallon suksesionin parësor dhe atë dytësor.
- Vlerëson ndikimin e njeriut në rritjen e suksesioneve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

[LINK](#)

Shënohet një koncept në mes të tabelës duke i lënë nxënësit për pak minuta t'i renditin lidhjet për këtë koncept. Në fletët A4, nxënësit duhet t'i paraqesin mendimet e tyre në këtë mënyrë. Ata bashkëveprojnë për t'i shkëmbyer njohuritë ashtu edhe për ta zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi konceptin. Në fund, duhet të shënojnë një përkufizim për konceptin.



2.5.2. Suksesionet (njëpasnjshmëritë) ekologjike

Pos ndryshimeve vjetore, ekosistemet pësojnë ndryshime edhe me kalimin e viteve. Asnjë biocenoze nuk është plotësisht e pandryshueshme. Ajo përcjell ndryshimin e kushteve të mjedisit të jashtëm. Ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës, në përbërjen dhe strukturën e llojeve të një ekosistemi, quhen suksesion (njëpasnjshmëri) ekologjik. Dallojmë dy lloj suksesioneesh: suksesioni parësor dhe suksesioni dytësor.




Suksesioni parësor paraqitet në ato biotope ku më parë nuk ka ekzistuar bota e gjallë. Vendet e tilla krijohen gjatë furtunave ranore në shkretëtira, gjatë mbulimit të luginave me shembjen e tokës, gjatë shpërthimeve vullkanike, vërshimeve të mëdha, kur krijohen shtretë ranorë, deponi të hirit të krijuara nga termocentralet, siç është rasti i deponive të hirit të formuara nga djegia e thëngjillit në termocentralet e Obiliqit në Kosovë etj. Llojet e para që shfaqen në një biotop të ndryshuar quhen lloje pioniere. Më pas paraqiten lloje të tjera bimore dhe llojet shtazore. **Suksesioni dytësor** ndodh në vendet ku më parë ka ekzistuar biocenoza, e cila është shkatërruar nga ndonjë faktor i mjedisit të jashtëm, p.sh., djegia e pyllit, shkatërrimi i pyllit nga orteku, prerja masive e pyllit, drenimi e më pas tharja e moçaleve etj.



2.5.2.1. Ndryshimi i pashmangshëm i liqenit

Për ta kuptuar më mirë procesin e suksesionit, do të marrim shembull të këtij procesi një liqen. Liqeni është i destinuar të mbushet dhe të bëhet tokë e thatë. Ky proces zgjat me vite, madje edhe me shekuj, dhe varet nga madhësia fillestare e liqenit, furnizimi me ujë dhe nga faktorët e mjedisit të jashtëm. Në fillim, liqeni dominohet nga planktoni, i cili pastaj mundëson paraqitjen e peshqve, gaforreve, guacave, kërmijve etj. (meqë planktoni është ushqim për këto lloje). Numri i llojeve shkon duke u rritur, meqë rrymat e ujit, era dhe shpendët sjellin farat e bimëve dhe vezë të kafshëve të



Suksesionet në deponitë e hirit në Kastriot, gjatë 55 vjetëve

2.5.2. Suksesionet (njëpasnjëshmëritë) ekologjike

Pos ndryshimeve vjetore, ekosistemet pësojnë ndryshime edhe me kalimin e viteve. Asnjë biocenozë nuk është plotësisht e pandryshueshme. Ajo përcjell ndryshimin e kushteve të mjedisit të jashtëm. Ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës, në përbërjen dhe strukturën e llojeve të një ekosistemi, quhen suksesion (njëpasnjëshmëri) ekologjik. Dallojmë dy lloj suksesionesh: suksesioni parësor dhe suksesioni dytësor.

Suksesioni parësor paraqitet në ato biotope ku më parë nuk ka ekzistuar bota e gjallë. Vendet e tilla krijohen gjatë furtunave ranore në shkretëtira, gjatë mbulimit të luginave me shembjen e tokës, gjatë shpërthimeve vullkanike, vërshimeve të mëdha, kur krijohen shtretër ranorë, deponi të hirit të krijuara nga termocentralet, siç është rasti i deponive të hirit të formuara nga djegia e thëngjillit në termocentralet e Obiliqit në Kosovë etj. Llojet e para që shfaqen në një biotop të ndryshuar quhen lloje pioniere. Më pas paraqiten lloje të tjera bimore dhe lloje shtazore. **Suksesioni dytësor** ndodh në vendet ku më parë ka ekzistuar biocenoza, e cila është shkatërruar nga ndonjë faktor i mjedisit të jashtëm, p.sh., djegia e pyllit, shkatërrimi i pyllit nga orteku, prerja masive e pyllit, drenimi e më pas tharja e moçaleve etj.

2.5.2.1. Ndryshimi i pashmangshëm i liqenit

Për ta kuptuar më mirë procesin e suksesionit, do të marrim shembull të këtij procesi një liqen. Liqeni është i destinuar të mbushet dhe të bëhet tokë e thatë. Ky proces zgjat me vite, madje edhe me shekuj, dhe varet nga madhësia fillestare e liqenit, furnizimi me ujë dhe nga faktorët e mjedisit të jashtëm. Në fillim, liqeni dominohet nga planktoni, i cili pastaj mundëson paraqitjen e peshqve, gaforreve, guacave, kërmijve etj. (meqë planktoni është ushqim për këto lloje). Numri i llojeve shkon duke u rritur, meqë rrymat e ujit, era dhe shpendët sjellin farat e bimeve dhe vezë të kafshëve të



Suksesionet në deponitë e hirit në Kastriot, gjatë 55 vjetëve



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Leximi i drejtuar**


Mësimi fillon me një diskutim për titullin duke u mbështetur në pyetjet: *Për çfarë mendoni se bën fjalë kjo njësi mësimore? Pse mendoni kështu?*

Secili nxënës e bën parashikimin e vet. Pastaj, lexohet pjesa e parë dhe mësimdhënësi ndalon për të kuptuar nëse nxënësit kanë qenë të saktë apo jo në parashikimet e tyre. Leximi vazhdon me ndalesa në pjesë të caktuara për ta mbajtur gjallë kureshtjen e nxënësve deri në fund të paragrafit.

Ç'mendoni se ka ndodhur?	→	Çfarë provash keni?
Ekosistemet pos ndryshimeve vjetore, pësojnë ndryshime edhe me kalimin e viteve.		Ekosistemet e përcjellin ndryshimin e kushteve të mjedisit të jashtëm.
→	Si ndodhi në të vërtetë?	
Ndryshimet në përbërjen dhe strukturën e llojeve të një ekosistemi gjatë viteve quhen suksesione (njëpasnjëshmëri) ekologjike.		



**Përforcimi:
Konsolidimi i të nxënësve:
Diagrami i Venit**



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të suksesioneve ekologjike, dallimit të suksesionit parësor dhe dytësor dhe vlerësimit të ndikimit të njeriut në rritjen e suksesioneve.

Detyrë:

(Shëno në fletore shembuj të suksesioneve parësore dhe dytësore që keni hasur në natyrë)

○ *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasifikimi i ekosistemeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Klasifikon ekosistemet në planetin tonë.
- Emërton biomet ujore.
- Dallon ekosistemet që e përbëjnë biomën e ujërave të ëmbla dhe biomën e ujërave të njelmëta.


Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fotografi të printuara për llojet e ekosistemeve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Përvijimi i të menduarit



2.6. KLASIFIKIMI I EKOSISTEMEVE

Në planetin Tokë, ekosistemet ndahen në dy grupe të mëdha: **ekosistemet ujore** dhe **ekosistemet tokësore**. Disa ekosisteme të ngjashme formojnë kategorinë e quajtur biom, që përfshin territore të mëdha dhe karakterizohen me tip të posaçëm të klimës. Dallohen biomet ujore dhe biomet tokësore.

2.6.1. BIOMET UJORE

Ekosistemet ujore në planetin Tokë grupohen në biomin e ujërave të ëmbla dhe biomin e deteve dhe të oqeaneve.

2.6.1.1. Biomi i ujërave të ëmbla

Biomin e ujërave të ëmbla e përbëjnë ekosistemet e ujërave rrjedhëse (përrenjtë dhe lumenjtë) dhe ekosistemet e ujërave të ndenjura (liqenet, moçalet, kënetat dhe ligatinat).

Lumi - paraqet tërësinë e ujërave rrjedhëse, të cilat rrjedhin prej burimit të lumit e deri në derdhje në det përmes tokës. Këto ujëra ndahen në disa zona burimi: zona e sipërme ose përroi malor, zona e mesme ose pjesa e lumit me ujë të qetë dhe zona përfundimtare ose zona e derdhjes së lumit në det. Në zonat e ndryshme të lumit, varësisht prej shpejtësisë, temperaturës dhe shkallës së ndotjes së ujit, dallohen llojet e ndryshme të shtazëve.

Liqeni - ekosistemi i ujërave të ndenjura, i cili paraqet një sasi të madhe të ujërave të rrethuara nga toka dhe jo të lidhura drejtpërdrejt me det.

KLASIFIKIMI I EKOSISTEMEVE

- EKOSISTEMET UJORE
 - Ekosistemi i ujërave rrjedhëse
 - (Përrenjtë, lumenjtë)
 - Ekosistemi i ujërave të ndenjura
 - Liqenet
 - Kënetat
 - Kënetat
 - Ekosistemet e deteve dhe të oqeaneve
- EKOSISTEMET TOKËSORE
 - Ekosistemet e pyjeve
 - Hillore
 - Gjeohumide
 - Gjeohumide
 - Ekosistemet e barishtave
 - Savanat
 - Lëndshet
 - Kullorët
- EKOSISTEMET TOKËSORE TË KULTIVUARA (ARTIFICIALE)
 - Ekosistemet e llojeve pyjore
 - Ekosistemet bujqësore

Klasifikimi i ekosistemeve



Përroi malor

2.6. KLASIFIKIMI I EKOSISTEMEVE

Në planetin Tokë, ekosistemet ndahen në dy grupe të mëdha: **ekosistemet ujore** dhe **ekosistemet tokësore**. Disa ekosisteme të ngjashme formojnë kategorinë e quajtur biom, që përfshin territore të mëdha dhe karakterizohen me tip të posaçëm të klimës. Dallohen biomet ujore dhe biomet tokësore.

2.6.1. BIOMET UJORE

Ekosistemet ujore në planetin Tokë grupohen në biomin e ujërave të ëmbla dhe biomin e deteve dhe të oqeaneve.

2.6.1.1. Biomi i ujërave të ëmbla

Biomin e ujërave të ëmbla e përbëjnë ekosistemet e ujërave rrjedhëse (përrnjetë dhe lumenjtë) dhe ekosistemet e ujërave të ndenjura (liqenet, moçalet, kënetat dhe lligatinat).

Lumi - paraqet tërësinë e ujërave rrjedhëse, të cilat rrjedhin prej burimit të lumit e deri në derdhje në det përmes tokës. Këto ujëra ndahen në disa zona burimi: zona e sipërme ose përroi malor, zona e mesme ose pjesa e lumit me ujë të qetë dhe zona përfundimtare ose zona e derdhjes së lumit në det. Në zonat e ndryshme të lumit, varësisht prej shpejtësisë, temperaturës dhe shkallës së ndotjes së ujit, dallohen llojet e ndryshme të shtazëve.

Liqeni - ekosistemi i ujërave të ndenjura, i cili paraqet një sasi të madhe të ujërave të rrethuara nga toka dhe jo të lidhura drejtpërdrejt me det.

KLASIFIKIMI I EKOSISTEMEVE

EKOSISTEMET UJORE

- Ekosistemi i ujërave rrjedhëse (Përrnjetë, lumenjtë)
- Ekosistemi i ujërave të ndenjura
 - Liqenet
 - Moçalet
 - Kënetat
- Ekosistemet e deteve dhe të oqeaneve

EKOSISTEMET TOKËSORE

- Ekosistemet e pyjeve
 - Hëkëse
 - Gjetëbarëshinë
 - Gjetëbarëshinë
- Ekosistemet e barishtave
 - Sograt
 - Savanat
 - Liradhat
 - Kulloracat

EKOSISTEMET TOKËSORE TË KULTIVUARA (ARTIFICIALE)

Ekosistemet e ujit pyjor
Ekosistemet bujqësore

Klasifikimi i ekosistemeve



Përroi malor

77



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Shpjegim i përparuar

Prezantohet njësia mësimore “Klasifikimi i ekosistemeve”, tregohet shkurtimisht përmbajtja e temës. Nxënësit do të punojnë në grupe, nga katër nxënës dhe në dyshe. Atyre u kërkohet që të diskutojnë për çështjen e parë dhe në bashkëbisedim me njëritjetrin të shkruajnë se çfarë dinë për atë që dëgjuan. Zhvillohet pjesa e parë e shpjegimit nga mësimdhënësi, pastaj kërkohet nga nxënësit që të shikojnë në fletë mendimet e tyre. Mësimdhënësi parashtron pyetje: *Çfarë ka të përbashkët në fletën tuaj dhe në ato që u përmendën në lexim? Çfarë gjëra të reja mësuat?*

Duke bashkëbiseduar, nxënësit në dyshe, renditin se çfarë dinë dhe më pas mendimet e tyre i shfaqin në grup. Vazhdohet pjesa e dytë e shpjegimit, mësimdhënësi kërkon që nxënësit të dëgjojnë me vëmendje duke i pasur parasysh shënimet me idetë e tyre. Më pas, kërkohet nga ndonjë pjesëtar i grupeve të shprehë disa nga përfundimet e tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët: Shënime mbi shënime

Modelohet strategjia *Shënime mbi shënime* duke përdorur kategori të njohura për nxënësit. Tregohet si lidhen treguesit me njëritjetrin. Treguesi 1 është ideja kryesore (*Klasifikimi i ekosistemeve*), treguesit 2 janë shembuj të treguesit 1 (*Ekosisteme ujore, tokësore*). Treguesit 3 janë shembuj të përpunimit të treguesve 2.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit të ekosistemeve në planetin tonë, emërtimit të biomeve ujore dhe dallimit të ekosistemeve që e përbëjnë biomën e ujërave të ëmbla dhe biomën e ujërave të njelmëta.

Detyrë:

(Të realizohet në shtëpi eksperimenti i dhënë në fletore pune, faqe 50, rezultatet të shënohen në fletore)

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Shfrytëzon organizues grafikë për t'i treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 7; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcakton faktorët që ndikojnë në suksesionet ekologjike.
- Dallon karakteristikat e suksesionit parësor dhe atij dytësor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, material shtesë nga interneti, fotografi të printuara për suksesionet ekologjike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS


Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Diskutim për njohuritë paraprake

Shënohet titulli në tabelë, pastaj në secilën bankë shpërndahen fotografi të printuara për suksesionet ekologjike dhe nxënësit individualisht duhet të shënojnë për njohuritë paraprake që kanë për suksesionet ekologjike (parësore dhe dytësore). Disa nga mendimet e nxënësve mund të jenë:

Në fotografi shihen suksesionet parësore dhe dytësore.

Suksesioni parësor paraqitet në vendbanimet ku më parë nuk ka ekzistuar bota e gjallë.

Suksesionet sekondare ndodhin në vendet ku më parë ka ekzistuar bashkësia jetësore, e cila është shkatërruar nga ndonjë faktor i mjedisit të jashtëm.



Një shembull i suksesionit parësor është ligëni


tjera në ligën. Masa e gjelbër bimore dhe mbeturinat e kafshëve që vdesin vazhdimisht shtresohen dhe e mbushin ligënin. Ligëni gradualisht kalon në kënetë dhe më pas në tokë të thatë. Toka e lagësht dhe pjellore nxit rritjen e bimëve barishtore në fillim, pastaj edhe të shkurreve dhe të drurëve. Kohët e fundit, ujërat e zeza urbane, industriale, përdorimi i plehrave në bujqësi etj. po ndikojnë në ciklet e jetës së ligëneve dhe po e shpejtojnë procesin e mbushjes së tij. Materialet e hedhura në ligëne shpesh përshpejtojnë shkatërrimin e botës bimore dhe shtazore, duke mbetur vetëm bakteret që zbrërthejnë lëndët organike, me ç'rast lirohen gazra që lirojnë erë të keqe.

Të mbahet në mend!

- Ekosistemet pos ndryshimeve vjetore, pësojnë ndryshime edhe me kalimin e viteve.
- Ekosistemet përcjellin ndryshimin e kushteve të mjedisit të jashtëm.
- Ndryshimet në përbërjen dhe strukturën e llojeve të një ekosistemi gjatë viteve quhen suksesion (njëpasnjëshmëri) ekologjike.
- Dallojmë suksesione parësore dhe suksesione dytësore.
- Suksesioni parësor paraqitet në vendbanimet ku më parë nuk ka ekzistuar bota e gjallë.
- Suksesionet sekondare ndodhin në vendet ku më parë ka ekzistuar bashkësia jetësore, e cila është shkatërruar nga ndonjë faktor i mjedisit të jashtëm.

Pyetje

1. C'kupton me suksesion ekologjik?
2. Përmendni karakteristikat e suksesionit parësor dhe atij dytësor.
3. Sindikon njeriu në rrjedhjen e suksesioneve?



Një shembull i suksesionit parësor është liqeni

tjera në liqen. Masa e gjelbër bimore dhe mbeturinat e kafshëve që vdesin vazhdimisht shtresohen dhe e mbushin liqenin. Liqeni gradualisht kalon në kënetë dhe më pas në tokë të thatë. Toka e lagësht dhe pjellore nxit rritjen e bimëve barishtore në fillim, pastaj edhe të shkurreve dhe të drurëve. Kohët e fundit, ujërat e zeza urbane, industriale, përdorimi i plehrave në bujqësi etj. po ndikojnë në çlirimin e jetës së liqeneve dhe po e shpejtojnë procesin e mbushjes së tij. Materialet e hedhura në liqene shpesh përshpejtojnë shkatërrimin e botës bimore dhe shtazore, duke mbetur vetëm bakteret që zbrërthejnë lëndët organike, me ç'rast lironen gazra që llojnë erë të keqe.

Të mbahet në mend!

- Ekosistemet pas ndryshimeve vjetore, pësojnë ndryshime edhe me kalimin e viteve.
- Ekosistemet përcjellin ndryshimin e kushteve të mjedisit të jashtëm.
- Ndryshimet në përbërjen dhe strukturën e llojeve të një ekosistemi gjatë viteve quhen suksesion (njepasnjeshmëri) ekologjike.
- Dallojmë suksesione parësore dhe suksesione dytësore.
- Suksesioni parësor paraqitet në vendbanimet ku më parë nuk ka ekzistuar bota e gjallë.
- Suksesionet sekondare ndodhin në vendet ku më parë ka ekzistuar bashkësia jetësore, e cila është shkatërruar nga ndonjë faktori i mjedisit të jashtëm.


Pyetje

1. Ç'kupton me suksesion ekologjik?
2. Përmendni karakteristikat e suksesionit parësor dhe atij dytësor.
3. Si ndikon njeriu në rrjedhjen e suksesioneve?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mbajtja e strukturuar e shënimeve**

Mësimdhënësi paraqet në tabelë një organizues grafik që thekson suksesionet ekologjike. Nxënësit do të mbajnë shënime për informacionin e duhur në skicën e grafikut, duke e përshkruar dhe analizuar suksesionin parësor dhe dytësor. Kërkohej nga nxënësit që ta respektojnë plotësimin e kutive në rrugë logjike, pasi të kenë lexuar në dyshe një fragment të caktuar nga materiali shtesë që u është dhënë.



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Diskutim në grup**

Nxënësit organizohen në katër grupe me nga katër nxënës: detyra e tyre është të diskutojnë, të shkëmbejnë mendime dhe t'u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në pjesën e dytë të orës mësimore. Më pas, nga një përfaqësues për çdo grup ua tregojnë nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit të grupit të tyre, duke shkëmbyer ide dhe mendime me grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të faktorëve që ndikojnë në suksesionet ekologjike dhe dallimit të karakteristikave të suksesionit parësor dhe atij dytësor.

Detyrë:

(T'u përgjigjen pyetjeve në librin bazë, faqe 76, dhe t'i shënojnë në fletore)

Reflektim për rrjedhjen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 7; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biomet detare dhe oqeanike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e ruajtjes së biomeve ujore.
- Analizon pasojat nga ndotja e biomeve ujore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, kompjuter, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit

Imagjinata e drejtuar

Prezantohet para nxënësve videoja rreth biomeve detare dhe oqeanike

<https://www.youtube.com/watch?v=u6E9nbs5hmY&t=1s>

Gjatë shikimit të videos nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë kuptuat nga kjo video?
- Si duhet të kujdesemi për biomet detare dhe oqeanike?

Disa nga përgjigjet e mundshme, janë:

- Kuptuam për biomet detare dhe oqeanike, bimët dhe kafshët që jetojnë aty.
- Të mos hidhen mbeturinat, sepse i dëmtojnë kafshët dhe bimët që jetojnë aty, të mos bëhet mbipeshkimi etj.

Kështu nxënësit i ndajnë idetë e tyre dhe i komentojnë përgjigjet e ndryshme me nxënësit e tjerë.

Moçalet janë ekosisteme të ngjashme me liqenet, por shumë të cekëta, të cilat vazhdimisht furnizohen me ujë nga burime të ndryshme. Kryesisht dominohen nga bimët shkurre ose drimore.

Kënetat janë ekosisteme të ngjashme me moçalet. Paraqesin pjesë tokësore me ujë të ndenjur ose me ujë që ka rrjedhje të ngadalshme, të cilat dominohen nga bimët barishtore. Kënetat dhe moçalet formohen nga suksesioni i ekosistemit të liqenit apo nga ndryshimi i rrjedhës së lumenjve kur mbetet një pjesë e masës ujore e izoluar.



Kënetë

2.6.1.2. Biomet detare dhe oqeanike

Paraqesin ekosistemet më të mëdha në planet dhe zënë rreth 70 % të sipërfaqes së tokës. Ujërat e tyre karakterizohen me sasi të madhe të kripërave.





Ndotja e deteve me pasoja të mëdha

2.6.1.3. Çka i rrezikon ekosistemet ujore?

Ekosistemet ujore janë të rrezikuara nga aktivitete të ndryshme të njerëzve, si p.sh.: mbipeshkimi, i cili po dëmton shumë rrjetën e zinxhirëve ushqimorë dhe ndotja e vazhdueshme që vjen nga ujërat e zeza urbane (nga familjet), industria, hedhjet e mbeturinave, shpëlarja e ndotësve të tokës gjatë reshjeve (pesticidet, plehtrat etj.),

aksidentet e anijeve cisterna në det ose nga pastrimi i tyre etj. Llogaritet se në dete rreth 4000 kimikate helmuese shkarkohen vazhdimisht. Sasia më e madhe e ndotësve në liqene, veçanërisht në dete, arrin përmes lumenjve. Si pasojë e ndotjes, shumë lloje bimore dhe shtazore rrezikojnë të zhduken e shumë të tjera janë zhdukur. Problem të veçantë paraqesin mbeturinat, veçmas ato plastike sepse shkaktojnë ngulfatjen e shumë llojeve shtazore. Ka pasur raste që në bregdetet janë gjetur madje edhe individë balene me sasi të madhe plastike në bark siç ishte rasti i balenës në bregdetin tajlandez, në vitin 2018, ku iu gjetën 80 qese plastike. Efektet janë të dukshme edhe në plazhe.

Pyetje

1. Sqaro skemën në faqen 78!
2. Cilën kategori e formojnë llojeve shtazore. Ka pasur raste që në bregdetet janë gjetur madje edhe individë balene me sasi të madhe plastike në bark siç ishte rasti i balenës në bregdetin tajlandez, në vitin 2018, ku iu gjetën 80 qese plastike. Efektet janë të dukshme edhe në plazhe.
3. Çka paraqet lumi dhe si ndahet në zona?
4. Dallo moçalet dhe kënetat.
5. Cilat janë ekosistemet më të mëdha në planet?

Detyrë

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth ekosistemeve ujore dhe ndotjes së tyre, hulumtoni në internet. Të dhënat për ndotjen e tyre i shënoni në fletore dhe i komentoni me nxënësit dhe mësimdhënësin në klasë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënit me këmbime

Nxënësit organizohen në grupe me nga 4 nxënës, ku secili prej tyre është përgjegjës për të lexuar një pjesë. Përgatitet “fleta e ekspertit”, e cila mund të ketë pyetje, detyra ose grafik që të plotësohet. Rigrupohen nxënësit ta lexojnë pjesën që u është caktuar si detyrë. Ata i diskutojnë përfundimet e tyre dhe vendosin për mënyrën se si do t’ua shpjegojnë këtë pjesë të tjerëve kur të shkojnë në grupet fillestare. Më pas, të gjithë nxënësit që kanë të njëjtin numër, ekspertët, raportojnë në grupet fillestare për t’i shpjeguar pjesët më të rëndësishme të pjesës së tyre të tekstit.

Pjesa tjetër e grupit është e gatshme ta mësojë informacionin e ri. Kështu duken fletët e ekspertëve:

Eksperti A

Pyetjet:

- Me çka karakterizohen biomet detare?

Eksperti B

Pyetjet:


- Çka i rrezikon ekosistemet ujore?



Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit: *Rrjeti i diskutimit*

Njeriu mund t’i mbrojë biomet ujore duke mos hedhur mbeturina në ujë, duke e ndërgjegjësuar shoqërinë për mospeshkim të pa lejuar, duke i ushqyer kafshët ujore.

PO



JO

Ekosistemet ujore janë të rrezikuara nga aktivitete të ndryshme të njerëzve, si: mbipeshkimi, ujërat e zeza urbane, industria, mbeturinat plastike.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shpjegimit të rëndësisë së ruajtjes së biomeve ujore dhe analizës së pasojave nga ndotja e biomeve ujore.

Detyrë:

(Gjatë shikimit të videos <https://www.youtube.com/watch?v=4fMemcd-VXw> të analizohen biomet ujore)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6; III. 1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biomet tokësore - pyjet halore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon biomet tokësore.
- Identifikon kushtet jetësore në tajga.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Di-Dua të di-Mësova më shumë

Shënohet njësia mësimore në fillim të tabelës, e ndarë në tri kolona: D-D-M. Kërkohet nga nxënësit të thonë atë çfarë dinë apo mendojnë se dinë për njësinë.

D – D – M Biomet tokësore		
D (Di) Biomet tokësore përfshijnë pyjet, livadhet, fushat.	D (Dua të di)	M (Mësova)

2.6.2. Biomet tokësore



Biomet e planetit Tokë

Në rruzullin tokësor ekzistojnë këto biomet tokësore: tundra, tajga, pyjet gjethërujtëse, pyjet tropikale të shiut, barishtoret dhe shkretëtinat. Klima është faktori dominues në shtrirjen e biomeve në rruzullin tokësor. Veçanërisht janë temperatura dhe reshjet ato që përcaktojnë vendshtrirjen e biomeve.

2.6.3. Biomet pyjore

Biomet pyjore përfaqësojnë biomet më të ndërlukuara dhe më të pasura me lloje bimore e shtazore. Në kuadër të biomeve pyjore hyjnë tajga - pyjet halore, pyjet gjethërujtëse, pyjet gjethetasha (përherë të gjelbra) dhe pyjet tropikale të shiut. Në këto biomet dominojnë llojet drunore, por gjenden dhe shkurre, shumë lloje barishtore, shtazë dhe mikroorganizma.

2.6.4. Pyjet e zonave me klimë të ftohtë dhe mesatare

2.6.4.1. Pyjet halore

Këto pyje janë të njohura edhe me emrin **tajga**. Këto pyje shtrihen ndërmjet zonës së tundrës në veri dhe të pyjeve gjethërujtëse në jug. Dominojnë llojet e halorëve si **pisha, hormoqi, bredhi** etj. Cilësohen me gjethe në formë të halave (nga edhe ka ardhur emri i tyre). Shtrihen në zonat me klimë të ftohtë (dimra të gatë e të ashpër dhe vera të shkurtra). Halorët janë të përhapur edhe në viset e larta malore, mbi brezin e pyjeve gjethërujtëse. Te ne më së shumti gjenden në Malin e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna dhe Koritnik, ku dominojnë **arneni, rrobulli, hormoqi, bredhi**. Nga bota shtazore në këto pyje tona interesante janë disa lloje të shpendëve, si: **gjeli i egër, shqiponja perandorake** etj., ndërsa nga gjitarët: **dhia e egër, ariu i murrmë, rrëqebulli ballkanik, ujku, drceri** etj.



2.6.4.2. Pyjet gjetherënëse

Quhen të tilla sepse u bien gjethet gjatë periudhës vjeshtë - dimër. Këto pyje janë të përhapura në zonat e klimës mesatare që cilësohen me vera të nxehta dhe dimra të ashpër. Kryesisht gjenden në hemisferën veriore. Varësisht prej kushteve klimatike paraqiten disa tipa të pyjeve gjetherënëse, por dominojnë ato të abut dhe të dushkut. Edhe në vendin tonë dominojnë këto pyje që shtrihen prej 400 deri në 1500 m lartësi mbidetare. Në këto pyje jetojnë lloje të shumta të gjitarëve si **lepuri, iriqi, miu, dhelpa, dreri, ujku, ariu, shumë lloje fluturash, bretkosa, gjarpërinj, shpendë etj.**

Karakteristikë për pyjet, sidomos për ato gjetherënëse, është prania e **stelës**. Stelën e formojnë gjethet e rena, veçanërisht gjatë vjeshtës, degët e thata, si dhe mbetjet e shtazëve të ngordhura. Në stelë jeton numër i madh i gjallesave. Stela ka rëndësi për ruajtjen e temperaturës së tokës posaçërisht gjatë dimrit.

Pyjet në Kosovë. Në Kosovë ka pyje halore dhe gjetherënëse, të cilat përbëjnë rreth 42 % të hapësirës së Kosovës. Prandaj, pyjet kanë rëndësi të madhe për ne, meqë i shfrytëzojmë për nevojat tona.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Di-Dua të di-Mësova më shumë

Pas plotësimit të kolonës së parë me mendimet e nxënësve rreth njësisë, ata fillojnë ta lexojnë paragrafin në libër. Gjatë leximit i formulojnë pyetjet dhe i shënojnë të gjitha paqartësitë apo fjalët e panjohura që kanë hasur gjatë leximit. Pas përfundimit të formulimit të pyetjeve, nxënësit i lexojnë paqartësitë e tyre të cilat më pas shënohen nga mësimitdhënësi në tabelë në kolonën e mesit D (Dua të di).

D - D - M Biomet tokësore		
D (Di) Biomet tokësore përfshijnë pyjet, livadhet, fushat.	D (Dua të di) Pse quhen pyje halore? Si njihen ndryshe këto pyje?	M (Mësova)



Përforcimi: Konsolidimi i të nxëniti:

Di-Dua të di-Mësova më shumë

Pas përfundimit të leximit, vazhdojnë ta plotësojnë edhe kolonën e tretë M (Mësova).

D - D - M		
D (Di) Biomet tokësore përfshijnë pyjet, livadhet, fushat.	D (Dua të di) Pse quhen pyje halore? Si njihen ndryshe këto pyje?	M (Mësova) Sepse këto pyje gjethet i kanë në formë të halave.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të biomeve tokësore dhe identifikimit të kushteve jetësore në tajga.

Detyrë:

(Të plotësohet fletore pune në faqe 51 dhe të ilustronë në fletore bimë dhe kafshë që jetojnë në pyje halore)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III. 1; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pyjet gjithërrënëse

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon llojet bimore dhe shtazore që dominojnë në pyjet gjithërrënëse.
- Krahason pyjet gjithërrënëse dhe pyjet halore.
- Përshkruan rëndësinë e stelës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fotografi të printuara nga interneti të pyjeve gjithërrënëse.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, Edukatë qytetare.

Përfitimet nga pylli. Përveç drurit që ka shumë përdorime, përdoren edhe produkte të tjera të pyllit. Boronicat, mjedrat, manaferrat dhe kërpudhat mbliiden shumë. Mirëpo, duhet të keni kujdes gjatë mbledhjes së kërpudhave, sepse disa janë helmuese. Gjuetia është gjithashtu një faktor i rëndësishëm ekonomik që zhvillohet në pyje. Pos të tjerash, pyjet ndikojnë në klimë. Ato pasurojnë atmosferën me lagështi, pastrojnë ajrin duke absorbuar pluhurin dhe ndotës të tjerë; mbrojnë nga era, zhurma. Po ashtu, janë prodhuesit më të mëdhenj të oksigjenit. Pyjet mbrojnë nga rreziqet natyrore: erozioni, ortekët.

Uji nga burimet e zonave pyjore zakonisht është me cilësi shumë të mirë. Atje nuk përdoren plehra dhe pesticide. Pyjet janë dhe zona rekreative. Gjatë shëtitjeve në pyll, ju mund të relaksoheni, merrni ajër të freskët dhe mund t'i vrojtoni shtazët dhe bimët.




Stela



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësit
Harta semantike





Të mbahet në mend!

- Pyjet halore shtrihen në zonat me klimë të ftohtë me dimra të gjatë dhe vera të shkurtra.
- Pyjet halore njihen me emrin taiga dhe janë brezi më kompakt (i pashkëputshëm) në botë.
- Pyjet gjetherënëse shtrihen në zonat me klimë mesatare me dimra të ashpër dhe vera të nxehta.
- Pyjet gjetherënëse janë të shumëllojshme, ndër të cilat dominojnë ato të dushkut dhe të ahut.

Pyetje

1. Përshkruaj kushtet jetësore në taigë dhe ku ajo është e përhapur.
2. Trego ose quhen pyje halore dhe cilat lloje dominojnë në to.
3. Në cilat rajone janë të përhapura pyjet gjetherënëse dhe pse quhen të tilla?
4. Emërto disa nga llojet shtazore në pyjet halore dhe gjetherënëse.
5. Ç'është stela?

Detyrë

Bëni një listë të veçorive që i dini për një pyll. Mundohuni t'i tregoni këto veçori me foto dhe vizatime. Shënoni cilat produkte të pyjeve i përdorni çdo ditë dhe çfarë roli kanë pyjet në natyrë dhe nëshëndetin tonë.

83



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Sistemi ndërveprues i shënimeve**

√	+	-	?
Quhen pyje gjetherënëse, sepse gjatë periudhës vjeshtë-dimër u bien gjethet.	Pyjet e pasurojnë atmo-sferën me lagështi, e pastrojnë ajrin duke e absorbuar pluhurin dhe ndotës të tjerë.	Stela ka rëndësi për ruajtjen e temperaturës së tokës, posaçërisht gjatë dimrit.	Çka quajmë stelë? Cilat janë përfitimet nga pylli?

Nga nxënësit kërkohet që të lexohet teksti. Gjatë leximit duhet të vendosin këto shenja në njërën anë të tekstit.
 “√” - kur informacioni që lexoni pohon atë çka dini.
 “+” - kur një pjesë e informacionit që lexoni është e re për ju.
 “-” - kur informacioni që lexoni është në kundërshtim me atë që dini ose mendoni se e dini.
 “?” - kur ka informacion që është i paqartë ose doni të dini më shumë për të.



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët:
Diagrami i Venit**

Pyjet gjetherënëse

Quhen pyje gjetherënëse sepse gjatë periudhës vjeshtë-dimër u bien gjethet. Dominojnë pyjet e ahut dhe dushkut.

Ngjashmëritë

Kanë klimë të ftohtë/mesatare. Pasurojnë ajrin me oksigjen.

Pyjet halore

Cilësohen me gjethe në formë të halave. Dominojnë arneni, rrobulli, harmoçi, bredhi. Gjethet në formë të halave nuk bien gjatë dimrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të llojeve bimore dhe shtazore që dominojnë në pyjet gjetherënëse, krahasimit të pyjeve gjetherënëse dhe pyjeve halore dhe përshkrimit të rëndësisë së stelës.

Detyrë:

(Të plotësohet fletore pune, faqe 52-54)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënët të temës:
 Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; III. 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pyjet e zonave me klimë të nxehtë

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Dallon karakteristikat e pyjeve gjethetrasha dhe atyre tropikale të shiut.
- Identifikon llojet bimore dhe shtazore, karakteristike e pyjeve gjethetrasha dhe atyre tropikale të shiut.
- Emërton të paktën 3 bimë mjekësore dhe ushqyese.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
[LINK](#)

Shënohet një koncept në mes të tabelës duke i lënë nxënësit për pak minuta t'i renditin lidhjet për këtë koncept. Në fletët A4, nxënësit duhet t'i paraqesin mendimet e tyre në këtë mënyrë. Nxënësit bashkëveprojnë për t'i shkëmbyer njohuritë ashtu edhe për ta zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi konceptin.



2.6.5. Pyjet e zonave me klimë të nxehtë

2.6.5.1. Pyjet gjethetrasha (përherë të gjelbra)

Quhen të tilla sepse gjethet i kanë të trasha "lëkurore" dhe përherë të gjelbra. Këto pyje janë të përhapura në zonat bregdetare, ku dominon klima mesdhetare. Në këto zona, verat janë të nxehta dhe të thata, ndërsa dimrat e butë, të lagësht, rrallëherë me ngrica, të cilat nuk kanë ndikim të madh në bimë. Ndër llojet karakteristike gjethetrasha janë: leandri, mërsina, ilqeja etj. Pyjet përherë të gjelbra janë të njohura për llojet e shumta mjekësore dhe aromatike, si: livanda, mërsina, rozmarina, sherbela etj. Në këto pyje jeton dhe një numër i madh i llojeve shtazore, si: lepuri, dhelpra, shumë lloje gjarpërinjsh, shpendë etj.



Livanda

2.6.5.2. Pyjet tropikale të shiut

Këto pyje shtrihen në të dyja anët e ekuatorit. Ndërshye quhen edhe pyje të pashkelura. Në këtë zonë, rrezet e diellit bien direkt në tokë gjatë gjithë vitit, për këtë arsye temperatura është e lartë (25-27 °C). Po ashtu, zona karakterizohet me sasi të mëdha të reshjeve, prandaj quhen pyje tropikale të shiut. Edhe pse këto pyje përfshijnë vetëm rreth 2 % të tokës, llogaritet se ato përmbajnë rreth 80 % të të gjitha llojeve të bimëve dhe shtazëve që gjenden në planet. Kjo begati me biodiversitet është arritur në saje të temperaturës së vulltishme dhe sasisë së mjaftueshme të ujit që organizmat kanë në dispozicion. Paraqiten pothuajse të gjitha format jetësore të bimëve, por dominojnë bimët drunore, lijana (kacavjerrëse) dhe ato epifite. **Bimë të dobishme nga pyjet tropikale të shiut.** Jo vetëm druri me cilësi të lartë vjen nga pyjet e shiut, i bimëve mjekësore, por edhe një numër i atyre frutore ushqyese. Banania është një nga më të njohurat. Frutat e bananeve kanë një përmbajtje të lartë të amidonit dhe përmbajnë vitaminat A, B dhe C. Pastaj vanilja, kanella, kafja, kakao etj.



Rozmarina



Pyjet tropikale

Disa nga bimët dhe shtazët karakteristike që jetojnë në pyjet tropikale



Kaulifloria



Pitoni



Tarantula



Dhelpra fluturuese



Marmosi



Pema e bananes



Kolibri

85



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Ditarët e të nxënësve (Ditari trepjesësh)

Nxënësit organizohen të punojnë në dyshe. Në fletoret e tyre duhet ta paraqesin tabelën si më poshtë.

Citim	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
- Pyjet me klimë të nxehtë kanë shumë bimë dhe kafshë.	- Pyjet me klimë mesdhetare e mundësojnë llojllojshmërinë e bimësisë dhe të kafshëve.	- Pyjet tropikale të shiut shtrihen në të dyja anët e ekuatorit dhe dallohen si më të begatshmet me lloje bimore e shtazore dhe njëherësh më karakteristike në botë.

Prezantohet pjesa për lexim dhe u thuhet nxënësve që në fillim t'i nënvizojnë pjesët që u bëjnë përshtypje apo në qoftë se kanë pyetje. Pas leximit dhe nxjerrjes së citimeve, u jepet kohë t'i bëjnë komentet e tyre. Në kolonën e tretë mësuesi vlerëson dhe gjykon duke dhënë mendime mbi komentet që kanë bërë nxënësit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve:

Diskutim në grup

Nxënësit organizohen në katër grupe me nga katër nxënës: detyra e tyre është të diskutojnë, shkëmbejnë mendime dhe u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në fazën e dytë të orës. Po ashtu, paqartësitë plotësohen edhe me ndihmën e mësuesit. Më pas, nga një përfaqësues për çdo grup ua tregojnë nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të karakteristikave të pyjeve gjetetrasa dhe atyre tropikale të shiut, identifikimit të llojeve bimore dhe shtazore, karakteristikë e pyjeve gjetetrasa dhe atyre tropikale të shiut dhe emërtimit të së paku 3 bimëve mjekësore dhe ushqyese.

Detyrë:

(Shkruani një ese shpjeguese rreth rëndësisë së pyjeve tropikale për pasurimin e planetit Tokë me oksigjen)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III. 3, 5; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biomet barishtore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan biomet barishtore.
- Krahason botën bimore dhe shtazore në mes të stepave dhe savanave.
- Numëron shkaqet e zvogëlimit të biomeve barishtore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fotografi të printuara për biomet barishtore.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Përvijimi i të menduarit


Biomet barishtore



2.6.6. Biomet barishtore



Stepa në Amerikë



Savanat (1. Akacia, 2. Adansonia digitata - baobab)



Kopeja e zebrave



Llavra e luanëve

Këto gjenden në pjesët e Tokës ku kushtet jetësore janë të pavalitshme për zhvillimin e pyjeve, por dhe nuk janë në shkallë si në shkretëtira. Në këto biome dominojnë bimët barishtore, por paraqiten edhe individë të rrallë të bimëve drunore. Në biomet barishtore bëjnë pjesë: **stepat, savanat, livadhet dhe kulllotat.**

Stepat përfaqësojnë rajone të gjera rrafshinore të brezit me klimë mesatare të Evropës, Azisë dhe Amerikës Veriore. Përbehen nga bimë barishtore, rrallë nga ndonjë individ i bimëve shkurre apo drunore. Nga bota shtazore në stepa jeton numër i konsiderueshëm i insekteve, i fluturave, i shpendëve, gjarëve e sidomos brejtës që në tokë formojnë korridore të shumta. Stepat kanë shkuar duke u zvogëluar vazhdimisht nga ana e njeriut, duke u shndërruar në tokë për mbjellje të kulturave bimore (grurë, elb, misër etj.) Në stepat e Amerikës Veriore, që quhen **preri**, jeton edhe bizoni.

Savanat përfaqësojnë sipërfaqe të mëdha barishtore të viseve tropike dhe subtropike, kryesisht në Afrikë, në Amerikën e Jugut dhe Australi, ku dominon vegjetacioni i lartë barishtor, ndërsa rrallë gjenden edhe ndonjë bimë drunore, siç është **Adansonia digitata** (baobab), si dhe akaciet që zakonisht kanë formën e ombrellës, në hijen e së cilës, gjatë ditëve të nxehta, strehohen shumë shtazë. Rajonet ku janë të përhapura savanat karakterizohen me dimra të butë e të pasur me reshje dhe vera të nxehta e të thata. Nga bimëngrënësit në savanë dallohen kopetë e mëdha të **antilopave, zebrave, gjirafave, buajve, elefantëve**, ndërsa nga mishngrënësit dallohen llavat e **hienave, luanëve, leopardëve** etj. Gjatë periudhës së thatësisë, shtazët migrojnë prej një vendi në tjetrin, duke kërkuar burimet e ujit dhe ushqimit.

Livadhet dhe kulllotat janë ekosisteme barishtore të krijuara në mënyrë natyrore dhe nga veprimtaria e njeriut. Livadhet natyrore janë ato rreth pellgjeve të lumenjve rrafshinorë, kulllotat natyrore ndodhen në zonat alpine, ndërsa ato artificiale gjenden kryesisht afër tokave të

punuara bujqësore dhe krijohen nga aktivitetet e njeriut, si: prerja e pyjeve, tharja e moçaleve e kënetave. Livadhet natyrore dhe kullotat alpine dallojnë mes vete: livadhet përbëhen nga bimë të gjata barishtore dhe me lule më të vogla, ndërsa kullotat alpine nga bimë të shkurtra dhe me lule më të mëdha - për shkak të intensitetit më të madh të dritës. Ato dallohen dhe për nga mënyra e shfrytëzimit të tyre: livadhet zakonisht koston, ndërsa kullotat shfrytëzohen nga bagëti - kullotën. Prej shtazëve në livadhe më së shumti hasen **karkalecat, milingonat, bletët, fazani, thëllëza, harabeli, lepuri** etj.



Livadhi natyror



Kullota alpine



Livadhi i krijuar nga aktivitetet e njeriut - prerja e pyjeve

Të mbahet në mend!

- Biomet barishtore njihen si stepa, savana, livadhe dhe kullota, ku dominon vegetacioni barishtor, rrallë ka bimë drunore ose shkurrore.
- Stepat përfshijnë rajone të gjera rrafshinore të brezit me klimë mesatare të Evropës, Azisë dhe Amerikës Veriore.
- Savanat përfshijnë sipërfaqe të mëdha barishtore që shtrihen në zonat me klimë tropikale dhe subtropikale, kryesisht në Afrikë, në Amerikën e Jugut dhe në Australi.
- Livadhet dhe kullotat janë të krijuara në mënyrë natyrore dhe nga veprimtaria e njeriut, me prerjen e pyjeve dhe me tharjen e moçaleve e kënetave.

Pyetje

1. Emërto biomet barishtore dhe sqaro përhapjen e tyre.
2. Pse është zvogëluar sipërfaqja e stepave?
3. Çfarë klimë i karakterizojnë rajonet ku shtrihen savanat?
4. Përskruaj dallimet e botës shtazore në mes stepave dhe savanave.
5. Trego çka paraqesin livadhet dhe kullotat!

88



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Mësimdhënësi paraqet në tabelë një organizues grafik që thekson biomet barishtore. Nxënësit do të mbajnë shënime për informacionin e duhur në skicën e grafikut, duke i përshkruar dhe duke i analizuar stepat, savanat, livadhet dhe kullotat. Kërkohej nga nxënësit që ta respektojnë plotësimin e kutive në rrugë logjike, pasi të kenë lexuar në dyshe një fragment të caktuar nga libri. Plotësimin e organizuesit grafik e ndihmon shumë edhe shikimi i fotografive që kanë përpara në tabelë.

Stepat ndryshe njihen si preri dhe përfshijnë rajone të gjera rrafshinore.

Savanat përfshijnë sipërfaqe të mëdha barishtore.

Biomet barishtore

Livadhet janë rajone të rrafshita me bimë barishtore dhe lule të vogla.

Kullotat janë më të pjerrëta, me bimë të shkurtra dhe me lule të gjata.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Rishikimi në dyshe

Nxënësit organizohen në dyshe: detyra e tyre është të diskutojnë, të shkëmbejnë mendime dhe t'u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në pjesën e dytë të orës mësimore. Më pas, nga një përfaqësues për çdo grup ua tregojnë nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit të grupit të tyre duke shkëmbyer ide, mendime dhe pyetje me dyshet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të biomeve barishtore, krahasimit të botës bimë dhe shtazore në mes të stepave dhe savanave dhe numërimit të shkaqeve të zvogëlimit të biomeve barishtore.

Detyrë:

(Të plotësohet fletore pune në faqet 58-59)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6; III. 1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan biomet tokësore.
- Krahason pyjet halore me pyjet gjetherënëse.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, kompjuter, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, TIK.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Imagjinata e drejtuar

Prezantohet para nxënësve videoja rreth pyjeve halore dhe gjetherënëse

<https://www.youtube.com/watch?v=3CrZL7pC64>

Gjatë shikimit të videos nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve:

- Çka kuptuat nga kjo video?
- Çfarë dallimesh kishin këto pyje me njëra-tjetrën?

Disa nga përgjigjet e mundshme, janë:

- Kuptuam biomet tokësore, pyjet halore dhe gjetherënëse.
- Pyjet halore kishin gjethet të vogla në formë të halave dhe gjethet nuk bien gjatë dimrit, kurse pyjet gjetherënëse kishin gjethet më të mëdha dhe ato bien gjatë stinës vjeshtë-dimër.




Armeni



Rrobulli



Gjeli i egër



Dhia e egër



Pyjet e dushkut

vendin tonë dominojnë këto pyje që shtrihen prej 400 deri në 1500 m lartësi mbidetare. Në këto pyje jetojnë lloje të shumta të gjitarëve si lepuri, iriqi, miu, dhelpra, dreri, ujku, ariu, shumë lloje fluturash, bretkosa, gjarpërinj, shpendë etj.

Karakteristikë për pyjet, sidomos për ato gjetherënëse, është prania e stelës. Stelën e formojnë gjethet e rena, veçanërisht gjatë vjeshtës, degët e thata, si dhe mbetjet e shtazëve të ngordhura. Në stelë jeton numër i madh i gjallesave. Stela ka rëndësi për ruajtjen e temperaturës së tokës posaçërisht gjatë dimrit.


Pyjet në Kosovë. Në Kosovë ka pyje halore dhe gjetherënëse, të cilat përbëjnë rreth 42 % të hapësirës së Kosovës. Prandaj, pyjet kanë rëndësi të madhe për ne, meqë i shfrytëzojmë për nevojat tona.

2.6.4.2. Pyjet gjetherënëse

Quhen të tilla sepse u bien gjethet gjatë periudhës vjeshtë - dimër. Këto pyje janë të përhapura në zonat e klimës mesatare që cilësohen me vera të nxehta dhe dimra të ashpër. Kryesisht gjenden në hemisferën veriore. Varësisht prej kushteve klimatike paraqiten disa tipa të pyjeve gjetherënëse, por dominojnë ato të abut dhe të dushkut. Edhe në

Përfitimet nga pylli. Përveç drurit që ka shumë përdorime, përdoren edhe produkte të tjera të pyllit. Boronicat, mjedrat, manaferrat dhe kërpudhat mbledhen shumë. Mirëpo, duhet të keni kujdes gjatë mbledhjes së kërpudhave, sepse disa janë helmuese. Gjuetia është gjithashtu një faktor i rëndësishëm ekonomik që zhvillohet në pyje. Pas të tjerash, pyjet ndikojnë në klimë. Ato pasurojnë atmosferën me lagështi, pastrojnë ajrin duke absorbuar pluhurin dhe ndotës të tjerë; mbrojnë nga era, zhurma. Po ashtu, janë prodhuesit më të mëdhenj të oksigjenit. Pyjet mbrojnë nga rreziqet natyrore: erozioni, ortekët.

Uji nga burimet e zonave pyjore zakonisht është me cilësi shumë të mirë. Atje nuk përdoren plehra dhe pesticide. Pyjet janë dhe zona rekreative. Gjatë shëtitjeve në pyll, ju mund të relaksoheni, merrni ajër të freskët dhe mund t'i vrojtoni shtazët dhe bimët.



Stela



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Harta semantike

Pyjet halore gjenden në Malin e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna.

Pyjet halore dhe gjetherënëse

Te pyjet gjetherënëse është karakteristikë prania e stelës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të biomeve barishtore, krahasimit të botës bimore dhe shtazore në mes të stepave dhe savanave dhe numërimit të shkaqeve të zvogëlimit të biomeve barishtore.

Detyrë:

(Të realizohet në shtëpi eksperimenti i dhënë në fletore pune, faqe 54-55.)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Të nxënit me këmbime

Nxënësit organizohen në grupe me nga 4 nxënës, ku secili prej tyre është përgjegjës për të lexuar një pjesë. Përgatitet “fleta e ekspertit”, e cila mund të ketë pyetje, detyra ose grafik që të plotësohet. Rigrupohen nxënësit ta lexojnë pjesën që u është caktuar si detyrë. U kërkohet anëtarëve të grupit ta analizojnë informacionin e mbledhur nga çdo anëtar, të cilin do ta bashkojnë në një përmbledhje tërësore të çështjeve kryesore. Ata i diskutojnë përfundimet e tyre, më pas të gjithë nxënësit që kanë të njëjtin numër, ekspertët, raportojnë në grupet fillestare për t’i shpjeguar pjesët më të rëndësishme të pjesës së tyre të tekstit.

Pjesa tjetër e grupit është e gatshme ta mësojë informacionin e ri. Kështu duken fletët e ekspertëve:

Eksperti A
Pyetjet:
- Çka i karakterizon pyjet halore?
- Gjethet, llojet bimore...

Eksperti B
Pyetjet:
- Çka i karakterizon pyjet gjetherënëse?
- Gjethet, llojet shtazore...

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, 6; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Biomet me kushte të papërshtatshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan saktë karakteristikat e tundrave dhe shkretëtirave.
- Analizon si i janë përshtatur jetës llojet bimore dhe shtazore në këto biome.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fotografi të printuara nga interneti për biomën e tundrave dhe të shkretëtirave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Diskutim për njohuritë paraprake

Shënohet titulli në tabelë, pastaj në secilën bankë shpërndahen fotografi të printuara për biomën e tundrave dhe të shkretëtirave dhe nxënësit individualisht duhet të shënojnë për njohuritë paraprake që kanë për këto biome.

Shkretëtirat

Në shkretëtira është shumë nxehtë gjatë vitit, këtu jeton deveja.

Tundrat

Këtu jeton ariu polar, ujku polar dhe është shumë ftohtë gjatë vitit.

2.6.7. Biomet me kushte të papërshtatshme

2.6.7.1. Tundra

Është biomë që shtrihet në pjesën më veriore të rruzullit tokësor me klimë polare. Kushtet jetësore në tundër janë shumë të pavolitshme për jetesë. Dimrat janë të gjatë me temperatura gati përherë nën 0 °C dhe vera të shkurtra e të ftohta me temperatura maksimale deri në +10 °C. Erërat janë të fuqishme dhe fryjnë pothuajse pa ndërprerë. Këto kushte ndikojnë në dominimin e likeneve, myshqeve dhe disa lloje të bimëve barishtore, rrallë gjendet ndonjë shkurre. Në tundër gjatë tërë vitit hasen **dreri polar, dhelpra polare, ariu polar, ujku polar** etj. Ndërsa gjatë verës së shkurtrë shihen disa shpendë migrues dhe mjaft insekte.



Tundra

2.6.7.2. Shkretëtirat

Çfarë është një shkretëtirë? Pse çdo herë kur shohim apo lexojmë për ndonjë kaktus dhe deve, na kujtohet shkretëtira?
 Për shumë njerëz, shkretëtirat janë vende të shkreta dhe pa jetë. Në të vërtetë, shkretëtirat janë gjithashtu vendbanime (habitate) të ndryshme që strehojnë banorë të ndryshëm. Organizmat që jetojnë në

Disa nga llojet e gjitarëve që jetojnë në tundër (dhelpra polare, lepur polar, ujku polar)



Shkretëtira e thatë



Shkretëtira e ftohtë



Një oazë në shkretëtirë

shkretëtira janë shumë të specializuar për shkak të kushteve ekstreme. Për të mbijetuar, ata kanë mënyra të përshtatjes për ruajtjen e ujit në trupin e tyre dhe rezistencë ndaj temperaturave të larta. Të gjitha shkretëtirat së bashku aktualisht mbulojnë rreth një të pestën e sipërfaqes së përgjithshme të tokës. Dallojmë shkretëtirat e thata dhe shkretëtirat e ftohta (në rajonet polare). Shkretëtirat e thata shtrihen në disa rajone të Afrikës, Azisë, Australisë dhe Amerikës Veriore. Jetesa në shkretëtirë është e vështirë, sepse ka reshje të rralla dhe të pakta, luhatje të mëdha të temperaturës dhe erëra të forta. Prandaj në shkretëtira jetojnë lloje të pakta bimore e shtazore. Prej llojeve bimore veçohen kaktuset, ndërsa në oaza jetojnë palmat, si dhe disa lloje të bimëve barishtore, ndërsa nga shtazët **deveja një dhe dygungore**, por hasen edhe kojota, disa lloje të minjve, të hardhucave, të insekteve etj. Disa bimë të shkretëtirave janë shumë të përdorshme, p.sh., **palma e hurmës** (njihet edhe si "bukë e shkretëtirës"), **aloeja** (bazë e produkteve të ndryshme në kozmetikë si kremra për lëkurë, shampo), **agavja** (bimë dekorative) etj.



Palma e hurmës



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Shpjegim i përparuar

Prezantohet njësia mësimore “Biomet me kushte të papërshtatshme”, tregohet shkurtimisht përmbajtja e temës.

Nxënësit do të punojnë në grupe me nga katër nxënës dhe pastaj në dyshe. Atyre u kërkohet që të diskutojnë për këto biome dhe në bashkëbisedim me njëritjetrin të shkruajnë se çfarë mund të dinë. Mendimet e tyre i shkruajnë në një fletë dhe më pas i diskutojnë me gjithë klasën. Zhvillohet pjesa e parë e shpjegimit nga mësimdhënësi, pastaj kërkohet nga nxënësit që t'i shikojnë në fletë mendimet e tyre. Mësimdhënësi parashtron pyetje:

Çfarë ka të përbashkët në fletën tuaj dhe në ato që u përmendën në lexim? Çfarë gjërash të reja mësuat?

Vazhdohet pjesa e dytë e shpjegimit, mësimdhënësi kërkon që nxënësit të dëgjojnë me vëmendje duke i pasur parasysh shënimet me idetë e tyre. Më pas, kërkohet nga ndonjë pjesëtar i grupeve të shprehë disa nga përfundimet e tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët: Rishikimi në dyshe

Nxënësit organizohen në dyshe: detyra e tyre është të diskutojnë, të shkëmbejnë mendime dhe t'u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në pjesën e dytë të orës mësimore. Më pas, nga një përfaqësues për çdo grup ua tregon nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit të grupit të tyre duke shkëmbyer ide, mendime dhe pyetje me dyshtet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të karakteristikave të tundrave dhe shkretëtirave dhe analizës se si i janë përshtatur jetës llojet bimore dhe shtazore në këto biome.

Detyrë:

(T'u përgjigjen në fletore pyetjeve të dhëna në librin bazë faqe 91)

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Krahason dhe bën dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 1, 7; III. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ekosistemet e kultivuara tokësore - artificiale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon ekosistemet e kultivuara tokësore.
- Dallon ekosistemet e kultivuara të tipit pyjor dhe bujqësor.
- Krahason ekosistemet e kultivuara dhe ato natyrore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, Fizikë, Edukatë qytetare.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

[LINK](#)

Shënohet një koncept në mes të tabelës duke i lënë nxënësit për pak minuta t'i renditin lidhjet për këtë koncept. Në fletët A4, nxënësit duhet t'i paraqesin mendimet e tyre në këtë mënyrë. Nxënësit bashkëveprojnë për t'i shkëmbyer njohuritë ashtu edhe për ta zgjeruar të kuptuarit e tyre mbi konceptin.



Monokulturë nga bredhi



Sipërfaqe e mbjellë me mollë



Sipërfaqe e mbjellë me rrush

2.6.8. Ekosistemet tokësore të kultivuara - artificiale

Ekosistemet tokësore të kultivuara janë krijuar nga veprimtaria e njeriut në zona të ndryshme të planetit Tokë. Ato janë krijuar duke i shkatërruar hapësirat e dikurshme të pyjeve, të ekosistemeve barishtore, me tharjen e moçaleve e kënetave etj.

Ekosistemet e kultivuara janë të tipit pyjor, (pyjet e kultivuara, p.sh., me bredh, hormoq etj.) dhe bujqësore gruri, misri etj. Pyjet që menaxhon njeriu quhen pyje ekonomike. Një pyll në të cilin njerëzit mbjellin vetëm një lloj druri quhet monokulturë.

Në agroekosisteme bëjnë pjesë: pemishtet, vreshtat, perimekulturat, sipërfaqet me drithëra (gruri, misri, elbi etj.), sipërfaqet me bimë industriale (ulliri, duhani, soja, luledielli, panxharsheqeri etj.).

Ekosistemet e kultivuara dallohen prej ekosistemeve natyrore si për nga struktura, ashtu dhe funksioni (tab. 2). Ato të kultivuara mirëmbahen nga njeriu duke i lëvruar, prashitur, ujitur, plehëruar, përzgjedhur farën me rendiment më të lartë etj.

Tabela 2. Karakteristikat e ekosistemeve natyrore dhe të ekosistemeve të kultivuara

Dallimet strukturore dhe funksionale ndërmjet ekosistemeve natyrore dhe ekosistemeve të kultivuara		
Karakteristikat	Ekosistemet natyrore	Ekosistemet e kultivuara
Prodhimtaria neto - përfundimtare	Mesatare	E lartë
Zinxhirët ushqimorë	Të ndërlikuar	Të thjeshtë
Laramania e llojeve	E madhe	E vogël
Qëndrueshmëria	E fortë	E dobët
Qëndrueshmëria në kohë	E gjatë	E shkurtër
Kushtet e mjedisit	Të ndërlikuara	Të thjeshta

Prodhimtaria e bimëve të kultivuara është në varësi nga cilësia e punës, që ka bërë fermeri në to, p.sh.: lëvrimi (a është në kohën e duhur dhe i thellë), plehërimi, ujitja, si dhe mbrojtja prej dëmtuesve të ndryshëm.



Sipërfaqe e mbjellë me ullinj



Sipërfaqe e mbjellë me grurë dhe misër



Sipërfaqe e mbjellë me patate



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja e sjell pyetjen

Formulohen pyetjet e duhura për nxënësit duke filluar me pse rreth materialit që ata do ta lexojnë. Për shembull, paragrafi më poshtë paraqet një pjesë nga njësia mësimore:

Ekosistemet tokësore të kultivuara janë krijuar nga veprimtaria e njeriut në zona të ndryshme të planetit Tokë. Ato janë krijuar duke i shkatërruar hapësirat e dikurshme të pyjeve, të ekosistemeve barishtore, me tharjen e moçaleve e kënetave etj.

Pasi nxënësit ta analizojnë paragrafin, u bëhen pyetje duke filluar me pse që do ta përqendrojnë vëmendjen e tyre në lidhjet shkak-pasojë në njësinë mësimore. Disa nga pyetjet mund të jenë:

1. Pse ekosistemet e kultivuara artificiale dallohen nga ato natyrore?
2. Pse ekosistemet natyrore kanë prodhimtari më të ulët se ato të kultivuara-artificiale?

Pastaj kërkohet nga nxënësit ta lexojnë paragrafin e ardhshëm, të formulojnë pyetje me *pse* dhe të shkëmbejnë ide origjinale rreth përgjigjeve të mundshme për pyetjet e tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxëniti: Rishikimi në dyshe

Modelohet strategjia *Shënime mbi shënime* duke përdorur kategori të njohura për nxënësit. Tregohet si lidhen treguesit me njëri-tjetrin. Treguesi 1 është ideja kryesore (*Ekosistemet e kultivuara*), Treguesit 2 janë shembuj të treguesit 1 (*Ekosisteme pyjore, bujqësore*). Treguesit 3 janë shembuj të përpunimit të treguesve 2.

1. Ekosisteme të kultivuara-artificiale
2. Ekosisteme pyjore
3. Pyjet e harmoçit
3. Pyjet e bredhit
2. Ekosisteme bujqësore
3. Gruri
3. Misri

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përkufizimit të ekosistemeve të kultivuara tokësore, dallimit të ekosistemeve të kultivuara të tipit pyjor dhe bujqësor dhe krahasimit të ekosistemeve të kultivuara dhe atyre natyrore.

Detyrë:

(Të analizohet videoja <https://www.youtube.com/watch?v=8PQiucc268c> dhe të shkruhet një ese për të)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis. Ndikimi pozitiv p.sh.: ruajtja e biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ p.sh.: zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, 6; III. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan ndikimet e njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor.
- Shpjegon burimet e ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme.
- Identifikon pasojat e civilizimit për mjedisin jetësor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, Fizikë, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Di-Dua të di-Mësova më shumë

Shënohet njësia mësimore në fillim të tabelës, e ndarë në tri kolona: D-D-M. Kërkohet nga nxënësit të thonë atë çfarë dinë apo mendojnë se dinë për njësinë. Shënohen mendimet e nxënësve në kolonën e parë D (Di).

D – D – M Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor		
D (Di)	D (Dua të di)	M (Mësova)
Ne duhet ta ruajmë mjedisin jetësor. Nuk duhet t'i presim pyjet, sepse ato na japin oksigjen.		

2.7. NDIKIMI I NJERIUT NË NATYRË DHE MJEDIS JETËSOR

2.7.1. Si e kemi ndryshuar mjedisin jetësor?

Njerëzit kanë qenë në Tokë për 200 mijë vjet. Në fillim, ndikimi i njeriut në mjedisin jetësor ka qenë pasiv dhe gati i padukshëm, pothuajse i njëjtë me llojet e tjera. Para rreth 10000 vjetësh, kur njeriu zbuloi përdorimin e mjeteve të punës, fillon periudha e ndërhyrjes aktive në mjedisin jetësor. Rritja e numrit të banorëve ka bërë që të rritet nevoja për sasi më të madhe të ushqimit, të hapësirës etj. Kështu është rritur edhe domosdoshmëria e shndërrimit të pyjeve dhe livadheve, moçaleve natyrore në sipërfaqe të punuara, për ndërtimin e vendbanimeve më të mëdha (qyteteve) dhe për infrastrukturë banimi (rrugë, hekurudha etj.). Këto ndryshime dallohen shumë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, si rezultat i zhvillimit të hovshëm demografik, i industrisë, i bujqësisë intensive, i automobilizimit, i ndërtimitarisë etj. Edhe në vendin tonë janë shkaktuar ndryshime të mëdha në ekosistemet natyrore, veçmas në ato të pyjeve, ku kemi humbje të mëdha të biodiversitetit.



Shpyllëzimi



Cilët janë shkaktarët që rrezikojnë mjedisin jetësor? Ata janë fenomene të ndryshme natyrore, si p.sh., shtirëngata, uraganet, tërmetet, vullkanet, rrufeja etj., ose njerëzore, ku bëjnë pjesë aktivitetet njerëzore që dëmtojnë mjedisin, si p.sh., mbishfrytëzimi i burimeve natyrore, shpyllëzimi, bujqësia, urbanizimi (ndërtimi i vendbanimeve, zonave industriale), ndotja (që vjen nga bujqësia, industria, amvisëria etj.).

Si t'i shfrytëzojmë burimet natyrore? Burimet natyrore janë të gjitha të mirat që njeriu i merr nga planeti Tokë për të siguruar ekzistencën e tij. Ka dy lloje të burimeve natyrore: të papërtërishme dhe të ripërtërishme.

Burime të papërtërishme janë ato burime natyrore që nuk rikrijohen, p.sh., mineralet, thëngjilli, nafta dhe gasi natyror. Burimet natyrore të ripërtërishme janë ato burime që kanë aftësi të ripërtërihen pas një kohe relativisht të shkurtër, p.sh., biomasa (gjërat që vijnë nga biodiversiteti), energjia diellore dhe uji. Kohët e fundit, burimet natyrore të ripërtërishme, siç është biodiversiteti, poshfritytëzohen mbi nivelin që ato kanë për rigjenerimin e vetvetes. Ky mbishfrytëzim po kryhet përmes aktiviteteve si prerja ilegale e pyjeve, mbledhja jo e qëndrueshme dhe ilegale e bimëve mjekësore dhe aromatike, peshkimi jo i qëndrueshëm, gjuetia ilegale (për shkak të kërkesës së lartë për lëkura, dhëmbë të fildishtë, ushqim etj.). Burimet natyrore duhen shfrytëzuar, por jo të tejkalohet shkalla e ripërtërishjes së tyre.



Gjuetia ndaj elefantit për dhëmbët e fildishtë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Di-Dua të di-Mësova më shumë

Pas plotësimit të kolonës së parë me mendimet e nxënësve rreth njësisë, ata fillojnë ta lexojnë paragrafin në libër. Gjatë leximit i formulojnë pyetjet dhe i shënojnë të gjitha paqartësitë apo fjalët e panjohura që kanë hasur gjatë leximit. Pas përfundimit të formulimit të pyetjeve, nxënësit i lexojnë paqartësitë e tyre të cilat më pas shënohen nga mësimmshënësi në tabelë në kolonën e mesit D (Dua të di).

D - D - M		
Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor		
D (Di) Nuk duhet t'i presim pyjet, sepse ato na japin oksigjen.	D (Dua të di) Si mund ta parandalojmë ndotjen e mjedisit?	M (Mësova)



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve:

Di-Dua të di-Mësova më shumë

D - D - M		
Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor		
D (Di) Nuk duhet t'i presim pyjet, sepse ato na japin oksigjen.	D (Dua të di) Cilët janë shkaktarët që e rrezikojnë ndotjen e mjedisit?	M (Mësova) Shpyllëzimi, djegia e pyjeve, ndërtimet e fabrikave në vende pjellore, mbeturinat, pesticidet etj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përshkrimit të ndikimit të njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor, shpjegimit të burimeve të ripërtërishme dhe jo të ripërtërishme dhe identifikimit të pasojave të civilizimit për mjedisin jetësor.

Detyrë:

(Të ilustron një poster me titullin “Si ta ruajmë mjedisin jetësor?”)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis. Ndikimi pozitiv p.sh.: ruajtja e biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ p.sh.: zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 7; IV. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cilët janë faktorët e shkatërrimit të pyjeve?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon shkaktarët e dëmtimit të pyjeve.
- Shpjegon efektin e shiut acidik në shkatërrimin e bimëve, shtazëve dhe monumenteve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë të vogla ngjitëse, fotografi të printuara të pyjeve dhe të mjedisit jetësor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
 Diskutim për njohuritë paraprake

Shënohet titulli në tabelë, pastaj në secilën bankë shpërndahen fletë të vogla ngjitëse dhe fotografi të printuara të pyjeve dhe të mjedisit jetësor. Nxënësit individualisht duhet të shkruajnë për njohuritë paraprake, duke u bazuar në fotografitë që shohin.

Pyjet zakonisht dëmtohen nga ndotësit e fabrikave, sëmundjet e ndryshme etj.

Njeriu duhet ta mirëmbajë mjedisin jetësor, sepse ai na siguron frymëmarrjen.

Në fabrika duhen instaluar filtera për zvogëlimin e sasisë së ndotësve.

2.7.2. CILËT JANË FAKTORËT E SHKATËRRIMIT TË PYJEVE - EKOSISTEMEVE MË PRODUKTIVE DHE MË TË RËNDËSISHME NË NATYRË?



Dallimi në mes drurëve të sëmurë dhe të shëndoshë

A keni dëgjuar ndonjë gjë për vdekjen e pyjeve? Çfarë imagjinoni? Si e dini se një pyll është para vdekjes? A keni parë ndonjëherë drurë të sëmurë ose të vdekur në pyjet e vendit tuaj ose në pyjet eventeve të tjera?


Drurët e shëndoshë i kanë gjethet me ngjyrë të gjelbër në të errët, kështu dhe kurorat e tyre janë më të errëta. Ndërsa tek ata që kanë filluar të sëmurin, kurorat janë me ngjyrë më të çelur.

Drurët zakonisht dëmtohen nga ndotësit, shirat acidike, sëmundjet e ndryshme, ndryshimet e mjedisit të jashtëm etj. Nëse nuk intervenohet për largimin e shkaktarëve që dëmtojnë drurët, gjethet u bien dhe drurët mbeten të zhveshur, prandaj vdekja është e paevitueshme. Vdekja e drurëve shkakton zvogëlim të sipërfaqeve pyjore. Sipërfaqet pyjore zvogëlohen edhe për shkak të faktorëve natyrorë, si, p.sh., era, ngrirja dhe temperaturat e larta, nga mungesa e ujit, nga dëmtuesit siç janë insektet dhe kërpudhat drunore si stresa natyrore, dhe streset e krijuara nga njeriu si shpyllëzimet (për hapjen e vendbanimeve, rrugëve, tokave bujqësore etj.), prerja ilegale e pyjeve, ndotja e ajrit - shiu acidik (shiu i thartë) etj.



Kjo mënyrë e dëmtimit të pyjeve ende ndodh në malet tona

2.7.2.1. Shirat acidike (të tharta) shkatërrimtare të pyjeve




Prerja e pyjeve me pasoja të mëdha për mjedisin

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, njeriu ka ndikuar që të rritet ndotja, e cila shkaktohet nga rritja e qarkullimit rrugor, e termocentraleve, e objekteve industriale të ndryshme dhe amvisërisë.

Kështu, djegia e thëngjillit dhe e naftës prodhon ndotës si dyoksidi i sulfurit (SO₂) dhe oksidet e azotit (NO_x), që në ajër bashkohen me pikat e ujit

dhe krijojnë të ashtuquajturin "shi acidik", i cili kur bie në tokë, dëmtton gjetet dhe rrënjët e bimëve. Gjithashtu, nga shiu acidik helmohehen dhe organizmat e tjerë të tokës. Kështu bakteret dhe kërpudhat ngadalësojnë proceset jetësore ose vdesin, sepse vetë sipërfaqja e tokës bëhet acidike (thartohet). Kjo pengon dekompozimin e mbeturinave, krijimin e humusit dhe qarkullimin e materieve minerale.



Dëmtimi i pyjeve nga shirat acidike ishte i madh veçmas në vitet '80 të shekullit të kaluar. Këto shira dëmtojnë edhe ndërtesat dhe monumentet e ndryshme. Njëريت gjithashtu janë të rrezikuara kur pinë ujë ujë elumenjve dhe të liqeneve apo ushqehen me bimë ose shtazë, që janë prekur nga shiu acidik. Për të zvogëluar shkarkimet e ndotësve, dhe për të shpëtuar pyjet dhe mjedisin në përgjithësi, janë miratuar ligje të rrepta. Në objektet industriale dhe në termocentrale janë instaluar filtra për zvogëllimin e sasisë së ndotësve, u ndalua benzina me plumb, automjetet motorike u pajisën me konvertues katalitikë. Nafta u lirua nga squfuri si substancë e dëmshme mjedisore.

Të mbahet në mend!

- Pyjet ndikohen nga një numër i madh faktorësh stresues: erës si stres natyror, atyre të krijuar nga njeriu, si prerjet, ndotja e ajrit, nga shiu acidik etj.
- Për mbrojtjen e pyjeve duhet të funksionojë "Ligji për pyjet" dhe të ngrihet vetëdija për kulturën ekologjike të të gjithë brezat.

Pyetje

- Emërto faktorët stresues të pyjeve.
- Cka janë shirat e tharta dhe çfarë dëmtojnë ato?
- Përmes figurës lart, sqaro krijimin e shiut acidik (të thartë).



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Të nxënit me këmbime**

Nxënësit organizohen në grupe me nga 4 nxënës, ku secili prej tyre është përgjegjës për të lexuar një pjesë. Përgatitet "fleta e ekspertit", e cila mund të ketë pyetje, detyra ose grafik që të plotësohet. Rigrupohen nxënësit ta lexojnë pjesën që u është caktuar si detyrë. U kërkohet anëtarëve të grupit ta analizojnë informacionin e mbledhur nga çdo anëtar, të cilin do ta bashkojnë në një përmbledhje tërësore të çështjeve kryesore. Ata i diskutojnë përfundimet e tyre dhe më pas të gjithë nxënësit që kanë të njëjtin numër, ekspertët, raportojnë në grupet fillestare për t'i shpjeguar pjesët më të rëndësishme të pjesës së tyre të tekstit. Pjesa tjetër e grupit është e gatshme ta mësojë informacionin e ri. Kështu duken fletët e ekspertëve:

Eksperti A
Pyetjet:
- Si duhet ta ruajmë mjedisin jetësor?

Eksperti B
Pyetjet:
- Pse njeriu është faktori kryesor në mjedis?



**Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit:
Rishikimi në dyshe**

Nxënësit organizohen në dyshe: detyra e tyre është të diskutojnë, të shkëmbejnë mendime dhe t'u japin përgjigje paqartësive që kanë hasur në pjesën e dytë të orës mësimore. Më pas, nga një përfaqësues për çdo grup ua tregon nxënësve të tjerë rezultatet e diskutimit të grupit të tyre duke shkëmbyer ide, mendime dhe pyetje me dyshtet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të shkaktarëve të dëmtimit të pyjeve dhe shpjegimit të efektit të shiut acidik në shkatërrimin e bimëve, shtazëve dhe monumenteve.

Detyrë:

(Të realizohet detyra e dhënë <https://www.liveworksheets.com/w/en/science/1372929>)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis. Ndikimi pozitiv p.sh.: ruajtja e biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ p.sh.: zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsëritje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon shkaktarët e ndotjes së mjedisit.
- Krahason mjedise jetësore të mëhershme dhe të tanishme.
- Argumenton arsyet e ndikimit të njeriut në mjedis jetësor.


Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: material shtesë nga interneti për ndikimin e njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografi, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënëtit
 Diskutim për njohuritë paraprake



2.7. NDIKIMI I NJERIUT NË NATYRË DHE MJEDIS JETËSOR

2.7.1. Si e kemi ndryshuar mjedisin jetësor?

Njerëzit kanë qenë në Tokë për 200 mijë vjet. Në fillim, ndikimi i njeriut në mjedisin jetësor ka qenë pasiv dhe gati i padukshëm, pothuajse i njëjtë me llojet e tjera. Para rreth 10000 vjetësh, kur njeriu zbuloi përdorimin e mjeteve të punës, fillon periudha e ndërhyrjes aktive në mjedisin jetësor. Rritja e numrit të banorëve ka bërë që të rritet nevojja për sasi më të madhe të ushqimit, të hapësirës etj. Kështu është rritur edhe domosdoshmëria e shndërrimit të pyjeve dhe livadheve, moçaleve natyrore në sipërfaqe të punuara, për ndërtimin e vendbanimeve më të mëdha (qyteteve) dhe për infrastrukturë banimi (rrugë, hekurudha etj.). Këto ndryshime dallohen shumë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, si rezultat i zhvillimit të hovshëm demografik, i industrisë, i bujqësisë intensive, i automobilizimit, i ndërtimit etj. Edhe në vendin tonë janë shkaktuar ndryshime të mëdha në ekosistemet natyrore, veçmas në ato të pyjeve, ku kemi humbje të mëdha të biodiversitetit.



Shpyllëzimi

2.7. NDIKIMI I NJERIUT NË NATYRË DHE MJEDIS JETËSOR

2.7.1. Si e kemi ndryshuar mjedisin jetësor?

Njerëzit kanë qenë në Tokë për 200 mijë vjet. Në fillim, ndikimi i njeriut në mjedisin jetësor ka qenë pasiv dhe gati i padukshëm, pothuajse i njëjtë me llojet e tjera. Para rreth 10000 vjetësh, kur njeriu zbulon përdorimin e mjeteve të punës, fillon periudha e ndërhyrjes aktive në mjedisin jetësor. Rritja e numrit të banorëve ka bërë që të rritet nevoja për sasi më të madhe të ushqimit, të hapësirës etj. Kështu është rritur edhe domosdoshmëria e shndërrimit të pyjeve dhe livadheve, moçaleve natyrore në sipërfaqe të punuara, për ndërtimin e vendbanimeve më të mëdha (qyteteve) dhe për infrastrukturë banimi (rrugë, hekurudha etj.). Këto ndryshime dallohen shumë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, si rezultat i zhvillimit të hovshëm demografik, i industrisë, i bujqësisë intensive, i automobilizimit, i ndërtimit etj. Edhe në vendin tonë janë shkakuar ndryshime të mëdha në ekosistemet natyrore, veçmas në ato të pyjeve, ku kemi humbje të mëdha të biodiversitetit.



Shpyllëzimi

95



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Ditarët e të nxënësve (Ditari dypjesësh)

Nxënësit organizohen të punojnë në dyshe. Në fletoret e tyre duhet ta paraqesin tabelën si më poshtë.


Citim	Koment
- Njerëzit kanë qenë në Tokë për 200 mijë vjet. Në fillim, ndikimi i njeriut në mjedisin jetësor ka qenë pasiv dhe gati i padukshëm, pothuajse i njëjtë me llojet e tjera.	- Rritja e numrit të banorëve ka bërë që të rritet edhe domosdoshmëria e shndërrimit të pyjeve dhe livadheve, moçaleve natyrore në sipërfaqe të punuara.

Prezantohet materiali për lexim dhe u thuhet nxënësve që në fillim t'i nënvizojnë pjesët që u bëjnë përshtypje gjatë leximit apo në qoftë se kanë pyetje. Mësimdhënësi mund të bëjë pyetje gjatë leximit të komenteve nga nxënësit në mënyrë që ata të nxiten të flasin dhe të aftësohen për t'u përgjigjur pyetjeve.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve:

Rrjeti i diskutimit



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të shkaktarëve të ndotjes së mjedisit, krahasimit të mjedisëve jetësorë të mëhershme dhe të tanishme dhe argumentimit të arsyeve të ndikimit të njeriut në mjedis jetësor.

Detyrë:

(Të realizohet në shtëpi njëri nga dy eksperimentet e dhëna në fletore pune, faqe 67)

Reflektim për veprimet e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënët të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejt-përdrejtë të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 7, III. 5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Identifikon ndotësit kryesorë të ajrit dhe ujit;
- Tregon pasojat nga ndotja e ajrit dhe ujit;
- Argumenton ndikimin e ndotjes së ajrit dhe të ujit në shëndetin tonë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi, videoprojektor, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit, Gjeografia, Kimia, Edukata qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënët

Imaginatë e drejtuar

Para nxënësve shfaqen fotografi dhe video të shkurtra me pamje të ndryshme të ndotjes së mjedisit. Nxënësit i vrojtojnë fotografitë me kujdes dhe pas kësaj do ta komentojnë secilën prej tyre.



2.7.3. Ndotja e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij

Ndotja ndodh atëherë kur në mjedis ka mbeturina, papastërti ose gjëra të tjera të dëmshme për organizmat e gjallë. Ka ndotje: të ajrit, të ujit dhe të tokës.

2.7.3.1. Ndotja e ajrit

Ajri i ndotur përmban lëndë të gazta dhe thërrmija të dëmshme për qeniet e gjalla. Nga lëndët e gazta që e ndotin ajrin, janë: monoksidi i karbonit (CO), oksidet e azotit (NO_x), dyoksidi i sulfurit (SO₂), sulfuri i hidrogjenuar (H₂S) etj. Si ndotësit më të njohur në vendin tonë janë termocentralet e Kastriotit (në të cilët përdoret thëngjilli linjit si lëndë djegëse, të cilat emitojnë (lirojnë) gazra të dëmshme dhe pluhur), automjetet etj. Nga këta ndotës dhe lagështia e ajrit, gjatë dimrit, në kryeqytetin tonë dhe rrethinë, shpesh krijohet sasi e madhe e smogut.

Ndikimi i ajrit të ndotur në shëndetin tonë përcillet nga ftohjet, kollitjet, zënie hundësh etj. Nëse ekspozohemi gjatë në ajër të ndotur, mund të na shkaktohen sëmundje kronike sidomos në sistemin e frymëmarrjes, por dhe sëmundje kanceroze.

Mbrojtja e ajrit nga ndotja mund të bëhet duke zbatuar ligjin për mbrojtjen e ajrit, duke shfrytëzuar karburantët me cilësi më të mirë, duke përdorur në objektet industriale filtra që ndalojnë pjesën më të madhe të thërrmijave dhe gazrave të dëmshme, duke larguar ndotësit nga vendbanimet, duke shtuar sipërfaqet gjelbëruese etj.



Termocentrali në Kastriot

2.7.3.2 Ndotja e ujit

Në shumë vende të botës, ende bëhet hedhja e ujërave (të zeza) nga industritë dhe nga amvisëritë në lumenj, liqene dhe dete. Në Kosovë ka ndotje të vazhdueshme të lumenjve dhe liqeneve nga ujërat e tilla, por dhe nga hedhja e mbeturinave të forta, veçmas atyre plastike. Për shkak të derdhjes së ujërave të ndotura në lumë, liqen apo det, shumica e bimëve dhe shtazëve, që jetojnë në këto ujëra, vdesin. Ujërat e tilla janë shkak të sëmundjeve të ndryshme të njerëzimit, p.sh., sëmundjeve të lëkurës, të sistemit të organeve të tretjes etj.

Për të ndaluar hedhjen e ujërave (të zeza) nga industritë dhe amvisëritë në lumenj, liqene dhe dete, duhen ndërtuar fabrikat për pastrimin e atyre ujërave dhe të funksionojë ligji për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe ligji për mbeturina.

2.7.3.3. Ndotja e tokës

Rritja në vazhdimësi e nevojave të njeriut për hapësirë, banim, ushqim etj. ka bërë që toka të ndotet nga ndotësit ndryshëm, p.sh., me pesticide që përdoren për zhdukjen e barishteve të këqija dhe dëmtuesve të tjerë. Përdorimi i tepruar i plehrave kimike (mbiplehërimi) gjithashtu shkakton ndotjen e tokave të punueshme. Këta ndotës përcillen nga dheu përmes zinxhirëve të ushqimit, më pas bimët dhe shtazët deri te tryezat tona. Nga toka e ndotur ndotet edhe ujërat nëntokësore dhe përmes tyre ndotësit mund të barten në pusët nga të cilat furnizohemi me ujë për pije dhe kështu mund të helmohemi. Prandaj helmet që i kemi hedhur në sipërfaqe të tokës, po i konsumojmë vetë.

Këta ndotës janë shkaktarë të helmimeve dhe sëmundjeve të ndryshme që shpesh përfundojnë edhe me vdekje. Në vendin tonë përveç nga ndotja, toka po shkatërrohet edhe ndërtimet e paplanifikuara si duhet të vendbanimeve, fabrikave, pompave të karburanteve, nga mihjet sipërfaqësore të thëngjillit etj. Masat elementare që duhet të merren për mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe shkatërrimi janë përdorimi i kontrolluar i pesticideve dhe plehrave kimike (artificiale) dhe zbatimi i ligjit për tokën, i cili nuk lejon të tjetërsohet toka pjellore prej 1 deri në shkallën e 4 të bonitetit.

2.7.3.4. Ndotjet e tjera

Përpos ndotjeve të sipërpërmendura, ka edhe ndotje të tjera: si zhurma, ndotja termale etj.

Zhurma, e cila shkaktohet kur në mjedisë kemi tinguj të lartë e të përzier, mund të na bëjë të ndihemi jo mirë dhe mund të na i dëmtojë veshët (zhurma e trafikut, zhurma nga objektet industriale, muzika e lartë etj.). Zhurma mund të shkaktojë probleme të ndryshme si: stres, zvogëlim të dëgjimit etj.

Ndotja termale vjen nga lirimimi i madh i nxehtësisë në mjedisë për një periudhë të gjatë, e cila lirohet nga fabrika të ndryshme, shpyllëzimi, ndotja e ajrit. Kjo ndotje shkakton ndryshime klimatike dhe zhdukjen e llojeve të ndryshme të bimëve dhe të kafshëve.



Derdhja e ujërave të zeza në lumë



Hedhja e mbeturinave në lumë



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore duke e ndarë në paragrafë dhe duke bërë ndërlidhje me diskutimet paraprake nga fotografitë.

Pas diskutimeve rreth fotografive dhe materialit në libër mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që ta plotësojnë tabelën sipas parimit Shkak-Pasojë

Ndotja e ujit	Ndotja e ajrit
Shkaktarët:	Shkaktarët:
Pasojat:	Pasojat:



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Diskutim i përbashkët

Pasi nxënësit kuptojnë, krahasojnë dhe i analizojnë ndotësit kryesorë të ujit dhe ajrit, diskutimi do të vazhdojë me pyetjen: Identifikoni masat që duhen të merren për mbrojtjen e

ajrit dhe të ujit dhe renditni sëmundjet që shkaktohen nga ndotja e ujit dhe ajrit! Ndërkohë, nxënësit përgatitin një plan për një aktivitet që ka të bëjë me vetëdijësimin e popullatës lidhur me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës.

Vlerësimi i nxënësve:

Në bazë të njohurive të tyre për t'i identifikuar ndotësit e ujit dhe ajrit, pasojat në mjedis dhe shëndet.

Detyrë:

(Vazhdim i aktivitetit nga pjesa e përforcimit dhe prezantim në orën tjetër të mësimt)

Reflektim për vryedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënët të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejt-përdrejtë të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 7, III. 5

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e tokës

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Identifikon ndotësit kryesorë të tokës;
- Tregon pasojat nga ndotja e tokës;
- Argumenton ndikimin e ndotjes së tokës në shëndetin e njeriut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi, videoprojektor, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit, Gjeografia, Kimia, Edukata qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Imagjinatë e drejtuar

Para nxënësve shfaqen fotografi dhe video të shkurtra me pamje të ndryshme të ndotjes së tokës. Nxënësi i vrojtojnë fotografitë me kujdes dhe pas kësaj do t'i komentojnë ato. Pjesë e diskutimit do të jenë edhe krahasimet nga njohuritë për ndotjen e ujit dhe të ajrit.



Për të ndaluar hedhjen e ujërave (të zeza) nga industritë dhe amvisëritë në lumenj, liqene dhe dete, duhen ndërtuar fabrikat për pastrimin e atyre ujërave dhe të funksionojë ligji për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe ligji për mbeturina.



Derdhja e ujërave të zeza në lumë

2.7.3.3. Ndotja e tokës

Rritja në vazhdimësi e nevojave të njeriut për hapësirë, banim, ushqim etj., ka bërë që toka të ndotet nga ndotës të ndryshëm, p.sh., me pesticide që përdoren për zhdukjen e barishteve të këqija dhe dëmtuesve të tjerë. Përdorimi i tepruar i plehrave kimike (mbiplehërimi) gjithashtu shkakton ndotjen e tokave të punueshme. Këta ndotës përcillen nga dheu përmes zinxhirëve të ushqimit, me pas bimët dhe shtazët deri te tryezat tona. Nga toka e ndotur ndotet edhe ujërat nëntokësore dhe përmes tyre ndotësit mund të barten në pusët nga të cilat furnizohemi me ujë për pije dhe kështu mund të helmohemi. Prandaj helmët që i kemi hedhur në sipërfaqe të tokës, po i konsumojmë vetë.



Hedhja e mbeturinave në lumë

Këta ndotës janë shkaktarë të helmimeve dhe sëmundjeve të ndryshme që shpesh përfundojnë edhe me vdekje. Në vendin tonë përveç nga ndotja, toka po shkatërrohet edhe ndërtimet e paplanifikuara si duhet të vendbanimeve, fabrikave, pompave të karburanteve, nga mihjet sipërfaqësore të thëngjillit etj. Masat elementare që duhet të merren për mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe shkatërrimi janë përdorimi i kontrolluar i pesticideve dhe plehrave kimike (artificiale) dhe zbatimi i ligjit për tokën, i cili nuk lejon të tjetërsohet toka pjellore prej 1 deri në shkallën e 4 të bonitetit.

2.7.3.4. Ndotjet e tjera

Përpos ndotjeve të sipërpërmendura, ka edhe ndotje të tjera: sizhurma, ndotja termale etj. Zhurma, e cila shkaktohet kur në mjedis kemi tinguj të lartë e të përzier, mund të na bëjë të ndihemi jo mirë dhe mund të na i dëmtojë veshët (zhurma e trafikut, zhurma nga objektet industriale, muzika e lartë etj.). Zhurma mund të shkaktojë probleme të ndryshme si: stres, zvogëlim të dëgjimit etj. Ndotja termale vjen nga lirim i madh i nxehtësisë në mjedisë për një periudhë të gjatë, e cila lirohet nga fabrika të ndryshme, shpyllëzimi, ndotja e ajrit. Kjo ndotje shkakton ndryshime klimatike dhe zhdukjen e llojeve të ndryshme të bimëve dhe të kafshëve.

Kuriozitete

Në Londër, në dhjetor të vitit 1952, smogu ka qenë shkaktar i vdekjes së 4000 njerëzve. Gjatë vitit 2017, në Prishtinë, 58 ditë janë tejkaluar vlerat ditore të lejueshme të ndotjes së ajrit nga grimcat e caktuara, ku dhe në shumë ditë janë regjistruar shifrat me ndotjen më të lartë në botë. Burim kryesor i ndotjes janë termocentralet në Kastriot dhe automjetet e vjetëruara, moshë mesatare e të cilave është rreth 20 vjet.

Të mbahet në mend!

- Sot kemi ndotje të ajrit, ujit dhe tokës, por dallohen dhe ndotja nga zhurma dhe ajo termike.
- Në vendin tonë, ndotësit më të mëdhenj të ajrit janë termocentralet dhe automjetet.
- Ndotja e lumenjve dhe e liqeneve po ndodh nga derdhja e ujërave të zeza, por dhe nga hedhja e mbeturinave të forta, veçmas atyre plastike.
- Ndotja e tokës po ndodh nga pesticidet dhe përdorimi i tepruar i plehrave kimike.
- Shkatërrimi i tokës po ndodh nga ndërtime të paplanifikuara si duhet.
- Për mbrojtje nga ndotja dhe shkatërrimi i mëtejme i mjedisit duhen ndërmarrë masa adekuata.

Pyetje

1. Cilat janë lëndët e gazta që ndotin ajrin?
2. Përmend pasojat në shëndetin tonë nga ndotja e ajrit.
3. Informohu cilat sëmundje të lëkurës dhe të sistemit të organeve të tretjes mund të shkaktohen përmes ujit të papastër të njeriut (mjeku i shkolllës, internet).
4. Analizo pse viteve të fundit, uji nga pusët në zonat e rrafshëta është bërë pothuajse i papërdorshëm për pije.
5. Hulumtoni ndotësit kryesorë të tokës në vendbanimin tuaj.
6. Numëro masat që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës.

102



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DRTA

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore duke i vënë theks ndotjes së tokës, ndotjes nga zhurma, ndotjes termale, shkaktarëve dhe pasojave.

Nxënësit udhëzohen që të shënojnë disa nga fjalët ose fjalitë që po i dëgjojnë për herën e parë dhe të diskutojnë për to bashkë me mësimdhënësin.

Prezantimi i punimeve

Nxënësit do t'i prezantojnë punimet nga ora e kaluar mësimore dhe gjatë prezantimit do t'i paraqesin shkaktarët kryesorë të ndotjes së ujit dhe të ajrit. Po ashtu, do të shtojnë prej njohurive të fituara në orën mësimore edhe shkaktarët e ndotjes së tokës, ndotjes nga zhurma dhe ajo termale.



Përforsimi: Konsolidimi i të nxëniti: Diskutim i përbashkët

Pasi nxënësit i prezantojnë punimet e tyre do të vazhdojë diskutimi i mëtejme për mundësitë e përfshirjes së nxënësve në nisma të ndryshme mjedisore që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes si dhe parandalimin e ndotjes së mëtejme të mjedisit.

Vlerësimi i nxënësve:

Në bazë të njohurive të tyre për t'i identifikuar ndotësit e tokës, pasojat në mjedis dhe shëndet.

Detyrë:

(Si mund të ndikojnë nxënësit në reduktimin e ndotjes së mjedisit?)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 5, II. 4, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndryshimi i klimës - ngrohja globale (efekti serrë)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon shkaktarët e efektit serrë.
- Vlerëson pasojat e ngrohjes globale.
- Njeh mënyrat dhe mundësitë e reduktimit të dyoksidit të karbonit, si shkaktar themelor i ngrohjes globale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë pune - shtroja e tavolinës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë titullin e mësimt dhe u kërkon nxënësve fillimisht të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj, fton disa nga ta të diskutojnë dhe t'i shpalosin mendimet e tyre për Ngrrohjen Globale, duke mos i pohuar apo mohuar mendimet e tyre. Mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë në mënyrë që vetë nxënësit t'i vetëvlerësojnë mendimet e tyre pasi ta kenë mësuar njësinë mësimore.

2.7.4. NDRYSHIMI I KLIMËS - NGROHJA GLOBALE (EFEKTI SERRË)

Pothuajse çdonjëri ka rast të shohë serra në kopshte, ku kultivohen perime, por edhe të dëgjojë vazhdimisht në njetë të informimit për ngrohjen globale apo ndryshimet klimatike globale. A e dini se proceset që zhvillohen në këto serra dhe në atmosferën e planetit Tokë janë njëaft të ngjashme?

Nga djegia e lëndëve fosile (thëngjilli, nafta, gazi), si dhe nga aktivitetet e tjera industriale lirohet numër i madh i ndotësve në ajër dhe të gjitha këto ndikojnë në ndryshimet klimatike globale.



Dyoksidi i karbonit dhe oksigjeni qarkullojnë vazhdimisht ndërmjet gjallesave dhe atmosferës, duke mbajtur nivelet e duhura në ajër. Por, viteve të fundit, shkaterimi i pyjeve, rritja e industrializimit, automobilizimit etj. po rrezikojnë ndryshimin e niveleve të tyre në ajër.

Automobilat - ndotës të mëdhenj të ajrit



2.7.4. NDRYSHIMI I KLIMËS - NGROHJA GLOBALE (EFEKTI SERRË)

Pothuajse çdonjëri ka rast të shohë serra në kopshte, ku kultivohen perime, por edhe të dëgjojë vazhdimisht në njetë të informimit për ngrohjen globale apo ndryshimet klimatike globale. A e dini se proceset që zhvillohen në këto serra dhe në atmosferën e planetit Tokë janë mjaft të ngjashme?

Nga djegia e lëndëve fosile (thëngjilli, nafta, gaz), si dhe nga aktivitetet e tjera industriale lirohet numër i madh i ndotësve në ajër dhe të gjitha këto ndikojnë në ndryshimet klimatike globale.




Dyoksidi i karbonit dhe oksigjeni qarkullojnë vazhdimisht ndërmjet gjallesave dhe atmosferës, duke mbajtur nivelet e duhura në ajër. Por, viteve të fundit, shkatërrimi i pyjeve, rritja e industrializimit, automobilizimit etj. po rrezikojnë ndryshimin e niveleve të tyre në ajër.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Shtroja e tavolinës**

Përgatiteni një letër të madhe me pjesë individuale dhe pjesë të përbashkëta në mes (sikur në paraqitjen vizuale), për të arritur rezultate. Pasi e keni shpalosur temën në tabelë dhe nxënësit ta kenë lexuar njësinë mësimore nga libri ftoni ata ta punojnë shtrojen e tavolinës (fletët nëse ka mundësi i siguron mësimdhënësi, nëse jo ato mund të punohen edhe nga vetë nxënësit). Hapi 1: Nxënësit i shkruajnë idetë në pjesë, individualisht pa folur me askënd (caktojeni kohën sa minuta). Hapi 2: Nxënësit ecin përreth në drejtim të akrepave të orës (ose në drejtim të kundërt me akrepat e orës) dhe lexojnë çfarë kanë shkruar në ato pjesë. Hapi 3: Nxënësit i diskutojnë idetë e tyre dhe i shkruajnë rezultatet më relevante në mes (tri deri në pesë aspekte).



**Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit:
Diskutim i përbashkët**

Kërkohet nga nxënësit që t'i mbyllin librat dhe ta fillojnë diskutimin për njësinë mësimore, duke i shfrytëzuar vetëm fletët e punës. Të gjitha grupet kanë mundësi t'i prezantojnë mendimet e tyre, prezantimin e bën përfaqësuesi i grupit dhe të tjerët e ndihmojnë atë nëse ka nevojë. Së fundi, nxënësit mund ta bëjnë vlerësimin e mendimeve (ideve) të tyre lidhur me ngrohjen globale, mendime këto të shprehura në fillim të orës mësimore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi duhet t'i identifikojë faktorët e efektit serrë.
Nxënësi duhet t'i vlerësojë pasojat e efektit serrë.
Nxënësi duhet të jetë në gjendje t'i njohë mundësitë e reduktimit të CO₂-it si shkaktar i ndotjes.

Detyrë:

(Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë në internet apo në ndonjë material tjetër (si enciklopedi etj.) rreth shkaktarëve të ndotjes)

● *Reflektim përvojëdhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Humlumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 6, II. 7, III. 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Niveli i dyoksidit të karbonit në ajër po rritet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon shkaktarët kryesorë të rritjes së dyoksidit të karbonit;
- Tregon pasojat nga ngritja e CO₂-it në ajër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: fotografi, videoprojektor, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit, Gjeografia, Kimia, Edukata qytetare.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Di

Në fazën e parë të mësimin nxënësit e plotësojnë kolonën “DI” me njohuritë që kanë rreth dyoksidit të karbonit si një prej gazrave kryesorë në efektin serrë. Mësimdhënësi/ja i paraqet edhe në tabelë kolonat, pastaj fton disa nxënës të lexojnë disa nga informacionet që ata kanë për temën dhe kështu i shkruan në tabelë.



Bimët marrin dyoksidin e karbonit. Djegia shton dyoksidin e karbonit në ajër



Serra



Shkrirja e akullnajave me pasojat për zhdukjen e llojeve të ndryshme shtazore dhe ngritjen e nivelit të deteve

2.7.4.1. Niveli i dyoksidit të karbonit në ajër po rritet

Me djegien e pyjeve, përpos që lirohet një numër i madh i ndotësve në ajër, zvogëlohet edhe sipërfaqja (e pyllit), e cila i absorbon ndotësit që lirohen në atmosferë, sepse sa më pak bimë që absorbojnë dyoksidin e karbonit në procesin e fotosintezës, aq më i papastër është ajri.

Prerja e pyjeve, por edhe aktivitetet e tjera antropogjene (përdorimi i thëngjillit, i derivateve të naftës etj.), po ndikojnë që përqendrimi i dyoksidit të karbonit, por dhe i gazrave të tjera, të rritet vazhdimisht në ajër. Kjo e bën atmosferën më të ngrohtë dhe ndikon në **ngrohjen globale**, sepse shtesa e gazrave gjatë ditës lejon depërtimin e rrezeve të diellit në atmosferë, mirëpo nuk lejon që nxehtësia e krijuar të lirohet nga atmosfera dhe kështu ka rritje të temperaturës. Dukuria është e ngjashme me ngritjen e temperaturës në serrë, prandaj edhe quhet efekti serrë. Matjet tregojnë se Toka vazhdimisht do të ngrohet. Pasojat e ngrohjes globale janë të ndryshme, si: shkrirja e akullnajave, rritja e nivelit të ujit të detit për shkak të shkrirjes së akullnajave, në disa rajone të globit do të paraqiten erëra të forta (stuhi), rritja e sasisë së reshjeve (vërshime), ndërsa në rajone të tjera do të krijohen shkretëtira për shkak të thatësisë. Kjo do të shkaktojë për njerëzimin kriza të mëdha për ujë të pijshëm dhe ushqim.

Nëse përdorim burime të energjisë së ripërtëritshme siç janë: dielli, era, uji rrjedhës, në vend të lëndëve djegëse fosile, atëherë ne do të kishim më pak ndikim në mjedis. Gjithashtu, kjo bëhet nëse zbatojmë ligjet dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Një rritje sado e vogël në temperaturën globale, mund të ketë një efekt të madh!



Të mbahet në mend!

- Shfrytëzimi i thëngjillit, i naftës dhe i gazit natyror ndikon në ngrohjen globale.
- Dyoksidi i karbonit gjithashtu rritet kur pyjet (biomasa) priten dhe digjen.
- Zhdukja e pyjeve nënkupton se ka më pak bimë që absorbojnë dyoksidin e karbonit në procesin e fotosintezës.
- Rritja e dyoksidit të karbonit në atmosferë ndikon në ngrohjen globale.
- Një rritje sado e vogël në temperaturën globale mund të ketë një efekt të madh. Për shembull:
 - mund të ndryshojnë fuqia e erës dhe sasia e reshjeve,
 - biloqet e akullit mund të shkrihen, duke rritur nivelin e detit etj.

Pyetje

1. Cili është roli i njeriut në rritjen e temperaturës globale në tokë dhe cilat janë pasojat?
2. Sqaro efektin e përdorimit të thëngjillit, të naftës dhe të gazit natyror në ndryshimet klimatike globale.
3. Trego efektin e djegies dhe të shkatërrimit të pyjeve në procesin e ngrohjes globale.
4. Përshkruaj procesin e ngrohjes së atmosferës, i cili njihet si efekti serra.
5. Përmend pasojat e ngrohjes globale!



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Dua të di**

Nxënësit udhëzohen që të shkruajnë disa nga fjalët ose fjalitë që po i dëgjojnë për herën e parë dhe të diskutojnë për to bashkë me mësuesin.

Mësova

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit që gjatë leximit të njohjes mësimore t'u japin theks pasojave në ekosistem nga ngritja e përqendrimit të CO₂-it në ajër, rolin e pyjeve në stabilizimin e përqendrimit të CO₂-it, aktivitetet e organizatave ndërkombëtare për të ndikuar te shtetet në minimizimin e CO₂-it, format e energjisë së ripërtëritshme ndikuese në uljen e emetimit të karbonit.



**Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit:
Diskutim i përbashkët**

Nxënësit individualisht e plotësojnë tabelën e mëposhtme pas leximit dhe shpjegimeve të marra nga mësuesi.

Di	Dua të di	Mësova

Vlerësimi i nxënësve:

Në bazë të njohurive të tyre për t'i identifikuar indikatorët e rritjes së CO₂-it në ajër dhe pasojat e rritjes së tij.

Detyrë:

(Si mund të ndikojnë nxënësit në reduktimin e ndotjes së mjedisit)?

Reflektim për rojedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Humlumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 5, II. 4, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndryshimi i klimës - ngrohja globale (efekti serrë) - Përsëritje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcakton faktorët e ndotjes;
- Vlerëson rreziqet e ndotjes dhe efektin global të saj.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë pune - shtroja e tavolinës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

- Diskutim i shkurtër mbi çfarë dinë nxënësit për efektin serrë.
- Pyetje për nxënësit: "Çfarë është efekti serrë dhe pse është i rëndësishëm?"

2.21. NDOTJA E MJEDISIT DHE MASAT PËR MBROJTJEN E TIJ

1. Plotësoji fjalitë, duke u bazuar në librin bazë.

- Ndotja ndodh atëherë kur në mjedis kemi _____ ose gjëra të tjera të dëmshme për organizmat e gjallë.
- Ajri i ndotur përmban _____ të dëmshme për qeniet e gjalla.
- Si ndotës më të njohur në vendin tonë janë _____.
- Ndikimi i ajrit të ndotur në shëndetin tonë përcillet nga _____.
- Mbrojtja e ajrit nga ndotja mund të bëhet duke zbatuar _____, duke shfrytëzuar _____ me cilësi më të mirë, duke përdorur _____ në objektet industriale, duke larguar _____ nga vendbanimet, rritja e _____ etj.
- Për shkak të derdhjes së ujërave të ndotura në lumë, liqen apo det, shtohet sasia _____, veçmas _____, të cilat krijojnë mungesë të oksigjenit.
- Ujërat e ndotura janë shkaktarë të sëmundjeve të ndryshme te njerëzit, p.sh., sëmundjes së _____ etj.
- Rritja në vazhdimësi e nevojave të njeriut për _____ etj., ka bërë që toka të ndotet nga ndotësit të ndryshëm.
- Nga toka e ndotur, ndoten edhe _____ dhe përmes tyre ndotësit mund të barten në _____ nga të cilët furnizohemi _____ dhe kështu mund të _____.
- Zhurma mund të shkaktojë probleme të ndryshme si: _____ etj.

2. A janë këto pohime të sakta?

- a. Nga lëndët e gazta që e ndotin ajrin janë: monoksidi i karbonit (CO), oksidet e azotit (NO₂), dyoksidi i sulfurit (SO₂), sulfuri i hidrogjenuar (H₂S). **PO JO**
- b. Nga ndotësit e ndryshëm dhe lagështia e ajrit, gjatë dimrit, në kryeqytetin tonë dhe në rrethinë, shpesh krijohet sasi e madhe e smogut. **PO JO**
- c. Nëse qëndrojmë gjatë në ajër të ndotur, mund të na shkaktohen sëmundje kronike, sidomos në sistemin e frymëmarrjes, por edhe sëmundje kanceroze. **PO JO**
- d. Në Kosovë nuk ka ndotje të lumenjve dhe liqeneve nga ujërat e zeza nga hedhja e mbeturinave të forta dhe atyre plastike. **PO JO**
- e. Për shkak të mungesës së oksigjenit në ujëra të ndotura, shumica e bimëve dhe shtazëve vdesin - baraspesha ekologjike humbet. **PO JO**
- f. Për të ndaluar hedhjen e ujërave (të zeza) nga industritë dhe amvisëritë në lumenj, liqene dhe dete, mjafton edukatë ekologjike. **PO JO**
- g. Përdorimi i tepruar i plehrave kimike (mbiplehërimi) shkakton ndotjen e tokave të punueshme. **PO JO**
- h. Masat elementare për mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe shkatërrimi janë përdorimi i kontrolluar i pesticideve dhe i plehrave kimike, dhe zbatimi i ligjit për tokën. **PO JO**
- i. Ndotja termale shkakton ndryshime klimatike dhe zhdukjen e llojeve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. **PO JO**

71



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Shpjegimi i koncepteve bazë

- Përkufizimin e efektit serrë.
- Si funksionon efekti serrë natyror.
- Gazrat serrë kryesore: CO₂, CH₄, N₂O, H₂O (avulli i ujit), O₃.

Diskutim dhe Pyetje (10 minuta)

- Nxënësit diskutojnë në grupe të vogla dhe i ndajnë mendimet e tyre mbi burimet e gazrave serrë.
- Pyetje për nxënësit: "Cilat janë burimet kryesore të gazrave serrë në jetën e përditshme?"



Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit:

Video edukative

<https://www.youtube.com/watch?v=ZGn078-k1s8>

Nxënësit ndahen në grupe dhe krijojnë postera që tregojnë ndikimet negative të efektit serrë dhe ndryshimet klimatike.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi duhet t'i vlerësojë pasojat e efektit serrë.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje t'i njohë mundësitë e reduktimit të CO₂-it si shkaktar i ndotjes.

Detyrë:

(Nxënësve do t'u kërkohet të përgatitin një raport të shkurtër mbi një rast konkret të ndikimit të efektit serrë dhe masat që janë marrë për ta adresuar atë)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 56

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv p.sh.: ruajtja-konservimi i biodiversitetit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 5, II. 4, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Çelësat e thjeshtë për përcaktim (klasifikim) të organizmave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkrauan çelësin determinues;
- Vlerëson rëndësinë e çelësit determinues;
- Njeh llojet e çelësve determinues.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Pyetje për nxënësit: "Çfarë është një çelës për përcaktimin e organizmave dhe pse është i rëndësishëm?"

2.8.1. Çelësat e thjeshtë për përcaktim (klasifikim) të organizmave

Çelësat janë një mjet për identifikimin e organizmave në situatat lokale (kur zhvillohen ekskursionet), p.sh. në një kënetë apo pyll. Kur përdorim çelësin e thjeshtë, zgjedhim një nga dy përshkrimet e kundërta, duke zgjedhur atë që i përshkruan identifikimit të organizmit. Përshkrimi i përzgjedhur nxjerr një numër, së bashku me të cilin ka përshkrimet të mëtejshme nga të cilat mund të zgjidhni. Zgjedhja përfundimtare tregon emrin e organizmit.

Shembull: zgjidh një nga organizmat në foto dhe përdor çelësin poshtë për ta identifikuar atë.



Mekrahë 1

1	Dykëmbë	B	pëllumbi
	Gjash të këmbë	C	bleta

Pakrahë 2

2	Mekëmbë	A	pleshti
	Pakëmbë	D,E (3)	ngjala dhe krimbi i tokës

3	Mesy	D	ngjala
	Fasy	E	krimbi i tokës

Në shembullin e mësipërm, përdorimi i karakteristikave të detajuara do të vononte identifikimin. Ky çelës është i thjeshtë, i saktë dhe ende ka përdorim.

2.8.1. Çelësat e thjeshtë për përcaktim (klasifikim) të organizmave

Çelësat janë një mjet për identifikimin e organizmave në situatat lokale (kur zhvillohen ekskurSIONET), p.sh. në një kënetë apo pyll. Kur përdorim çelësin e thjeshtë, zgjedhim një nga dy përshkrimet e kundërta, duke zgjedhur atë që i përshtrahet identifikimit të organizmit. Përshkrimi i përzgjedhur nxjerr një numër, së bashku me të cilin ka përshkrime të mëtejshme nga të cilat mund të zgjidhni. Zgjedhja përfundimtare tregon emrin e organizmit.

Shembulli: zgjidh një nga organizmat në foto dhe përdor çelësin poshtë për ta identifikuar atë.



Me krahë 1

1	Dy këmbë	B	pëllumbi
	Gjashtë këmbë	C	bieta

Fa krahë 2

2	Me këmbë	A	pleshiti
	Pa këmbë	D, E (3)	ngjala dhe krimbi i tokës

3	Mesy	D	ngjala
	Fasy	E	krimbi i tokës

Në shembullin e mësipërm, përdorimi i karakteristikave të detajuara do të vononte identifikimin. Ky çelës është i thjeshtë, i saktë dhe ende ka përdorim.

108



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Demonstrim dhe Ushtrim

- Demonstrim i përdorimit të çelësit për një organizëm të caktuar.
- Ushtrime praktike ku nxënësit, në grupe të vogla, e përdorin çelësin për të identifikuar disa organizma të ilustruar në fletore pune.

Puna në Grupe

- Nxënësit ndahen në grupe dhe fillojnë t'i identifikojnë organizmat që kanë vëzhguar gjatë ekskurSIONIT, duke e përdorur çelësin e përcaktimit.
- Çdo grup duhet t'i dokumentojë karakteristikat kryesore të organizmave dhe emrat e tyre të përcaktuar.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit: Diskutim dhe Përmbledhje

- Çdo grup prezanton një ose dy organizma që kanë identifikuar, duke i shpjeguar karakteristikat dhe procesin e përdorur për identifikim.
- Diskutim mbi sfidat e hasura gjatë përdorimit të çelësit dhe si mund të përmirësohet kjo aftësi.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi në fund të orës mësimore vlerësohet sipas aftësisë së tij/të saj për t'i përshkruar apo identifikuar çelësat determinues.

Detyrë:

(Nxënësit do të përgatitin një raport të shkurtër mbi një organizëm që kanë identifikuar gjatë ekskurSIONIT, duke përfshirë një përshkrim të karakteristikave të tij dhe procesin e përdorur për identifikim)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës: Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv p.sh.: ruajtja-konservimi i biodiversitetit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 5, II. 4, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si duhet të ushqehemi?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan rëndësinë e të ushqyerit e shëndetshëm;
- Analizon pasojat nga ushqimi i pashëndetshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Diskutim dhe Pyetje

Nxënësit diskutojnë në grupe të vogla për ushqimet që konsumojnë zakonisht dhe përse i zgjedhin ato. Pyetje për nxënësit: "Si mendoni se mund ta përmirësoni dietën tuaj të përditshme?"

Diskutim i shkurtër mbi çfarë nënkuptojnë nxënësit me fjalën "ushqim i shëndetshëm". Pyetje për nxënësit: "Cilat janë ushqimet tuaja të preferuara dhe pse mendoni se janë të shëndetshme ose jo të shëndetshme?"

3. USHQIMI I DUHUR - PËR NJË ORGANIZËM TË SHËNDETSHËM

Ushqim dhe tretje



Ushqime të pasura me karbohidrate



Ushqime të pasura me yndyra

3.1. Si duhet të ushqehemi?

Trupi i njeriut gjithmonë ka nevojë për energji

Ju keni mësuar tashmë se trupi juaj merr energji për të ecur ose për aktivitetet të tjera fizike nga lëndët ushqyese që ai i djeg. Një motor avulli ka nevojë për qymyr ose naftë për të bërë punë. Një makinë ka nevojë për benzinë ose naftë. Nëse fikni këtë makinë, nuk nevojitet energji. Ndërsa, trupi juaj nuk është aspak "i fikur", me pushim të plotë fizik. Ai edhe kur është pasiv, ka nevojë për energji. Pra, frymëmarrja duhet të mbahet. Zemra pompon vazhdimisht gjakun përmes enëve. Po ashtu, aktiviteti i zorrëve vazhdon. Në fundi, trupi duhet të mbajë një temperaturë konstante të trupi prej rreth 37 °C.

Nëse kryeni aktivitetet të ndryshme gjatë ditës, do t'ju duhet energji shtesë për këtë. Për shembull, çiklizmi për 1 orë e gjysmë do të kërkojë një sasi energjie shtesë që mund ta merrni nga një grusht kikirikë. Po kur luani futboll për një orë? Sigurisht që keni nevojë shtesë për sasinë e energjisë!

Trupi e merr energjinë nga karbohidratet, yndyrat dhe proteinat.

Shumicën e energjisë e përbajnë ushqimet e pasura me yndyrë dhe karbohidrate. Për shembull, 240 gramë yndyra do të mbulonin gjithë kërkesat e përditshme të energjisë. Energia e panevojshme ruhet nga trupi në formë të dhjamit. Ajo yndyrë ju bën të ndiheni të lodhur dhe të ngarkoni zemrën tuaj. Për të shmangur këto depozitime të yndyrës, keni nevojë për ushqim të përshtatshëm dhe ushtrimet të mjaftueshme.

Ushqimi duhet përtypur mirë

Një dietë e shëndetshme nuk varet vetëm nga sasia e dhuruar e ushqimit, por është me rëndësi edhe procesi i të ngrënit. Kështu, ushqimi duhet jetë i tillë që të copëtohet lehtë gjatë përtypjes në gojë, në mënyrë që të përzhohet mirë me enzimat e pëshëtyrës. Dhe kështu ushqimi tretet më lehtë. Ju duhet të ndani nevojat e përditshme ushqyese në 5 vakte. Në këtë mënyrë, ju vazhdimisht e ushqeni trupin tuaj me ushqimin e kërkuar, pa i ngarkuar organet ndihmëse të tretjes. Nëse hani shumë ose nëse ushqimi juaj hyn në organizëm duke qenë shumë i frohtë ose shumë i nxehtë, lukthi do të reagojë. Thartira e repërt mund të dëmtojë mukozën e lukthit. Nëse ky inflamacion nuk trajtohet, mund të shkaktohet ulcera e lukthit.

Ushqimi i llojllojshëm është i shëndetshëm

Ushqimi vetëm me karbohidrate, yndyra dhe proteina nuk mjafton për ta mbajtur trupin tuaj të shëndetshëm. Ai ka nevojë edhe për substanca vitale, siç janë mineralet dhe vitaminat, edhe pse duhen në sasi të vogël. Kështu, çdo vitaminë kryen një funksion të veçantë në trup. Për shembull, vitamina C rrit rezistencën ndaj sëmundjeve të caktuara, ose, p.sh., mungesa e hekurit si kripë minerale shkakton anemi. Ato janë të pranishme në sasi të ndryshme në ushqimet e ndryshme, veçmas në drithëra, fruta dhe perime. Përdorimi i dietave të ndryshme është i mjaftueshëm për t'ju siguruar vitamina dhe minerale të duhura. Mirëpo, nëse nuk i plotësojmë nevojat tona me vitamina përmes ushqimeve, ne mund t'i marrim ato përmes pilulave, çdoherë me rekomandim të mjekut/ës. Rëndësi kanë edhe fibrat.



Ushqime të pasura me proteina



Ushqime të pasura me kripëra minerale, vitamina dhe fibra

111



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbytjes Video edukative

Shfaqja e një videoje edukative mbi zgjedhjet ushqimore të shëndetshme dhe ndikimin e tyre në shëndet.

<https://www.youtube.com/watch?v=a-084pqI05U>



Aktivitet në Grup

Nxënësit ndahen në grupe dhe krijojnë postera që ilustronjë një menu të shëndetshme për një ditë të plotë (mëngjes, drekë, darkë, ushqime të ndërmjetme). Çdo grup duhet të përfshijë ushqime nga të gjitha grupet ushqimore dhe t'i shpjegojë përfitimet e tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Aktivitet Përmbledhës

Nxënësit shkruajnë në fletore për një ushqim të shëndetshëm që do ta përfshijnë në dietën e tyre dhe pse. Diskutimi mbi rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm mbi ushqyerjen e shëndetshme dhe burimet e besueshme të informacionit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i pjesëmarrjes në diskutime dhe aktivitetet në grup.

Detyrë:

(Nxënësit do të mbajnë një ditar ushqimor për një javë, duke regjistruar çdo vakt dhe ushqimet e konsumuara. Ata duhet të reflektojnë mbi zgjedhjet e tyre dhe të propozojnë përmirësime)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës: Vlerëson rëndësinë e të ushqyerit e shëndetshëm.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. V 2. IV IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shëndeti - dietat e balancuara dhe stërvitja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon konceptin dieta të balancuara;
- Vlerëson rëndësinë e dietës dhe stërvitjeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri bazë, fletore pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Edukatë qytetare, Kimi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Diskutim i hapur:

Përhëndetje dhe prezantimi i temës.

Diskutim i shkurtër mbi rëndësinë e një stili të shëndetshëm jetese.

Pyetje hyrëse për ta nxitur diskutimin: Çfarë është një dietë e balancuar? Pse është e rëndësishme stërvitja?

3.2. SHËNDETI - DIETAT E BALANCUARA DHE STËRVITJA

3.2.1. Si ta ruajmë shëndetin?

Që të jemi të shëndetshëm, ne duhet të përkujdesemi përmes ushqimit dhe një sërë aktiviteteve. Duhet të përzgjedhim dieta të balancuara me ushqim të shëndetshëm, të jemi fizikisht aktiv (eje në natyrë, aktivitete sportive, vrapim etj.), të flemë mjaftueshëm (8-10 orë).



Ecja në natyrë

3.2.1. Dietat e balancuara dhe stërvitja

Një dietë e balancuar duhet të ketë të gjitha lëndët ushqyese të kërkuara nga trupi për ta mbajtur atë të shëndetshëm. Çdo kequshqyerje shkakton problem shëndetësor. Kequshqyerja nënkupton marrje jo të mjaftueshme ose tejkalim të sasisë së nevojshme të ushqimit, p.sh., disa arrijnë mbipeshë nga marrja e tepërt e ushqimeve, të tjerët mund të jenë nën peshën normale, sepse nuk konsumojnë ushqim të mjaftueshëm dhe cilësor. Dieta ndryshon varësisht nga moshja, aktiviteti dhe klima.

Mbipeshë llogaritet kur masa trupore është 15% më e madhe se masa ideale për lartësinë e caktuar. Sot në botë me mbipeshë janë rreth 340 milionë fëmijë dhe adoleshentë të moshës 5-18 vjeç. Peshë e tepërt e trupit bën që zemra të punojë më shumë, sepse duhet të pompojë gjak për një masë më të madhe të indeve. Shtimi i pompimit shkakton një tendosje në zemër. Njerëzit me mbipeshë kanë



Ushqime të pashëndetshme



Piramida ushqimore



Ushtrimet në palestër



Vrapimi në natyrë

më shumë gjasa të jenë diabetikë (me sëmundje të sheqerit) dhe të kenë një sulm në zemër. Sa më e balancuar të jetë dieta, më pak ka lodhje dhe sëmundje. Shumica e karbohidrateve që merren për të plotësuar nevojat për sheqer janë të dëmshme për dhëmbët tuaj. Bakteret në gojën tuaj përdorin sheqerin dhe prodhojnë acide. Acidet kalbëzojnë dhëmbët. Është mirë që sa më pak të kenë ëmbëlsira në shujtat tuaja, dhe pas ngrënies së ëmbëlsirave dhe ushqimeve të tjera, t'i lani dhëmbët. Nëse ka shumë yndyrë në ushqimin që konsumoni, ajo shtrohet në enët e gjakut gjatë qarkullimit. Depozitimi i yndyrave mund të shkaktojë formimin e mpiksjes së gjakut që mund të bllokojë enët e ngushta të gjakut. Nëse mpiksja e gjakut ndodh në tru, ajo shkakton një goditje në tru. Nëse ajo ndodh në enët e gjakut që ushqejnë muskujt e zemrës me oksigjen, atëherë mund të ndodhë një sulm në zemër etj.

Kripa e tepërt në ushqim e bën më të vështirë punën e zemrës në pompimin e gjakut. Tensioni i gjakut rritet, ju lodheni më shpejt. Rekomandohet që të hani sa më pak ushqime të përpunuara, p.sh., salcicë, donera, burgera viçi, sepse ato përmbajnë shumë yndyrë dhe kripë.

Duke shikuar piramidën ushqyese në figurën lart, vini re se drithërat, buka e zezë, makaronat, frutat e freskëta dhe mishit i bardhë janë të rekomanduara për një dietë të balancuar. Çdo ditë rekomandohet të kemi 3 - 5 porcione më fruta dhe perime. Është vlerësuar se përveç dietave jo të balancuara, një arsye për mbipeshë dhe sëmundje të zemrës mund të jetë mungesa e stërvitjeve. Njerëzit që bëjnë stërvitje të rregullta janë më të shëndetshëm dhe bëhen më të fuqishëm:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Aktivitet Praktik - Planifikimi i Dietës

Mësim i bazuar në projekt

- Nxënësit punojnë në grupe për të krijuar një plan javor të dietës së balancuar.
- Diskutimi dhe prezantimi i planeve të tyre për klasën.

Prezantimi i Stërvitjes

Shpjegimi i përfitimeve të stërvitjes: forcimi i muskujve, përmirësimi i qarkullimit të gjakut, kontrolli i peshës, përmirësimi i humorit.

Llojet e stërvitjes: kardio, forcë, fleksibilitet.

Diskutimi i rreziqeve të mundshme të stërvitjes së tepruar ose të papërshtatshme.

Videoja informuese mbi llojet e stërvitjes dhe përfitimet e saj (5 minuta).

<https://www.youtube.com/watch?v=7TregDRcrBw>



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët Reflektim dhe përmbledhje

Përmbledhje e temave të trajtuara gjatë mësimin.

Diskutimi i rëndësisë së kombinimit të dietës së balancuar dhe stërvitjes për një stil të shëndetshëm jetese.

Pyetje dhe përgjigje për të adresuar çdo paqartësi ose pyetje të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve, pasi arrijnë ta vlerësojnë rëndësinë e dietës dhe të stërvitjeve.

Detyrë:

(Përgatitja e një eseje mbi përfitimet e një diete të balancuar dhe të stërvitjes për shëndetin personal)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës: Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 5, II. 4, IV. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si ta mbajmë higjienën për një jetë të shëndetshme?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e higjienës personale;
- Përshkruan mbajtjen e higjienës brenda shtëpisë;
- Vlerëson gjendjen e higjienës së klasës dhe ndikimin e saj në shëndet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, laptop, projektor, fotografi nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Art figurativ, TIK, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja shfaq në ekran disa fotografi dhe u kërkon nxënësve të mendojnë se cili është mesazhi që duan të tregojnë përmes këtyre fotografive apo edhe çfarë mendojnë ata kur i shohin fotografitë (nëse nuk ka mundësi të shafqen në projektor, laptop apo TV mund edhe të printohen dhe të shpërndahen fotografitë e tilla). Pastaj, nxënësit i shprehin mendimet e tyre lidhur me atë se çfarë po shohin.



3.3. SI TA MBAJMË HIGJIENËN PËR NJË JETË TË SHËNDETSHME?

Parandalimi i sëmundjes është më i preferuar se kurimi.

3.3.1. Higjiena personale

Higjiena personale nënkupton mbajtjen pastër të trupit. Pastërtia e trupit arrihet duke u përkujdesur vazhdimisht për trupin dhe veshjet:

Duart duhen larë shpesh, sidomos pas përdorimit të tualetit dhe para ngrënies, në mënyrë që të parandalohet bartja e parazitëve dhe baktereve në ushqim.

Dhëmbët duhen larë së paku dy herë në ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje, me furçe dhe me pastë dhëmbësh fluoride. Rekomandohet të bëhet kontroll te dentisti çdo gjashtë muaj, në mënyrë që të parandalohet prishja e dhëmbëve.

Flokët lahen për heqjen e vajrave të tepërta, baktereve dhe papastërtive. Krehja bëhet për të mbajtur flokët dhe lekuren e kokës të shëndetshme. Krehrit që i përdor vetë nuk duhet t'i përdorë dikush tjetër dhe anasjelltas, sepse mund të transferohen papastërtitë.

Trupi lahet sepse kështu largohet lëkura e vdekur, vajrat dhe bakteret. Pas larjes, duhet të thahet trupi me kujdes, sidomos në mes gishtërinjve të këmbëve, sepse ndihmon në parandalimin e infeksioneve të ndryshme, sidomos nga kërpudhat.

Rrobot dhe faculetat duhen larë dhe tharë për të pamundësuar zhvillimin e patogjenëve si të parazitëve, baktereve.

Mbajta e duhur e higjienës ndihmon të jemi të shëndetshëm, të ndihemi mirë, të mos kemi erë të pakëndshme.

3.3.2. Higjiena e shtëpisë

Higjienës së shtëpisë duhet kushtuar rëndësi të madhe, sepse pjesën më të madhe të kohës e kalojmë aty. Shtëpipte e pastra zvogelojnë mundësinë e barjes së sëmundjeve. Kuzhina nuk duhet të ketë pluhur, enët e ushqimit duhen larë dhe tharë pas përdorimit. Ushqimi preferohet të gatuhet me përbërës

Higjiena e trupit

e freskët, por edhe me ata që i kemi ruajtur në frigorifer. Para gatimit, shkriticja e peshkut, e mishit, e shpendëve, e perimeve duhet të bëhet me kujdes. Kurse dhoma e ditës dhe ajo e gjumit nuk duhet të përmbajnë pluhur, tym cigareje etj. Mbështjellësit e jashtëkeve, jorganëve, çarçafët duhen larë shpesh, që t'iu largohen papastërtitë dhe të parandalohet zhvillimi i mikrobeve që shkaktojnë sëmundje. Mbetjet nga shtëpia duhen hedhur në mënyrë të rregullt në kontejner, si dhe ujërat e zeza në kanalizim.



Higjiena e shtëpisë

3.3.3. Higjiena e komunitetit

Higjiena në një komunitet qoftë në zonat rurale, qoftë në ato urbane, mund të mbahet nëse ka angazhim individual dhe organizim në komunitet. Kjo kërkon kontroll të vazhdueshëm nga inspektorati shëndetësor.

Duhet të përcillet dhe të sigurohet se:

- mbeturinat mblidhen dhe hidhen në vendin e duhur,
- ujërat e zeza janë hedhur si duhet,
- uji i pijshëm të jetë i pastër,
- pishinat publike të jenë të pastra,
- marketet ushqimore dhe vendet e ngrënies janë në përputhje me rregulloret shëndetësore,
- vaksinimi dhe programet e vaksinimit kryhen sipas standardeve.

Pyetje

1. Si mund ta parandalojmë sëmundjen?
2. Pse duhet mbajtur higjienën e shtëpisë?
3. A mjafton mbajtja e higjienës personale dhe e higjienës së shtëpisë?
4. Si duhet ta mbajmë higjienën në komunitet?

117



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes *Lexim i drejtuar*

Nxënësit e lexojnë titullin dhe japin mendime e parashikime për përmbajtjen e paragrafit të parë (higjiena personale, urbane dhe rurale), duke i argumentuar ato. Pasi e lexojnë paragrafin e parë, ata e krahasojnë përmbajtjen e tij me parashikimet e tyre. Vazhdohet kështu me tërë tekstin. Mësimdhënësi/ja kujdeset për t'i sqaruar konceptet kryesore gjatë leximit me ndalesa. Diskutohet rreth informacionit të marrë në tekst dhe informacioneve të sjella nga vetë nxënësit. Nxënësit ndahen në grupe dhe i demonstrojnë praktikatat e duhura të larjes së duarve dhe të dhëmbëve. Diskutimi dhe reflektimi mbi rëndësinë e këtyre praktikave.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët *Shkrim i shpejtë*

Në minutat e fundit të orës nxënësit do të shkruajnë shumë shkurt dhe shumë shpejt në lidhje me temën “Higjiena në komunitet”. Në këtë shkrim nxënësit do t'i përmbledhin mendimet në lidhje me temën dhe informacionet që morën. Disa nxënës i lexojnë shkrimet e tyre. Mësimdhënësi/ja do të përqendrohet në idetë e hedhura në letër, e jo në paraqitjen e shkrimit (mënyrën si po shkruajnë: me gabime apo me shkrim të parregullt). Jepet një fjali e pambaruar si temë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime), pasi e shpjegojnë rëndësinë e higjienës personale.

Detyrë:

(Nxënësit të mbajnë një ditar të higjienës personale për një javë dhe të reflektojnë mbi përvojën e tyre)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon procesin e rritjes dhe të zhvillimit, proceset riprodhuese njerëzore dhe problemet e abuzimit seksual.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 5, II. 4, IV. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Riprodhimi te njeriu dhe edukata seksuale

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Definojnë termin dimorfizëm seksual;
 - Përshkruan ndryshimet fizike trupore te meshkujt dhe femrat;
 - Shpjegon procesin e riprodhimit njerëzor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Art figurativ, Edukatë qytetare.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë **Di**

“DI” në fazën e parë të mësimin nxënësit e plotësojnë kolonën “DI” me njohuritë që kanë rreth riprodhimit të njeriut dhe edukatës seksuale. Mësimdhënësi/ja i paraqet edhe në tabelë kolonat, pastaj fton disa nxënë të lexojnë disa nga informacionet që ata kanë për temën dhe kështu i shkruan në tabelë.
 “Dua të di - në kolonën dua të di nxënësit shkruajnë pyetje se çfarë duan të dinë për riprodhimin dhe edukatën seksuale, nëse për këtë pjesë nuk kanë pyetje, atëherë mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit ta lexojnë njësinë mësimore në libër dhe nëse aty gjejnë diçka të paqartë e shkruajnë si pyetje ose çfarë duan të dinë më shumë.

3.4. RIPODHIMI TE NJERIU DHE EDUKATA SEKSUALE

Njeriu, si dhe shumica e shtazëve, ka vetinë e riprodhimit seksual. Individit i seksit femër dallohet nga individit i seksit mashkull. Ndryshueshmëria për nga forma dhe ndërtimi në mes individit mashkull dhe individit femër të të njëjtit lloj quhet **dimorfizëm seksual**. Duke shikuar figurën më poshtë, dallohet qartë individit i seksit femër prej individit të seksit mashkull. Ju keni mësuar tashmë diçka rreth organeve të trupit tuaj, prandaj duhet të dini edhe për organet tuaja riprodhuese.




Dimorfizmi te njeriu

3.4.1. Puberteti - pjekuria seksuale

Çfarë është puberteti? Foshnjat lindin me organe riprodhuese, por ato nuk funksionojnë deri në pubertet. Puberteti është koha kur organet riprodhuese bëhen të pjekura. Gjatë pubertetit, fëmija zhvillohet në individ të rritur. Kështu, një femër dhe një mashkull nga periudha e fëmijërisë kalojnë në atë të rinisë (adoleshencë). Në pubertet vihen re ndryshime fizike trupore dhe ndryshime emocionale. Këto ndryshime i kontrollojnë hormonet seksuale.

3.4. RIPRODHIMI TE NJERIU DHE EDUKATA SEKSUALE

Njeriu, si dhe shumica e shtazëve, ka vetinë e riprodhimit seksual. Individit i seksit femër dallohet nga individit i seksit mashkull. Ndryshueshmëria për nga forma dhe ndërtimi në mes individit mashkull dhe individit femër të të njëjtit lloj quhet **dimorfizëm seksual**. Duke shikuar figurën më poshtë, dallohet qartë individit i seksit femër prej individit të seksit mashkull. Ju keni mësuar tashmë disa rreth organeve të trupit tuaj, prandaj duhet të dini edhe për organet tuaja riprodhuese.



Dimorfizmi te njeriu

3.4.1. Puberteti - pjekuria seksuale

Çfarë është puberteti? Foshnjat lindin me organe riprodhuese, por ato nuk funksionojnë deri në pubertet. Puberteti është koha kur organet riprodhuese bëhen të pjekura. Gjatë pubertetit, fëmija zhvillohet në individ të rritur. Kështu, një femër dhe një mashkull nga periudha e fëmijërisë kalojnë në atë të rinisë (adoleshencë). Në pubertet vihen re ndryshime fizike trupore dhe ndryshime emocionale. Këto ndryshime i kontrollojnë hormonet seksuale.

118

“Mësova”- ndërsa kolonën Mësova e plotësojnë me njohuritë e reja të fituara. Kështu veprohet edhe në tabelën e punuar për të gjithë klasën, mësimdhënësi/ja fton disa nxënës t’i shkruajnë edhe në tabelë njohuritë e tyre të fituara.

DI	DUA TË DI	MËSOVA



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mësim i bazuar në diskutim

Nxënësit ndahen në grupe për të diskutuar mbi temat e trajtuara: rëndësia e komunikimit në marrëdhëniet intime, si të përdoren metodat kontraceptive dhe si të parandalohen SST-të.

Çdo grup i prezanton përfundimet e tyre dhe diskutojnë në klasë.

Prezantim dhe diskutim interaktiv

Shpjegimi i strukturës dhe i funksionit të sistemit riprodhues mashkullor dhe femëror me ndihmën e diagramave.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Reflektim dhe përmbledhje

Nxënësit të krijojnë një poster informues mbi një metodë të caktuar kontraceptive ose një sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe ta prezantojnë në orën e ardhshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen pasi e përshkruajnë dhe vlerësojnë dimorfizmin seksual dhe ndryshimet midis meshkujve dhe femrave.

Detyrë:

(Nxënësit udhëzohen që në mënyrë individuale të hulumtojnë për pubertetin)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V. 3, V. 9, VI. 6

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Puberteti - pjekuria seksuale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon strukturat riprodhuese të meshkujve dhe femrave dhe funksionet e tyre;
- Përshkruan fazat e ciklit menstrual;
- Shpjegon kujdesin për higjienën e trupit gjatë pubertetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë titullin e mësimt dhe u kërkon nxënësve fillimisht të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj, fton disa nga ta të diskutojnë dhe t'i shpalojnë mendimet e tyre për pubertetin, duke mos i pohuar apo mohuar. Mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë në mënyrë që vetë nxënësit t'i vetëvlerësojnë mendimet e tyre pasi ta kenë mësuar njësinë mësimore.

3.4. RIPRODHIMI TE NJERIU DHE EDUKATA SEKSUALE

Njeriu, si dhe shumica e shtazëve, ka vetinë e riprodhimit seksual. Individit i seksit femër dallohet nga individit i seksit mashkull. Ndryshueshmëria për nga forma dhe ndërtimi në mes individit mashkull dhe individit femër të të njëjtit lloj quhet **dimorfizëm seksual**. Duke shikuar figurën më poshtë, dallohet qartë individit i seksit femër prej individit të seksit mashkull. Ju keni mësuar tashmë diçka rreth organeve të trupit tuaj, prandaj duhet të dini edhe për organet tuaja riprodhuese.




Dimorfizmi te njeriu

3.4.1. Puberteti - pjekuria seksuale

Çfarë është puberteti? Foshnjat lindin me organe riprodhuese, por ato nuk funksionojnë deri në pubertet. Puberteti është koha kur organet riprodhuese bëhen të pjekura. Gjatë pubertetit, fëmija zhvillohet në individ të rritur. Kështu, një femër dhe një mashkull nga periudha e fëmijërisë kalojnë në atë të rinisë (adoleshencë). Në pubertet vihen re ndryshime fizike trupore dhe ndryshime emocionale. Këto ndryshime i kontrollojnë hormonetsëksuale.

Hormoni kryesor femëror quhet **estrogjen**, ndërsa hormoni kryesor mashkullor quhet **testosteron**. Deri në moshën 10-vjeçare ka pak ndryshime në zhvillimin e meshkujve dhe femrave. Ndërmjet moshave 11 dhe 15-vjeçare, dallohet puberteti ose pjekuria seksuale. Te meshkujt puberteti zakonisht fillon një deri në dy vjet më vonë se te femrat. Ju mund të keni vënë re tashmë disa ndryshime në vetvete. Në figurën poshtë mund të shihni dallimin ndërmjet foshnjës rreth 5-muajshe, fëmijës rreth 10 vjeç dhe adoleshentes rreth 15 vjeç.



Ndryshimet nga foshnjëria deri në adoleshencë

- a. Foshnja rreth 5-muajshe
- b. Fëmija rreth 10 vjeç
- c. Adoleshentja rreth 15 vjeç

3.4.2. Cilat janë ndryshimet fizike?

Gjatë pubertetit, ndodhin një sërë ndryshimesh fizike. Një nga ndryshimet e para është zgjatja e trupit. Te femrat rriten gjinjtë, kofshët, dhe diferencohet beli, ndërsa te meshkujt zgjerohen shpatullat, rriten dhe forcohen muskujt, ndryshon zëri, dalin qime në mjekër. Te femrat dhe meshkujt fillon rritja e qimeve në pubik (përreth organeve gjentiale) dhe nën sqetulla. Ndryshimet fizike që ndodhin në pubertet quhen karakteristika sekondare seksuale. Këto ndryshime përcillen me ndryshime emocionale. Të rinjtë, në këtë fazë të zhvillimit, quhen adoleshentë.

119



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbytjes *Lexim i drejtuar*

Lexohet titulli “Cilat janë ndryshimet e tjera në pubertet” (paragrafi i parë). Nxënësit japin parashikimin e tyre për përmbytjen e paragrafit. Pastaj, lexohet paragrafi dhe bëhet krahasimi i informacionit me atë që parashikuan ata. Në këtë moment mësimdhënësi/ja sqaron koncepte a pyetje që mund t’u lindin nxënësve. Kështu vazhdohet dhe me paragrafët e tjerë me nëntitujt “Ndryshimet që ndodhin te meshkujt dhe femrat”.

Videoja edukative - Puberteti dhe hormonet përgjegjëse
<https://www.youtube.com/watch?v=X1m4Dyr1N18>



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit *Diagrami i Venit*

Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që njohuritë e fituara t’i paraqesin në formë të diagramit të venit. Pra, në një rën anë t’i shkruajnë ndryshimet karakteristike që shfaqen te gjinia mashkullore, kurse në anën tjetër t’i shkruajnë karakteristikat që shfaqen te gjinia femrore gjatë pubertetit. Kurse, në mes t’i shkruajnë karakteristikat e përbashkëta për të dyja gjinitë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen pasi e përshkruajnë pubertetin dhe ndryshimet që shfaqen gjatë kësaj periudhe.

Detyrë:

(Të shikohen ushtrimet në fletore pune)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: V. 3, V. 9, VI. 6

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Puberteti - pjekuria seksuale - Përsëritje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon strukturat riprodhuese të meshkujve dhe femrave dhe funksionet e tyre;
- Përshkruan fazat e ciklit menstrual;
- Shpjegon kujdesin për higjienën e trupit gjatë pubertetit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Diskutim i njohurive paraprake


Diskutim i shkurtër mbi çfarë nxënësit dinë rreth pubertetit dhe pjekurisë seksuale. Pyetje hyrëse për ta nxitur diskutimin: Çfarë është puberteti? Çfarë ndryshimesh ndodhin gjatë kësaj periudhe? Vazhdohet ushtrimi në fletore pune, faqe 80.

3.3. RIPRODHIMI TE NJERIU DHE EDUKATA SEKSUALE

1. Lidhi me vija shprehjet e anës së majtë me karakteristikat e shënuara në anën e djathtë.

dimorfizëm seksual	estrogjeni
puberteti	koha kur organet riprodhuese bëhen të pjekura
pkjuria seksuale krijon	fillimi i menstruacioneve
ndryshimet fizike	ndryshueshmëria për nga forma dhe ndërtimi në mes individit mashkull
ndërmjet moshave 11 dhe 15	testosteroni
ndryshimet emocionale	dallohet puberteti
qelizat e spermës	formohen në testikuj
qelizat vezë	përcillen me ndryshime emocionale
higjiena e organeve gjentale	ndryshime të thella emocionale
te shumica e adoleshentëve	dallohen lehtë
në pubertetin e vajzës	formohen puçrrat në lëkurë
hormoni kryesor mashkullor	piqen në vezore
hormoni kryesor femëror	është domosdoshmëri

2. Në figurën poshtë, shëno karakteristikat e individit mashkull dhe individit femër në pubertet.



dimorfizëm seksual	estrogjeni
puberteti	koha kur organet riprodhuese bëhen të pjekura
pkjuria seksuale krijon	fillimi i menstruacioneve
ndryshimet fizike	ndryshueshmëria për nga forma dhe ndërtimi në mes individit mashkull
ndërmjet moshave 11 dhe 15	testosteroni
ndryshimet emocionale	dallohet puberteti
qelizat e spermës	formohen në testikuj
qelizat vezë	përcillen me ndryshime emocionale
higjiena e organeve gjentale	ndryshime të thella emocionale
te shumica e adoleshentëve	dallohen lehtë
në pubertetin e vajzës	formohen puçrrat në lëkurë
hormoni kryesor mashkullor	piqen në vezore
hormoni kryesor femëror	është domosdoshmëri

3. Shkruani më poshtë ndryshimet që keni vërejtur te vetja.

4. A janë këto pohime të sakta?

- a. Njeriu, si dhe shumica e shtazëve, ka vetinë e riprodhimit seksual. PO JO
- b. Puberteti është koha kur organet riprodhuese bëhen të pjekura. PO JO
- c. Në pubertet, nuk vihen re ndryshime fizike trupore dhe ndryshimet emocionale. PO JO
- d. Te meshkujt, puberteti zakonisht fillon pesë vjet më vonë se te femrat. PO JO
- e. Një nga ndryshimet e para është zgjatja e trupit. PO JO
- f. Ndryshimet fizike që ndodhin në pubertet quhen karakteristika primare seksuale. PO JO
- g. Pjekuria seksuale krijon ndryshime të thella emocionale, sociale dhe personale në raport me njerëzit e tjerë. PO JO
- h. Me fillimin e ciklit menstrual, një femër është e pjekur seksualisht dhe mund të mbesë shtatzënë. PO JO
- i. Në pubertet, adoleshentët djersiten më shumë. PO JO

81




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Mësim i bazuar në diskutim

Nxënësit ndahen në grupe për të diskutuar mbi temat e trajtuara: ndryshimet gjatë pubertetit, rëndësia e komunikimit dhe respektit në marrëdhëniet intime dhe metodat për parandalimin e rreziqeve.

Çdo grup i prezanton përfundimet e tyre dhe diskutojnë në klasë.

Vazhdohet me ushtrimin e radhës në fletore pune, faqe 80.

2. Në figurën poshtë, shëno karakteristikat e individit mashkull dhe individit femër në pubertet.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët
Reflektim dhe përmbledhje

- Përmbledhje e temave të trajtuara gjatë mësimin.
- Diskutimi mbi rëndësinë e edukatës seksuale dhe menaxhimin e ndryshimeve gjatë pubertetit për një zhvillim të shëndetshëm.
- Përsëritje e informacionit kyç për të siguruar që nxënësit e kanë kuptuar materialin e mësuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet pasi nxënësit e përshkruajnë dhe dallojnë pubertetin dhe ndryshimet që ndodhin gjatë tij.

Detyrë:

(Nxënësit të përgatitin një prezantim të shkurtër mbi një aspekt të pubertetit ose edukatës seksuale që atyre u duket i rëndësishëm dhe ta prezantojnë në orën e ardhshme)

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Biologji

Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI

Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës. Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, III. 8, V. 7, VI. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Seksualiteti njerëzor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon llojet e seksualitetit te njerëzit;
- Përshkruan karakteristikat e individëve me përkatësi të ndryshme të seksualitetit;
- Identifikon dhe përshkruan abuzimet seksuale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi: Përgatitja për të nxënë

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë titullin e mësimit dhe u kërkon nxënësve fillimisht të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj, fton disa nga ta të diskutojnë dhe t'i shpalosin mendimet e tyre për seksualitetin njerëzor, duke mos i pohuar apo mohuar. Mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë në mënyrë që nxënësit t'i vetëvlerësojnë mendimet e tyre pasi ta kenë mësuar njësinë mësimore.

3.6. SEKSUALITETI NJERËZOR

Seksualiteti njerëzor u shërben për riprodhim, për krijimin e marrëdhënieve të ndryshme etj. Është një formë e shprehjes së ndjenjave dhe dashurisë. Ekzistojnë disa orientime seksuale, si: **heteroseksualiteti, homoseksualiteti dhe biseksualiteti.**

Nëse një person tërhiqet nga seksi i kundërt, atëherë themi se është heteroseksual, ndërsa nëse tërhiqet nga seksi i njëjtë, themi se është homoseksual. Kur një person tërhiqet nga të dyja sekset, edhe seksi i njëjtë, edhe seksi i kundërt, themi që është biseksual.



Duhet theksuar se Republika e Kosovës, si edhe shumë vende të tjera në botë, ka ligje që mbrojnë komunitetin LGBTQ+, për shkak se ka shumë stereotipa dhe paragjykimë që lidhen me orientimet seksuale.

3.6. SEKSUALITETI NJERËZOR

Seksualiteti njerëzve u shërben për riprodhim, për krijimin e marrëdhënieve të ndryshme etj. Është një formë e shprehjes së ndjenjave dhe dashurisë. Ekzistojnë disa orientime seksuale, si: **heteroseksualiteti, homoseksualiteti dhe biseksualiteti.**

Nëse një person tërhiqet nga seksi i kundërt, atëherë themi se është heteroseksual, ndërsa nëse tërhiqet nga seksi i njëjtë, themi se është homoseksual. Kur një person tërhiqet nga të dyja sekset, edhe seksi i njëjtë, edhe seksi i kundërt, themi që është biseksual.



Duhet theksuar se Republika e Kosovës, si edhe shumë vende të tjera në botë, ka ligje që mbrojnë komunitetin LGBTQ+, për shkak se ka shumë stereotipa dhe paragjykimë që lidhen me orientimet seksuale.

123



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Sistemi ndërveprues i shënimeve

Përzgjidhni një tekst që është i rëndësishëm për temën e mësimin.

Shpërndajeni tekstin për nxënësit ose jepni udhëzime se ku mund ta gjejnë atë në libër.

Shpjegimi i simboleve:

Para se ta fillojnë leximin, ua shpjegoni nxënësve kuptimin e simboleve që do të përdorin:

√ (shenjë kontrolli): Për ide apo informacione që nxënësit tashmë i dinë.

(kryq): Për informacion të ri dhe interesant.

(minus): Për informacione ose ide që janë të ndryshme nga ato që nxënësit mendonin.

? (pikëpyetje): Për informacione ose ide që janë të paqarta ose që duan më shumë shpjegim.

Leximi aktiv

Ndërsa lexojnë, nxënësit duhet t'i përdorin simbolet për t'i shënuar reagimet e tyre në tekst.

Nxënësit duhet të bëjnë shënime në tekst ose në një fletore të veçantë për t'i shpjeguar arsyet e shënimeve të tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Për të krijuar një lidhje analogjike me konceptin e ri “seksualiteti njerëzor”, mund të zgjidhet si koncept i njohur nga mësimdhënësi/ja koncepti “abuzime seksuale”. Paraqitet organizuesi grafik i analogjisë në tabelë. Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth karaktereve të përbashkëta e të veçanta për të dyja konceptet. Paraqiten ato përkatësisht në kolonën e ngjashmërive dhe ndryshimeve. Shkruhen të përmbledhura ngjashmëritë e dallimet e dy koncepteve në tabelë nga mësimdhënësi/ja.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen sipas aftësisë së tyre për ta përshkruar seksualitetin njerëzor.

Detyrë:

(Të plotësohet fletore pune, faqe 82)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës. Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, III. 8, V. 7, VI. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Abuzimi seksual

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan termin abuzim seksual;
- Tregon format e abuzimit seksual;
- Njeh mënyrat e reagimit në rast të të qenët target i abuzimit.


Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Organizues grafik



3.6.1. Abuzimi seksual

Në rastet kur kontakti seksual bëhet pa pëlqimin e njërit prej partnerëve quhet abuzim seksual. Shembuj të abuzimit seksual janë **ngacimi seksual, përdhunimi, pedofilia dhe incesti**. Përdorimi i forcës, shantazhit dhe çfarëdo forme tjetër për ta shfrytëzuar një person seksualisht quhet përdhunim. Personat e rritur që ndiejnë tërheqje seksuale ndaj fëmijëve, quhen **pedofili**, ndërsa vetë sjellja **pedofili**.

Ka raste kur marrëdhënie seksuale ka mes anëtarëve në rrethin e ngushtë të fëmijës (biologjikisht të afërm - prindërve dhe fëmijëve, vëllezërve dhe motrave, gjyshërve dhe nipërve). Ky lloj i marrëdhënies quhet **incest**. Në Kosovë dhe pothuajse në të gjitha vendet e botës, incesti është i ndaluar me ligj. Pedofilia dhe incesti shkaktojnë te fëmijët lëndime të mëdha psikike dhe fizike. Abuzimet seksuale dhe të tjerat janë të ndaluara me ligj.

3.6.2. Si mund ta mbron veten?

Gjithmonë mbani në mend se trupi juaj është vetëm juaji. Askush nuk ka të drejtë të të prekë kundër vullnetit tënd. Ju nuk duhet të nënshtroheni për asgjë, edhe nëse jeni i varur nga personi. Në rast të abuzimit, duhet të kërkonti ndihmë tek organet përkatëse (policia, qendrat për punë sociale etj.) ose te njerëzit që u besoni.

Të mbahet në mend!

- Njerëzit mund të jenë heteroseksuale, homoseksuale, biseksuale etj.
- Në Kosovë, si në shumë vende të tjera të botës, me ligj dhe me kushtetutë të gjithë janë të barabartë dhe mbrohen njëjtë, pa marrë parasysh etninë, racën, gjininë dhe orientimin seksual.
- Abuzimet seksuale janë të ndryshme, si: ngacimi seksual, përdhunimi, pedofilia dhe incesti.
- Abuzimi seksual është i dënueshëm me ligj.

Pyetje

1. Ç'është heteroseksualiteti dhe trego ku dallon nga homoseksualiteti dhe biseksualiteti.
2. Cilat janë mënyrat e abuzimit seksual?
3. Si duhet ta mbron veten nga abuzimi seksual?

3.6.1. Abuzimi seksual

Në rastet kur kontakti seksual bëhet pa pëlqimin e njërit prej partnerëve quhet abuzim seksual. Shembuj të abuzimit seksual janë **ngacmimi seksual, përdhunimi, pedofilia dhe incesti**.

Përdorimi i forcës, shantazhit dhe çfarëdo forme tjetër për ta shfrytëzuar një person seksualisht quhet **përdhunim**. Personat e rritur që ndiejnë tërheqje seksuale ndaj fëmijëve, quhen **pedofili**, ndërsa vetë sjellja **pedofili**.

Ka raste kur marrëdhënie seksuale ka mes anëtarëve në rrethin e ngushtë të fëmijës (biologjikisht të afërm - prindërve dhe fëmijëve, vëllezërve dhe motrave, gjyshërve dhe nipërve). Ky lloj i marrëdhënies quhet **incest**. Në Kosovë dhe pothuajse në të gjitha vendet e botës, incesti është i ndaluar me ligj. Pedofilia dhe incesti shkaktojnë te fëmijët lëndime të mëdha psikike dhe fizike. Abuzimet seksuale dhe të tjerat janë të ndaluara me ligj.

3.6.2. Si mund ta mbroji veten?

Gjithmonë mbani në mend se trupi juaj është vetëm juaji. Askush nuk ka të drejtë të të prekë kundër vullnetit tënd. Ju nuk duhet të nënshtroheni për asgjë, edhe nëse jeni i varur nga personi. Në rast të abuzimit, duhet të kërkoni ndihmë tek organet përkatëse (policia, qendrat për punë sociale etj.) ose te njerëzit që u besoni.

Të mbahet në mend!

- Njerëzit mund të jenë heteroseksualë, homoseksualë, biseksualë etj.
- Në Kosovë, si në shumë vende të tjera të botës, me ligj dhe me kushtetutë të gjithë janë të barabartë dhe mbrohen njëjtë, pa marrë parasysh etninë, racën, gjininë dhe orientimin seksual.
- Abuzimet seksuale janë të ndryshme, si: ngacmimi seksual, përdhunimi, pedofilia dhe incesti.
- Abuzimi seksual është i dënueshëm me ligj.

Pyetje

1. Ç'është heteroseksualiteti dhe trego ku dallon nga homoseksualiteti dhe biseksualiteti.
2. Cilat janë mënyrat e abuzimit seksual?
3. Si duhet ta mbroji veten nga abuzimi seksual?

124



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Shpjegimi i simboleve

Para se të fillojnë leximin, shpjegoni nxënësve kuptimin e simboleve që do të përdorin:

√ (shenjë kontrolli): Për ide apo informacione që nxënësit tashmë i dinë.

(kryq): Për informacion të ri dhe interesant.

(minus): Për informacione ose ide që janë të ndryshme nga ato që nxënësit mendonin.

? (pikëpyetje): Për informacione ose ide që janë të paqarta ose që duan më shumë shpjegim.

Leximi aktiv

Ndërsa lexojnë, nxënësit duhet t'i përdorin simbolet për t'i shënuar reagimet e tyre në tekst.

Nxënësit duhet të bëjnë shënime në tekst ose në një fletore të veçantë për t'i shpjeguar arsyet e shënimeve të tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Tabela e koncepteve

Abuzim seksual	
Pedofili	
Incest	
Organet e raportimit në rast abuzimi	

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen sipas aftësisë së tyre për t'i përshkruar konceptet abuzim seksual, pedofili, incest.

Detyrë:

(Të shënohet ndonjë përjetim personal sipas informatave të mësuara nga mësimi, shënimi të jetë anonim)

○ *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuate.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, III. 8, V. 7, VI. 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drogat - efektet dhe pasojat e përdorimit të tyre

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikimi i llojeve të ndryshme të drogës;
 - Kuptimi i efekteve psikologjike dhe fizike nga përdorimi i drogës;
 - Ndërgjegjësimi për pasojat nga përdorimi i drogës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: TV, poster, fotografi, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Kimi, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënët
Stuhi mendimesh

Bëhen pyetje të tilla, si:
 Çfarë dini për drogat dhe llojet e ndryshme të tyre?
 Cilat janë disa efekte të njohura të përdorimit të drogave?
 Pse mendoni se njerëzit e përdorin drogën?

3.7. DROGAT - EFEKTET DHE PASOJAT E PËRDORIMIT TË TYRE


Drogat janë kimikate, të cilat, kur futen në organizëm, ndryshojnë një ose më shumë funksione të tij.

Dalohen drogat mjekësore dhe jomjekësore. Drogat mjekësore janë barnat apo ilaçet që shërojnë sëmundje ose lehtësojnë simptomat. Barnat përfshijnë ilaçe të tilla si kodeina, metadoni, tramadoli etj. Personi që merr lloje të tilla të barnave rregullisht, fillon të bëhet i varur, domethënë, gjithmonë ka nevojë për ilaçin. Nëse një person i varur nga barnat (i droguar) përpigjet të ndalojë marrjen e barnave, mund të vuajë nga efekte të tilla si djerstje, dridhje dhe ndjesi të të sëmurit. Drogat jomjekësore ndikojnë për keq në funksionimin e trurit, të sistemit nervor dhe të gjithë organizmit. Drogat klasifikohen edhe në të ligjshme (duhani, alkooli, kafeina etj.), dhe të paligjshme (kanabis, heroina, kokaina, drogat sintetike etj.).



Gjendja e personit që përdor drogë

Disa droga merren përmes gojës, disa të tjera përmes hundës (me mushkëri), e disa injektohen të tretura drejt në gjak. Pas përdorimit, zakonisht fillojnë simptomat, si: dhembje në formë ngërçesh, dhembje muskujsh, dhembje nyjash etj. Për t'i larguar këto dhembje, përdoruesit shpesh merr një sasi të re drogë dhe kështu përfundon në një rreth vicioz (duke marrë vazhdimisht drogë). Kështu, përdoruesit krijojnë varësi ndaj substancave të tilla. Kjo mund të çojë në mbidozë e madje edhe në vdekje. Drogat si kokaina, kanabis, heroina etj. sot përbëjnë një problem global për shoqërinë njerëzore.



Efektet e pirjes së duhanit në mushkëri

Alkooli shkon në gjak nëpërmjet stomakut dhe pastaj përcillet në tru. Nga aty ai ndikon në sistemin nervor. Alkooli është një depresant (e ngadalëson funksionimin e trurit). Sasia e madhe e alkoolit në gjak mund të ndikojë në humbjen e vetëkontrollit të njerëzve (dehje), e gjithashtu mund të bëhet shkak për vdekjeje, sepse ul ritmin e frymëmarrjes dhe punës së zemrës. Drogat si kokaina, kanabis, heroina etj. sot përbëjnë një problem global për shoqërinë njerëzore.

Për shkak të efektit të alkoolit në sistemin nervor të njerëzve, ku ne nuk jemi plotësisht të vetëdijshëm për veprimet tona, përdorimi i tij për personat që ngasin automjetet kufizohet me ligj (0.05%).

Pirja e duhanit konsiderohet të jetë një nga shkaqet e mëdha të vdekjes në botë. Sipas OBSH-së, çdo gjashtë sekonda në botë vdes një person, ku shkaktar është pirja e duhanit. Në Kosovë çdo vit vdesin rreth 2000 persona nga sëmundjet që lidhen me pirjen e duhanit. Cigaret përmbajnë shumë kimikate si katran, monoksid karboni, cianid, nikotinë etj. Nikotina është substancë e cila krijon varësi, prandaj njerëzit ndonjëherë mund të kenë vështirësi të heqin dorë nga duhani, por kjo, natyrisht, nuk është e pamundshme. Nikotina shkakton sëmundje të zemrës, sepse ngushton enët e gjakut në trup, dhe dëmton mushkëritë duke shkakuar sëmundjen e kancerit. Prandaj prodhuesit e cigareve janë të obliguar të vënë një paralajmërim shëndetësor mbi pako. Monoksid karboni nga cigaret zvogëlon efikasitetin e oksigjenit në gjak (hemoglobininë) dhe bartet më pak oksigjen. Kjo rrit rrezikun e një sulmi në zemër. Nëse një grua shtatzënë pi duhan, fetusi nuk e merr sasinë normale të oksigjenit dhe foshnja nuk arrin peshën dhe rritjen normale. Foshnja në këto raste ka më shumë gjasa të marrë infeksione në muajt e parë të jetës.

Të mbahet në mend!

- Përdorimi i zgjaturi i barnave mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme.
- Pirja e alkoolit mund të dëmtojë mëçinit, zemrën dhe stomakun.
- Kanabisi, kokaína, opiumi, morfina, heroina etj., janë të gjitha droga që mund të ndryshojnë mënyrën se si funksionon trupi dhe mund të dëmtojnë organet e trupit. Këto droga, madje, janë vdekjeprurëse.
- Pirja e duhanit mund të shkaktojë kancer, sëmundje të zemrës dhe sëmundje të mushkërive.

Pyetje

1. Cili është efekti i alkoolit nëse merrret në sasi të madhe?
2. Emërto drogat dhe trego pasojat e përdorimit të tyre.
3. Trego përbërësit e duhanit dhe sëmundjet që mund të shkaktohen nga pirja e duhanit.
4. Cilat janë pasojat të foshnja nëse nëna e saj konsumon duhan gjatë shtatzënisë?

126



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Aktivitet Aktivizues - Video ose Histori

Shfaqni një video të shkurtër ose tregoni një histori reale lidhur me një individ që i ka përjetuar efektet dhe pasojat e përdorimit të drogave.

Diskutoni reagimet fillestare të nxënësve për materialin e parë, duke i inkurajuar ata të ndajnë mendimet dhe ndjenjat e tyre.

Leximi aktiv

Ndërsa lexojnë, nxënësit duhet t'i përdorin simbolet (✓), (kryq), (minus), (?) sikur në njësinë paraprake për t'i shënuar reagimet e tyre në tekst, varësisht njohurive dhe kërkesave për njësinë mësimore.

Nxënësit duhet të bëjnë shënime në tekst ose në një fletore të veçantë për t'i shpjeguar arsyet e shënimeve të tyre.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit Tabela e koncepteve

Droga	
Llojet e drogave	
Alkooli	
Duhani	

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen sipas aftësisë së tyre për të përshkruar: drogat dhe efektet, llojet e drogave, alkoolin, duhanin.

Detyrë:

(Të shënohet ndonjë përjetim personal, nxjerrë nga historitë e ndryshme të njerëzve të promovuara në internet)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon institucionet ku mund të kërkojnë ndihmë adekuate. Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3, III. 8, V. 7, VI. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pagjumësia dhe qëndrimi i gjatë ulur - pasojat në shëndet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përkufizon pagjumësinë dhe liston të paktën tri shkaqe të zakonshme;
- Përmend pasojat e pagjumësisë, duke e përfshirë lodhjen, vështirësitë në përqendrim, humor të keq, probleme me kujtesën dhe rrezik të shtuar për sëmundje;
- Shpjegon lidhjen midis pagjumësisë dhe qëndrimit të gjatë ulur me shëndetin e përgjithshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: TV, poster, fotografi, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: TIK, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi: Përgatitja për të nxënë *Stuhi mendimesh*

Bëhen pyetje të tilla, si:

- Çfarë është pagjumësia sipas mendimit tuaj?
 - Çfarë mendoni se ndodh kur qëndrojmë ulur për një kohë të gjatë?
- Shkruani përgjigjet në dërrasë ose në një letër të madhe për t'i ndarë në klasë.


3.8. PAGJUMËSIA DHE QËNDRIMI I GJATË ULUR - PASOJAT NË SHËNDET

3.8.1. Çfarë ndodh nëse ke pagjumësi?

Pagjumësi pothuajse të gjithë kemi përjetuar herë pas here. Ndonjëherë pagjumësia te disa mund të zgjasë për pak net, por te disa kjo mund të jetë e vazhdueshme. Kjo ndodh për shkaqe të ndryshme. Trajtimi i pagjumësisë është i rëndësishëm dhe duhet të bëhet në fazat e para të paraqitjes së saj. Pagjumësia e vazhdueshme mund të rrisë rrezikun për paraqitjen e problemeve shëndetësore të ndryshme te ju. Nder problemet e njohura të pagjumësisë së vazhdueshme janë çrregullimet e shëndetit mendor: depresioni, ankthi, konfuzioni, frustrimi, por dhe rreziqet e sëmundjeve të zemrës, rritjes së peshës, diabetit, e çrregullimit të sistemit të tretjes, humbjes së imunitetit, shtypjes së lartë të gjakut. Pagjumësia mund të ndikojë shumë në uljen e suksesit në shkollë, në punë, në humbjen e kujdesit gjatë vozitjes etj. Pagjumësia mund të ndikojë në shkurtimin e jetëgjatësisë suaj.

Çfarë e shkakton pagjumësinë? Shkaqet e pagjumësisë janë të ndryshme si: stresi, çrregullimi i orarit të gjumit, përdorimi i laptopit dhe i telefonit celular para rënies në gjumë, të ngrënë shumë vonë para gjumit, mungesa e ushtrimeve, pirja e kafeinës para gjumit etj. Një natë pa gjumë ndikon që ju të ndiheni të lodhur dhe pa energji të nesërmen. Mund të ndieni edhe kokëdhembje. Mirëpo, nëse keni disa net pa gjumë, atëherë do të keni probleme më serioze shëndetësore. Për problemet e pagjumësisë duhet të bisedoni me prindërit dhe me mjekun e shkollës. Me këshillat e tyre mund të hiqni zakonet e këqija të gjumit, ndërsa mjeku juaj si pjesë e procesit të diagnostikimit, mund dhe të gjejë shkaqet themelore për pagjumësinë tuaj.

Për sa gjumë kemi nevojë? Njerëzit sot në përgjithësi përtojnë pagjumësi dhe zgjohen me ndjenjë e lodhjes. Shkaqet u thanë më lart. Varësisht prej moshës ndihen dhe nevojat për gjumë. Shumica prej nesh kanë nevojë për rreth 8 orë gjumë të mirë gjatë natës.



Pagjumësia ka pasojat e mëdha për shëndetin

3.8.2. Pasojat e qëndrimit ulur për kohë të gjatë

Hulumtimet e bëra lidhur me pasojat e qëndrimit ulur në periudha të gjata kohore kanë treguar se ato janë të shumta si: shtimi në peshë, rritja e shtypjes së gjakut, e sheqerit të lartë në gjak, e yndyrës së tepërt, depresioni, deformimi i umazave të kurrizit të përcojella me dhembje në qafë dhe shpinë, dobësimi i muskujve etj.

Qëndrimet ulur për kohë të gjatë janë ato para kompjuterit, televizorit, gjatë kryerjes së punëve të ndryshme. Kështu, është e nevojshme që çdo 30 minuta të bëjmë një lëvizje 5-minutëshe, që të shmangim qëndrimin ulur për kohë të gjatë.



Qëndrimi ulur për kohë të gjatë sjell rreziqe të shumta për shëndetin tonë

Të mbahet në mend!

- Pagjumësia e vazhdueshme duhet të trajtohet seriozisht, sepse mund të rrisë rrezikun për paraqitjen e problemeve shëndetësore të ndryshme të ju.
- Nder problemet e njohura të pagjumësisë së vazhdueshme janë çrregullimet e shëndetit mendor si depresioni, ankthi, por dhe sëmundjet e zemrës, rritjes së peshës, diabetit, e çrregullimit të sistemit të tretjes, humbjes së imunitetit.
- Pagjumësia mund të ndikojë shumë në uljen e suksesit në shkollë, në punë, në humbjen e përqendrimit gjatë vëllimit etj.
- Pagjumësia ndodh si rezultat i stresit, i çrregullimit të orarit të gjumit, i përdorimit të kompjuterit dhe të telefonit celular para rënies në gjumë, i ngrënies para gjumit, i mungesës së aktiviteteve fizike, pirjes së kafeinës para gjumit etj.
- Njeriu i rritur ka nevojë për së paku 8 orë gjumë gjatë natës.
- Pasojat e qëndrimit ulur në periudha të gjata kohore janë të shumta.

Pyetje

1. Pse mungesa e gjumit është e keqe për shëndetin tuaj?
2. Përcakto shkaktarët e pagjumësisë.
3. Trego pasojat e qëndrimit ulur për kohë të gjatë.

128



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Diskutimi i Përvojave Personale dhe Shpjegimi i Kontekstit

Kërkoni nga nxënësit të ndajnë ndonjë përvojë personale ose informacion që kanë dëgjuar për pagjumësinë ose qëndrimin e gjatë ulur.

Shpjegoni kontekstin e gjerë të ndikimit të pagjumësisë dhe qëndrimit të gjatë ulur në shëndetin e përgjithshëm dhe jetën e përditshme.

Puna në grupe

Organizoni nxënësit në grupe të vogla për t'i diskutuar pyetjet e ngritura më herët. Jepni secilit grup një temë të veçantë (grupi 1 diskuton shkaqet e pagjumësisë, grupi 2 diskuton efektet e pagjumësisë në shëndet, grupi 3 diskuton pasojat e qëndrimit të gjatë ulur).



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Tabela e koncepteve

Prezantimet	
Grupi 1	Shkaqet e pagjumësisë
Grupi 2	Efektet e pagjumësisë në shëndet
Grupi 3	Pasojat e qëndrimit të gjatë ulur

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen sipas përfshirjes në diskutime dhe prezantimeve në grupe të temave të ndara nga mësimdhënësi.

Detyrë:

(Si e keni të organizuar një ditë të zakonshme, përfshirë orarin, kohëzgjatjen e gjumit dhe qëndrimin e gjatë ulur gjatë një dite, sa kohë i kaloni në aktivitete rekreative?)

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Biologji
Shkalla e kurrikulës: III **Klasa:** VI
Tema: Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Rezultatet e të nxënit të temës: Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës. Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuatë. Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I. 3, III. 8, V. 7, VI. 7

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Seksualiteti njerëzor, abuzimi, drogat, pagjumësia - Përforcim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan format e seksualitetit njerëzor;
- Tregon format e abuzimit seksual;
- Njeh drogat, pasojat dhe efektet e përdorimit të tyre;
- Analizon efektet e pagjumësisë dhe pasojat e qëndrimit të gjatë ulur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 6.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Përforcim

3.4. SEKSUALITETI NJERËZOR

1. Plotëso fjalitë duke u bazuar në librin bazë.

- Njerëzit mund të jenë: _____ etj.
- _____ do të thotë paragjykim, diskriminim dhe urrejtje ndaj dikujt që ka ngjyrë tjetër, etni tjetër apo i takon një kombi tjetër.
- Në Kosovë _____ të gjithë janë të barabartë dhe mbrohen njëjtë pa marrë parasysh etninë, racën, gjininë, orientimin seksual.
- Në rastet kur kontakti seksual bëhet pa pëlqimin e njërit prej partnerëve quhet _____.
- Shembuj të abuzimit seksual janë _____.
- Përdorimi i forcës, shantazhit ose çfarëdo forme tjetër për të detyruar dikë të kryejë marrëdhënie seksuale quhet _____.
- Personat e rritur që ndiejnë tërheqje seksuale ndaj fëmijëve quhen _____, ndërsa vetë sjellja _____.

3. A janë këto pohime të sakta?

- Në natyrë seksualiteti u shërben njerëzve për riprodhim, dhe për një marrëdhënie partneriet. PO JO
- Kosova, si dhe shumë vende në botë, ka ligj për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTQ+. PO JO
- Komventa e Kombëve të Bashkuara mbi diskriminimin racial nuk përcakton ndonjë dallim midis termave "diskriminim racor" dhe "etnik". PO JO
- Në Kosovë, me ligj dhe me kushtetutë të gjithë janë të barabartë, pa marrë parasysh etninë, racën, gjininë, orientimin seksual. PO JO
- Perdhanimi mund të ndodhë vetëm midis të njohurve. PO JO
- Incesti nënkupton marrëdhënie seksuale mes anëtarëve në rrethin e ngushtë të familjes. PO JO
- Në Kosovë dhe pothuajse në të gjitha vendet e botës, incesti është i ndaluar me ligj. PO JO
- Pedoofilia dhe incesti shkaktojnë të fëmijët lindime të mëdha psikike dhe fizike. PO JO
- Askush nuk ka të drejtë të prekë dikë kundër vullnetit të tij/Saj! PO JO

3.4. SEKSUALITETI NJERËZOR


1. Plotëso fjalitë duke u bazuar në librin bazë.

- Njerëzit mund të jenë: _____ etj.
- _____ do të thotë paragjykim, diskriminim dhe urrejtje ndaj dikujt që ka ngjyrë tjetër, etni tjetër apo i takon një kombi tjetër.
- Në Kosovë _____ të gjithë janë të barabartë dhe mbrohen njëjtë pa marrë parasysh etninë, racën, gjininë, orientimin seksual.
- Në rastet kur kontakti seksual bëhet pa pëlqimin e njërit prej partnerëve quhet _____.
- Shembuj të abuzimit seksual janë _____.
- Përdorimi i forcës, shantazhit ose çfarëdo forme tjetër për të detyruar dikë të kryejë marrëdhënie seksuale quhet _____.
- Personat e rritur që ndiejnë tërheqje seksuale ndaj fëmijëve quhen _____, ndërsa vetë sjellja _____.

2. Lidh shprehjet e shtyllës A me mënyrën e seksualitetit të njerëzimit e shtyllës B duke shkruar shkronjat.

- | A | B |
|--|--------------------------|
| a) meshkujt të dashur për femrat | |
| b) personi mashkull bie në dashuri me një person mashkull | _____ heteroseksualiteti |
| c) femrat e dashura për meshkujt | |
| d) një femër bie në dashuri me një femër tjetër | _____ homoseksualiteti |
| e) bien në dashuri me seksin e njëjtë dhe seksin e tyre të kundërt | _____ biseksualiteti |

Zgjidh fjalëkryqin



Horizontalisht

1. Lëndë ushqyese të domosdoshme që nevojiten në sasi të vogla.
2. Lëndë energjike e deponuar në bimë, kryesisht në drithëra.
3. Lëndët ushqimore që më së shumti na japin energji.
4. Droga që e ngadalëson funksionimin e trurit.
5. Çka duhet larë në trupin tonë së paku dy herë në ditë?
6. Mungesa e një minerali që shkakton anemi.
7. Listim, regjistrim i gjësëve.
8. Dallimi për nga forma dhe ndërtimi në mes individit maskull dhe femër të të njëjtit lloj.
9. Paragjykim, diskriminim dhe urrejtje ndaj dikujt që ka racë apo kombësi tjetër.

Vertikalisht

1. Lëndë ushqyese e njohur si burim kryesor i energjisë.

86

Përforsim

3. A janë këto pohime të sakta?

- a. Personi që merr droga mjekësore të caktuara rregullisht, fillon të bëhet i varur. **PO JO**
- b. Alkooli është depresant që e ngadalëson funksionimin e trurit. **PO JO**
- c. Nikotina shkakton sëmundje të zemrës, sepse i ngushton enët e gjakut në trup. **PO JO**
- d. Nëse një grua shtatzënë pi duhan, foshnja nuk e arrin peshën dhe rritjen normale. **PO JO**

2. Lidhi shprehjet e shtyllës A me shprehjet përkatëse të shtyllës B duke shënuar shkronjat.

- | A | B |
|--------------|--------------------------|
| a) morfina | |
| b) kodeina | |
| c) metadoni | _____ drogat mjekësore |
| d) kanabisi | |
| e) heroína | _____ drogat jomjekësore |
| f) tramadoli | |
| g) kokaina | |

2. Në tabelën poshtë, shënoji pasojat e mundshme shëndetësore nga pagjumësia dhe qëndrimi ulur për kohë të gjatë.

A	B
PASOJAT NGA PAGJUMËSIA	PASOJAT NGA QJËNDRIMI ULUR PËR KOHË TË GJATË

2. Në tabelën poshtë, shënoji pasojat e mundshme shëndetësore nga pagjumësia dhe qëndrimi ulur për kohë të gjatë.

A	B
PASOJAT NGA PAGJUMËSIA	PASOJAT NGA QJËNDRIMI ULUR PËR KOHË TË GJATË

3. A janë këto pohime të sakta?

- a. Pagjumësi pothuajse të gjithë kemi përjetuar herë pas here. **PO JO**
- b. Pagjumësia e vazhdueshme nuk e rrit rrezikun e paraqitjes së problemeve shëndetësore të ndryshme te ju. **PO JO**
- c. Nëse keni disa net pa gjumë, pasojat shëndetësore bëhen më serioze. **PO JO**
- d. Shumica prej nesh kanë nevojë për rreth 5 orë gjumë të mirë gjatë natës. **PO JO**
- e. Qëndrimet ulur për kohë të gjatë janë ato para kompjuterit, televizorit, gjatë kryerjes së punëve të ndryshme. **PO JO**

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen sipas aftësisë së tyre për t'i plotësuar kërkesat në fletoren e punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:
